

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit
Dhjetor 2021/ Nr. 12



109-VJETORI I FORCAVE TË ARMATOSURA
Peleshi: Mirënjohje për ushtarakët që e
krijuan dhe i dhanë jete kësaj force moderne

Përmbajtja

Numri 12

SEKSIONI PËRKUJTIMOR -SHKENCOR

- 6** Roli i Lidershit të Lartë Ushtarak Shqiptar në Krijimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare

GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ

- 20** Faleminderit për qasjen pozitive dhe mbështetjen e vazhdueshme që Maqedonia e Veriut po jep për shtetin e Kosovës

BARAZIA SI KONCEPT

- 28** "Çdo femër që më në fund e kuptoi vlerën e saj, ka marrë valixhet e saj të krenarisë dhe ka hipur në një fluturim drejt lirisë, i cili zbarkoi në luginën e ndryshimit"

INTERVISTË ME KOLONELIN ARBEN TOSKA

- 24** Akademia e Nënoficerëve, 28 vite profesionalizëm dhe devotshmëri

NATO

- 40** Riga, Letoni, 30 nëntor-1 dhjetor 2021: Sekretari i Përgjithshëm thërret në takim ministrat e Jashtëm të NATO-s

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shef i Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 109-VJETORI I FA

Peleshi: Mirënjohje për ushtarakët që e krijuan dhe i dhanë jete një force moderne

Ministri Peleshi: 4 dhjetori shënon 109-vjetorin e krijimit të ushtrisë shqiptare. Më 4 dhjetor 1912, 6 ditë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë u krijua Ushtria Kombëtare...



14 BUXHETI 2022

Rama: Rritja e pagave me 30 për qind për FA do të ndihmojë në një performancë më të mirë

Kryeministri Edi Rama, në një takim me Forcat e Armatosura që kishte si qëllim diskutimin mbi buxhetin 2022 për Ministrinë e Mbrojtjes, tha se...



18 "MBROJTJA KIBERNETIKE"

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Sulmet kibernetike kërcënojnë të rrezikojnë thelbin e demokracive liberale, vullnetin e lirë të shoqërive moderne

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi zhvilloi një vizitë zyrtare në Izrael. Bashkë me ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, morën pjesë në konferencën e nivelit të lartë...



19 GËZUAR 28-29 NËNTORIN

"Shqipëria 109 vite shtet

Më 28 nëntor 1443 i madhi Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ngriti flamurin kombëtar në kalanë e Krujës. Ndërkaq, më 28 nëntor të vitit 1912, Ismail Qemali ngriti flamurin...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 89-të i botimit
Nr. 12/ 2021

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitim, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>





109-VJETORI I FORCËVE TË ARMATOSURË

Peleshi: Mirënjohje për ushtarakët që e krijuan dhe i dhanë jetë kësaj force moderne



Ministri Peleshi: 4 dhjetori shënon 109-vjetorin e krijimit të ushtrisë shqiptare. Më 4 dhjetor 1912, 6 ditë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë u krijua Ushtria Kombëtare dhe për herë të parë u krijua dhe Ministria e Mbrojtjes Kombëtare, ku Forcat e Armatosura u ndanë në Forca Tokësor, Forca Detare dhe Forca Ajrore. Në rrugëtimin e tyre një shekullor kanë hasur vështirësi, të cilat i kanë kaluar me sukses siç dinë veç



djemtë dhe vajzat nën uniformën ushtarke.

Krenar sot të jem mes jush si një forcë moderne, profesionale dhe e arsimuar njëloj si koleget tuaj të NATO-s, aleancës më të madhe politike dhe ushtarake në botë. Mirënjohje për ushtarakët që e krijuan dhe i dhanë jetë kësaj force moderne.

Ministri Peleshi: Më 4 dhjetor 1912, 6 ditë pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë u krijua Ushtria Kombëtare dhe për herë të parë u krijua edhe Ministria e Mbrojtjes Kombëtare, ku Forcat e Armatosura u ndanë në Forca Tokësor, Forca Detare dhe Forca Ajrore.





Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj:

Nderim dhe mirënjohje ndaj themeluesve dhe arkitektëve të forcës ushtarake të vendit dhe të gjithë gjeneratave që kanë shërbyer e kontribuar në vite

Mesazh urimi i SHSHPPFA me rastin e 109-Vjetorit të Krijimit të Forcave të Armatosura

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, me anë të një mesazhi, ka uruar ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe civilë të Forcave të Armatosura, me rastin e 109-vjetorit të krijimit të tyre:

Të nderuar ushtarakë dhe civilë të Forcave të Armatosura, si Shefi i

Shtabit të Përgjithshëm, kam kënaqësi në t'ju përsëhendes dhe t'ju uroj për përvjetorin e 109-të të Krijimit të Forcave tona të Armatosura!

4 Dhjetori i vitit 1912 është një kushtrim i të parëve tanë ndaj kujtesës kombëtare për vlerën dhe rëndësinë e Forcave të Armatosura, por edhe tribuna për të shprehur nderimin dhe mirën-



Armatosura, ky përvjetor i gjen Forcat tona të Armatosura me mesazhe të rëndësishme për një vëmendje të shtuar përkujdesjeje, për një mbështetje dhe motivim të merituar dhe rritje të dinjitetit të të gjithë personelit që shërben dhe ka shërbyer në Forcat e Armatosura, por edhe për një modernizim, zhvillim dhe rritje të aftësive të tyre.

Kam bindjen time të palëkundur se me angazhimet dhe përkushtimin tonë, kurdoherë do ta meritojmë plotësisht dhe denjësisht respektin dhe besimin e popullit, të autoriteteve të vendit dhe të aleatëve tanë në NATO. Është rasti i këtij përvjetori, t'i sigurojmë të gjithë, se devocioni i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë gjithmonë atdheu, nderi, detyra dhe se ato do të jenë të suksesshme në përmbushjen e misionit të tyre fisnik.

Me mirënjohjen dhe respektin më të thellë për shërbimin, sakrificat dhe kontributin tuaj dinjitoz, ju uroj gëzuar këtë përvjetor të Forcave të Armatosura!

Gjeneralmajor
Prof. Asoc. Bajram Begaj
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm

johjen tonë ndaj themeluesve dhe arkitektëve të forcës ushtarake të vendit dhe të gjithë gjeneratave që kanë shërbyer e kontribuar në vite. Kjo ditë është momenti që të ndjehemi krenarë për rrugëtimin e lavdishëm dhe për statusin e nderuar e të vlerësuar që kemi fituar brenda shoqërisë tonë, por edhe midis aleatëve tanë në Aleancën Euroatlantike.

Forcat e Armatosura janë sot nderi dhe krenaria e vendit, në sajë të angazhimeve dhe kontributeve të qenësishme dhe të rëndësishme në misionet brenda vendit dhe ato ndërkombëtare. Ky është një motiv i mjaftueshëm që t'u shpreh një mirënjohje dhe respekt të veçantë të gjithë atyre që kanë kontribuar në vite dhe atyre që janë aktualisht të angazhuar në vijën e parë të frontit të Aleancës dhe organizmave të tjerë ndërkombëtar në Letoni, Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë e Sudan. Sot, për

të gjithë ne njerëzit me uniformë, është gjithashtu çasti solemn, t'u kushtojmë një përlulje dhe homazh të veçantë të gjithë atyre që me vetëmohim kanë bërë edhe sakrificën sublimë në shërbim të Shqipërisë brenda dhe jashtë vendit. Respekt dhe mirënjohje edhe për gjithë familjet e ushtarakëve, që me përfshirjen dhe mbështetjen e tyre të pakushtëzuar dhe të pakursyer, janë bërë pjesë e pandarë e kontributeve dhe komunitetit tonë ushtarak.

Me shërbimin dhe kontributin e saj në çdo situatë nevojë dhe emergjence të komunitetit e qytetarëve, në çdo skaj të vendit, Forcat e Armatosura janë bërë një pjesë integrale, e dashur dhe e kërkuar e gjithë shoqërisë tonë. Ky angazhim, do të vazhdojë të ngelet prioriteti dhe detyrimi ynë më i rëndësishëm.

Të nderuar ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe civilë të Forcave të



109 vjetori i themelimit të ushtrisë shqiptare

SEKSIONI PËRKUJTIMOR –SHKENCOR

Roli i Lidershit të Lartë Ushtarak Shqiptar në Krijimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare

Krijimi i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare ndodhi pak ditë pas shpalljes së aktit historik të Pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimit të shtetit të pavarur modern. Institucionet e Mbrojtjes dhe Ushtria Shqiptare e kanë zanafilën tek Pavarësia dhe shteti i pavarur shqiptar, ato kanë moshën e Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës. Roli i lidershit në keto institucione ishte i dukshëm dhe përcaktues në organizimin ushtarak dhe ngritjen e Ushtrisë Shqiptare, Për të sjellë në vëmendjen e brezave historinë e formimit të këtij institucioni dhe lidershit e saj u zhvillua seksioni 'Roli i Lidershit të Lartë Ushtarak Shqiptar në Krijimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.' me pjesëmarrjen e disa prej studiuesve tanë ushtarakë.

Fjalën e hapjes e mbajti z. Proletar Hasani i cili theksin e tij e vuri mbi rolin e lidershit të lartë ushtarak, në ngritjen, zhvillimin dhe drejtimin e institucioneve të mbrojtjes dhe të ushtrisë shqiptare.

Kumtues të tjerë të cilët do trajtonin me detaje "Gjurmët e lidershit ush-

tarak të lartë shqiptar do ishin z. Asllan Zemani, Bashkim Qeli.

Bernard Zotaj dhe Zaho Golemi do na sillnin edhe njëherë në kujtesën tonë Ministrin e parë të Luftës, Mehmet Pashe Dëralla, ndërsa z. Sali Jonuzi me dëshirën për të sjellë sa më pranë lexuesit emra historikë të cilët kanë shenjuar suksese në veprimtaritë e tyre ushtarake solli emrin e drejtuesit të Shtabit Madhnor të Ushtrisë shqiptare major Ali Shefqet Shkupi.



Lidershipi shqiptar në vite

DR. ASLLAN ZEMANI

Tanimë nuk përbën më një fakt të ri njoftimi se historia e popullit shqiptar është e mbushur me luftëra për liri dhe pavarësi kundër pushtuesve të huaj. Duke qenë e tillë, kjo histori, sigurisht ka pasur protagonistët si dhe artin e saj luftarak, me të përbashkëtat dhe me veçoritë e veta dalluese nga ato të vendeve e të popujve të tjerë, në periudha të ndryshme të historisë së Shqipërisë.

Pikërisht për të pasqyruar dhe shpjeguar këto dukuri shërben Historia Ushtarake, e cila edhe në Shqipëri ka fillimin, ecurinë dhe zhvillimet e veta, gjithashtu në një proces, me arritjet, mangësitë dhe veçoritë dalluese. Çështja nuk është se historia ushtarake është e palëvruar. Përkundrazi, për të është shkruar jo pak, por sepse asnjë herë nuk është shkruar në mënyrë të sistemuar dhe se nuk ka, deri më sot, një pasqyrë të kronologjisë dhe të ecurisë së saj reale, tërësisht shkencore, në të gjitha pjesët dhe treguesit përbërës të saj.

Në historinë më se njëqindë vjeçare të Ushtrisë Shqiptare roli i lidershipit ka qenë dhe është më i spikatur në Forcat e Armatosura pasi, ky rol me të drejtë konsiderohet si "frymëmarrja" e kësaj force, pra është pikërisht ai që prodhon adrenalinën e cila ngre lart moralin e ushtarakut duke e çuar atë deri në vetësakrifikim.

Gjithkush që ka shfletuar dhe lexuar kronikat apo shtypin e periudhës së pas vitit 1912, që ka shfletuar librat e historisë dhe e njeh historinë ushtarake shqiptare, me siguri ka mësuar dhe e di mirë tashmë se, Shqipëria, historikisht ka nxjerrë ushtarakë të shquar, në të gjitha kohërat

Shumë nga këta djem u bënë

ushtarakë me grada dhe poste të larta, duke ndikuar me shërbimet, me punën dhe përkushtimin, me aftësitë dhe pasionin e pafund, që i karakterizonte, për interesat e vendeve ku shërbyen. Kështu, emrat e shumë oficerëve shqiptarë të asaj periudhe mbushin lista të gjata, të shndërruara tashmë në dokumente arkivore, në ekspozite muzeshë, si dhe janë bërë personazhe të shumë librave historikë. Për rrjedhojë ata janë bërë, njëherësi, edhe pjesë e natyrshme e historisë ushtarake të vendeve ku ata shërbyen dhe jetuan!

Shumica e ministrave të Luftës, apo siç u quajtën më pas, të Mbrojtjes, dhe e Kryetarëve apo e Shefave të Shtabit Madhor shqiptar, që erdhën në krye të këtyre institucioneve të rëndësishëm të mbrojtjes së vendit, padyshim që u përpoqën të bënin më të mirën. Ata, përveçse atdhetarë, bënë gjithçka për të qenë sa më profesionistë dhe luftuan gjatë kohës që drejtuan në postet e tyre të rëndësishëm dhe luftuan, në tërësi, për të

krijuar një ushtri me trajta dhe përmbajtje kombëtare, pse jo edhe me elementë modernë. Kjo dukuri nuk vërehet vetëm në fasadë apo thjeshtë në emërtim por, sidomos, në brendinë dhe përpjekjet e shumta që vinë pikërisht nga historia e organizimit dhe e drejtimit dhe e vepërimit të kësaj ushtrie.

Mbas çlirimit të vendit, formimi i ushtarakëve shqiptarë u bazua kryesisht në arsimimin e tyre në akademitë e ish BS deri sa u hodhën bazat për krijimin e një serie shkollash ushtarake, të cilat luajtën pa dyshim rolin kryesor në përgatitjen e lidershipit ushtarak me vlera ushtarake të pa diskutueshme për vendin, por që në prizmin doktrinar nuk kishin asnjë lidhje me strukturën që pritej të ndërtohej në vend. E më pas në kohë, gati gjithë drejtuesit ushtarakë u arsimuan vetëm në shkollat shqiptare ushtarake, në një shkollë vërtet me karakteristika të spikatura, që luajti rol të dorës së parë në formimin e lidershipit ushtarak shqiptarë.

Partneriteti midis Shqipërisë dhe NATO-s si dhe me vendet anëtare të saj, rriti dhe intensifikoi bashkëpunimin politik dhe ushtarak, kontribuoi në angazhimin drejt parimeve të demokracisë dhe rritjes së stabilitetit, transparencës në buxhetin e mbrojtjes, thellimin e kontrollit demokratik në Ministrinë e Mbrojtjes, planifikimin e përbashkët, stërvitjet e përbashkëta ushtarake. Rol të veçantë luajti dhe pjesëmarrja direkte e ushtarakëve si në arsimim por veçanërisht pjesëmarrja direkte në operacione të përbashkëta duke bashkëvepruar me forcat e NATO-s në fusha të tilla si paqëruajtja, operacionet e kërkim-shpëtimit dhe ato humanitare.



Në historinë më se njëqindë vjeçare të Ushtrisë Shqiptare roli i lidershipit ka qenë dhe është më i spikatur në Forcat e Armatosura pasi, ky rol me të drejtë konsiderohet si "frymëmarrja" e kësaj force, pra është pikërisht ai që prodhon adrenalinën e cila ngre lart moralin e ushtarakut duke e çuar atë deri në vetësakrifikim.

Roli i lidërshiptit të lartë ushtarak në ngritjen, zhvillimin dhe drejtimin e institucioneve të mbrojtjes dhe të ushtrisë shqiptare

Prof. Dr. PROLETAR HASANI

Qeveria e Përkohëshme e Vlorës e dalë nga mbledhja e Kuvendit Kombëtar, në përbërje të kabinetit të saj përfshiu edhe Ministrinë e Luftës (të Mbrojtjes Kombëtare), sepse në vizionin dhe strategjinë e saj, ndër shqetësimet e para dhe të ngutshme kishte edhe mbrojtjen e vendit. Për këtë arsye i nevojitej, "... ngritja dhe organizimi i një force të armatosur, e një ushtrie sado të vogël, për t'u mbrojtur nga sulmet e fqinjëve".

Në ngritjen, zhvillimin dhe organizimin e institucioneve të Mbrojtjes dhe të organizimit të Ushtrisë Shqiptare, një vend dhe rol të rëndësishëm ka luajtur pa dyshim lidërshipti ushtarak shqiptar. Kjo shenjë u duk që më 4 Dhjetorin e vitit historik 1912, me krijimin e Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës te kryesuar nga kryeministri Ismail Qemali, e cila emëroi në drejtimin e dikasterit të Luftës, apo ndryshe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, një lider ushtarak të njohur, gjeneralbrigade Mehmet Dërrallën (Tetovën) ai ishte një oficer karriere, me shumë përvojë organizimi dhe drejtimi ushtarak e luftarak, i cili njihet edhe si një prej komandantëve të shquar të kryengritjeve shqiptare të viteve 1910-1912.

Pikërisht për këto mangësi e vështirësi, ndërmarrja e Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës për të përfshirë në përbërje të saj edhe institucionin e Luftës (Mbrojtjes Kombëtare), roli i lidërshiptit ushtarak shqiptar u bë më i dukshëm dhe i rëndësishëm.

Roli dhe merita e lidërshiptit të tyre qëndron në faktin se ata i përmbushën objektivat strategjike të vëna nga Qeveria e Përkohëshme përmes vështirësive të shumta, të nisur pothuajse nga asgjëja, në mungesë të plotë të trashëgimisë të institucioneve dhe organizimeve ushtarake. Nën udhëheqjen dhe kujdesin e Qeverisë së Përkohëshme e Vlorës ata i a dolën që ti krijonin dhe vinin në funksionim institucionet e Mbrojtjes dhe të hidhnin

hapat e para në organizimin ushtarak shqiptar. Për këtë qëllim ata përgatitën dokumentin e parë që ishte "Rregullorja e ministrisë së Luftës", si dhe ligjin për "Organizimin e Milicisë Shqiptare", më 3 qershor të vitit 1913, deri në organizimin e Ushtrisë Shqiptare, me të gjitha strukturat e saj, veçanërisht të forcave aktive. Madje, u mendua nga ky lidërshipt edhe përkthimi i terminologjisë ushtarake në gjuhën shqipe. Në mungesë të organizimit të formacioneve ushtarake të rregullta shqiptare për shkaqe të kuptueshme, ministria e Luftës dhe Shtabi Madhor, drejtuan veprimet luftarake të formacioneve luftarake vullnetare dhe të atyre rezerviste në Jug të vendit, për të ndalur përparimin e trupave shoviniste greke, që synonin pushtimin e territoreve shqiptare. Ndërkohë vijonin përpjekjet për organizimin e "Kompanisë modele", që ishte nënreparti i parë i rregullt i Ushtrisë Shqiptare, sipas të cilit do të organizoheshin edhe nënrepartet dhe repartet e tjerë të kësaj ushtrie. Mund të thuhet se lidërshipti ushtarak i Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, hodhi themelet e institucionit të parë të Mbrojtjes në Shqipëri, si dhe shënoi fillimet apo shënjoji gjurmën e organizimit modest ushtarak shqiptar.

Një faqe e re u hap në historinë e popullit shqiptar me Kongresin e Lushnjes në janar të vitit 1920 dhe qeverisë së dalë prej tij. Në Këshillin Kombëtar (Senati) u hodh idea për ringritjen të Ministrisë së Luftës dhe krijimin e organizimit të mirëfilltë ushtarak të Ushtrisë Shqiptare. Ministër i Luftës, u emrua gjeneralbrigade Ali Riza Kolonja, një oficer i lartë i dalë nga Akademia Ushtarake turke dhe i kualifikuar në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm gjerman. Ai ishte një oficer me kulturë të gjerë, me përvojë drejtuese të pasur dhe me koncepte bashkohore. Së pari gjeneral Ali R. Kolonja evidentoi dhe mbloshi copëzat e nënreparteve dhe reparteve ushtarake shqiptare

që qenë ngritur dhe vepronin në zona të ndryshme të territorit të Shqipërisë që nga koha e Luftës së Parë Botërore. Të tilla ishin disa nënreparte të "Milicisë Shqiptare" ("Milizia Albaneze"), që vepronin në rajonin e Gjirokastrës dhe Delvinës. Gjithashtu edhe pak reparte ushtarake të organizuar në krahinën e Korçës, si dhe në Durrës e Elbasan.

Mbi bazën e tyre gjeneral Kolonja, i mbështetur nga Shefi i Shtabit Madhor, nënkoloneli energjik Ali Shefqeti (Shkupi), si dhe një grup oficerësh me përvojë të gjatë ushtarake, vendosën organizimin e Ushtrisë sipas sistemit modern "tresh", me tre regjimente. Kjo përbënte fillimet e organizimit ushtarak modern shqiptar.

mënyrën dhe këndvështrimin bashkohor, në përafrimin e institucionit të Mbrojtjes dhe të vetë organizimit ushtarak të Ushtrisë me modelet më të mirë dhe të përshatshëm të kohës.

Që nga krijimi i dikasterit të Mbrojtjes dhe i Ushtrisë Shqiptare, deri në fundin e vitit 1990, kur në Shqipëri ra sistemi politik njëpartiak, lidërshipti ushtarak përbëhej nga liderë të lartë, personalitete të fushës, që ishin, në përgjithësi, ushtarakë të karrierës, me grada të larta, si gjeneralë ose kolonelë, me përvojë në drejtim. Por, natyrisht, ata kishin formim ushtarak dhe kualifikime akademike të plota në kulturën ushtarake, disa edhe me kulturë të gjerë dhe në fusha të tjera si dhe njohës të gjuhëve të huaja. Të tillë ishin që nga ministri i parë i Mbrojtjes, Mehmet Dërralla, por edhe Kryetari i Shtabit Madhor, majori e më pas nënkoloneli Ali Shefqeti (Shkupi). Ata u pasuan nga ministri i Luftës i pari në Qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjes, gjeneral Ali Riza Kolonja, i kualifikuar në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Berlin, njohës i disa gjuhëve të huaja dhe më tej diplomat ushtarak si dhe pjestar në Komisionin Nderkombëtar të Përcaktimit të Kufijve të Jugut të Shqipërisë në vitet 1921 deri më 1925.

Lidershipi Shqiptar dhe roli i tij në ushtri

Si një studiues i konceptit të lidershipit ushtarak dhe rolit të tij në periudha të ndryshme kohore. Sa e rëndësishme ishte prania e ushtarakëve të huaj në strukturat e Forcave tona të Armatosura dhe çfarë roli luajtën ata?

Roli i arsimimit të ushtarakëve shqiptarë jashtë vendit gjithmonë ka qenë prezent por në mënyrë të veçantë ai arriti kulmin e vet mbas viteve '90, ku siç dihet me qindra ushtarakë u shpërndanë në të katër anët e globit, ashtu sikurse edhe tek ne mbërritën qindra ekspertë të tjerë ushtarakë, të cilët asistuan reformimin e Forcave të Armatosura Shqiptare për ta sjellë atë në standartet e kërkuara nga partnerët tanë. Gjatë këtij procesi të gjatë fillimisht u punua me përgatitjen e liderit ushtarak pasi do të ishin pikërisht këta që do të kryenin ndryshimet thelbësore. Kthimi i ushtarakëve nga vendet ku ata u trajnuan pa dyshim që fillimisht krijoi njëfarë konfuzioni, pasi të gjithë mundoheshin të sillnin përvojat e marra nga arsimimi i tyre në vendin ku kishin studiuar, prandaj shpesh herë ne dëgjonim të flitej për lidershipin ushtarak duke dhënë definicione të ndryshme rreth këtij problemi por, pavarësisht prej tyre thelbi i lidershipit në përgjithësi qëndron në faktin se ai është një proces influencimi tek njerëzit, për të arritur një ose disa synime, objektiva, apo për të përmbushur përgjegjësi të gjeneralëve të cilët duhet të sigurohen që ushtria të jetë gjithmonë e gatshme për të përmbushur misionet kushtetuese, qoftë kjo edhe për luftë nëse do të jetë nevojta. Të gjithë njerëzit ndikohen nga ajo se ç'farë ata kanë parë, ç'farë kanë mësuar dhe me kë kanë patur të bëjnë, por veçanërisht lideri ushtarak është pikërisht ai që di të punojë me njerëzit. Disa njerëz janë gazmorë dhe buzëqeshin gjatë gjithë kohës, disa të tjerë janë seriozë. Disa liderë hyjnë në një dhomë të një mision të caktuar pra, ai është diçka virtuale që duhet jetuar, duhet ndërë shpirtërisht dhe duhet bërë pronë e drejtuesit në përgjithësi por veçanërisht i liderit ushtarak, i cili duhet ta përmirësojë atë çdo ditë. Ja si e përkufizon lidershipin Schëarzkoopf, më 8 Maj 2000. "Unë ju them njerëzve se lidershipi është një kombinim i dy gjërave i karakterit dhe kompetencës". Krahas karakterit dhe kompetencës lideri ushtarak duhet të karakterizohet nga ndjenja e lartë e përgjegjësisë, kështu psh është mbushur me njerëz të panjohur dhe brenda pesë minutash ambientohen shumë shpejt me pjesëmarrësit, të tjerë e kanë shumë të vështirë të ambientohen. Ka liderë të tjerë ndoshta shumë kompetent por që janë të paretshëm në situata sociale. Pavarësisht tipave dhe karaktereve të njerëzve është lideri ai që pa dalë nga vetvetja gjen mënyrën dhe rrugën se si do të inspirojë zemrat e tyre. Trajtimi i njerëzve me drejtësi nga ana e liderit nuk do të nënkuptojë trajtimin e tyre sikur ata të ishin klone të njëri-tjetrit. Në fakt në qoftë se lideri i trajton të gjithë në mënyrë të njëjtë, mund të bëhet i padrejtë, për arsye se njerëz të ndryshëm kërkojnë gjëra të ndryshme prej tij. Në këtë kontekst liderët efektiv janë në mënyrë të mjaftueshme fleksibël për të përshtatur stilin e tyre të lidershipit dhe teknikat me njerëzit që ata drejtojnë. Disa vartës u përgjigjen pozitivisht me të mirë, sugjerimeve ose shtytjes miqësore, të

tjerë kanë nevojë madje duan nganjëherë ngacmim me fjalë më të ashpra. Karakteri njerëzor i liderit përbën pa dyshim aspektin më të besueshëm të një lideri të suksesshëm. Sipas gjeneral Harold K. Johnson; Komunikimi, ose aftësia për të informuar njerëzit mbi atë ç'ka pret prej tyre me fjalë të kuptueshme dhe aftësia për t'ju transmetuar atyre interesin që keni për ta, përbën çelësin për një drejtim të suksesshëm. Stili i lidershipit pa dyshim që është mënyra dhe rruga e sigurimit të drejtimit, implementimit të planeve dhe motivimit të njerëzve. Sipas studiuesve ushtarakë ekzistojnë tre stile të ndryshme lidershipi: autoritar, pjesëmarrës, dhe delegues. Në jetën e përditshme ne ndeshim në stile të ndryshme drejtimi të cilët varen nga situata, prandaj shumica e liderëve i përdorin të kombinuar të tre stilet e drejtimit, por vetëm njëri prej tyre bëhet dominant. Pa u zgjatur shumë në trajtimin teorik unë mendoj se drejtuesi, apo lideri ushtarak, nuk duhet ta njehësojë veten me postin që i jepet. Ai lypset të ketë egon dhe personalitetin e tij si njeri. Mund të përmëndim shumë emra drejtuesish të cilët, megjithëse janë në pension ose nuk janë më në poste drejtuese, ende kujtohen me respekt. Kjo ndodh sepse drejtuesi me personalitet është i prirur të krijojë marrëdhënie të tilla me vartësit e



bashkëpunëtorët, që ata ta pranojnë atë jo vetëm si "autoritet zyrtar", por edhe si "autoritet shoqëror".

-Në literaturën ushtarake thuhet se, veprimi i komandantit është të "aktivizojë potenciale luftarake operacionale, për të krijuar fuqi luftarake", ndërsa funksioni i liderit është të përshtasë fuqinë luftarake, procesi nëpërmjet të cilit një komandant imponon vullnetin me sukses. Kush është roli i lidershipit në pikpamjen tuaj?

Roli i lidershipit është një nga aspektet më thelbësore të suksesit në të gjitha sferat e jetës por, më i spikatur është ky rol në Forcat e Armatosura pasi, ky rol sot me të drejtë konsiderohet si "frymëmarrja" e kësaj force, pra është pikërisht ai që prodhon adrenalinën e cila ngre lart moralin e ushtarakut duke e çuar atë deri në vetësakrifikim. Mjafton të kujtojmë këtu thënien brilante të ish Presidentit të SHBA-së

Bill Klinton më 23 nëntor 1999 në Ferizaj të Kosovës: "Kur dolëm në tribunë, ju brohoritët për ne, sepse ju kishit qenë të shtypur, ndërkohë që ne ju qëndruam pranë. Dhe ne përdorëm fuqinë ushtarake për të mundur agresionin e Milosheviçit. Ne e fituam luftën. Por, dëgjoni, vetëm ju mund të fitoni paqen". Është pikërisht "Fuqia ushtarake" siç e quan Klintoni, pjesë shumë e rëndësishme e fuqisë së një shteti, shumë e rëndësishme për fitoren e luftës, është pikërisht roli i lidershipit ai që ngre lart zemrat e njerëzve, Klintoni e quan, "ne ju qëndruam pranë", që historikisht ka qenë një faktor shumë më i fuqishëm, për atë që Klintoni e quan "ne e fituam luftën", që në një farë mënyre do të thotë se Kosova, por jo vetëm, asnjëherë në historinë e saj nuk kishte patur aleatë kaq të fuqishëm në anën e saj. Në këto kushte, të mos arrish të fitosh paqen, për lidershipin është një mëkat i madh historik, është shpërdorim i një rasti të tillë që një kombi e një populli nuk i jepen ndoshta asnjëherë në historinë e tij.

-Në korrik të vitit 1943 krijohet Shtabi i Përgjithshëm me lidership ushtarak nga kahe të ndryshme, me lidership ushtarak të spikatur nga orientimi politik i vendit.

A ka qenë parim për liderat e ushtrisë shqiptare ky koncept?

Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare lidershipi i kohës filloi t'i jepte ushtrisë formën organizative të një ushtrie brenda shtetit. Duke marrë postin e Komandantit të Përgjithshëm, Hoxha luajti rolin e një kryetari të shtetit, ndërsa Moisiu atë të ushtarakut të mirëfilltë në drejtimin teknik ushtarak. Spiro Mojsiu, ishte një figurë e shquar ushtarake e kohës. Ai qëndroi në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nga muaji maj i vitit 1944 deri në gusht të vitit 1946. Bedri Spahiu, Dali Ndreu, etj. kishin qenë ushtarakë të karrierës, ata ishin arsimuar në shkolla ushtarake jashtë vendit si psh Dali Ndreu në Itali e Abaz Kupi kishte shërbyer në armën e xhandarmërisë gjatë kohës së Zogut me gradën e majorit. Jo vetëm gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ku roli i lidershipit ushtarak ka qenë i pa diskutueshëm por edhe më herët vendit tonë nuk i kanë munguar asnjëherë lidera të sukseshëm të cilët kanë qenë të arsimuar në akademitë ushtarake nga më të njohurat për kohën. Fillimisht u përkrahën ushtarakët e arsimuar jashtë vendit të cilët mbështetën Luftën Nacionalçlirimtare dhe morrën pjesë intensive në organizimin e saj, por ajo që dëmtoi më rëndë ushtrinë tonë erdhi mbas çlirimit të vendit, ku u denigruan thujtë të gjithë ata që kishin studiuar jashtë vendit dhe në Forcat e Armatosura hyri fryma e partisë në pushtet e cila politizoi çdo qelizë të ushtrisë, duke shmangur në mënyrë të qëllimshme rolin e lidershipit ushtarak, madje më vonë me heqjen edhe të gradave ushtarake, ushtria u shndërua në një organizim të madh politik ku predominonte vija e partisë. Në periudhën kur BS e udhëhiqte Stalini u hodhën bazat e bashkëpunimit dypalësh politik, ideologjik ushtarak, ekonomik e kulturor. Stalini i dha ndihma ekonomike të konsiderueshme Shqipërisë, mbështeti bazat e ekonomisë, fuqizoi ushtrinë shqiptare, dha bursa të shumta për arsimimin e lidershipit ushtarak si dhe solli këshilltarë të lartë në thujtë gjithë pikat kyçe të drejtimit të ushtrisë dhe të shtetit. Në periudha të ndryshme, si ajo e pavarësisë, ushtarakë holandezë (në tetor 1913) erdhën në Vlorë dhe dhanë kontributin e tyre në ristrukturimin dhe përgatitjen e xhandarmërisë shqiptare, kurse në qeverinë e Ahmet Zogut nga Austria erdhi kolonel Gustav Fon Myrdac për të drejtuar shtatmadhorinë.

Çfarë impakti krijuan ata dhe cilat ishin tiparet daluese të lidershipit ushtarak në periudhën 1912-1944.

Në këto vite, në Ushtrinë Shqiptare drejtuan kryesisht ushtarakë shqiptarë që ishin përgatitur në

Turqi. Kështu psh në kohën e shpalljes së Pavarësisë, Ismail Qemali caktoi si Ministër të luftës Mehmet Pashë Dërrallën, një Gjeneral i arsimuar në Akademinë e Shtatmadhorisë në Stamboll dhe që kishte arritur funksione të larta në ushtrinë osmane. Ishte një nga mbështetësit e tij dhe një ndër inisiatorët për Pavarësinë e Shqipërisë, ai kishte qenë komandant i Forcave Ushtarake të Lidhjes së Prizrenit. Po kështu pranë Dërrallës, i pari Shef i Shtabit të Përgjithshëm u caktua Major Ali Shefqet Shkupi, për të organizuar ushtrinë si kryetar i Shtatmadhorisë, ai kishte përfunduar në vitin 1905 studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Stamboll, me gradën kapiten shtatmadhorie. Shumë ushtarakë të huaj punuan në Shqipëri pas Shpalljes së Pavarësisë me 1912, mjafton të kujtojmë këtu; grupin e ushtarakëve holandezë të kryesuar prej Kolonelit De Veer dhe majorit Thomson, të cilët ndihmuan në ristrukturimin dhe përgatitjen e xhandarmërisë shqiptare. Leon de Chilardey, hyri në shërbim të Ushtrisë shqiptare që në vitin 1913, ndërsa kapiteni austriak Hasler shërbente si instruktor që prej vitit 1914. Të gjitha qeveritë shqiptare në vitet 1920-1939 e kanë vlerësuar shumë lart rolin e lidershipit ushtarak si mjaft të rëndësishëm në situatat e vështira që kalonte vendi ynë në këto kohë shumë të turbullta. Po kështu Ali Riza Kolonja i cili drejtoi ushtrinë në vitin 1920, me gradën gjeneral, u zgjodh ministër lufte nga qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës. Ai ishte ushtarak karriere, shkollën ushtarake e kish mbaruar në Stamboll dhe Akademinë e Shtatmadhorisë në Gjermani. Ministri Selahudin Said Shkoza, drejtoi në periudhën 1920-1921 me gradën kolonel, ishte arsimuar në Stamboll. Ai hyri në historinë e Ushtrisë Shqiptare jo vetëm si një ministër mbrojtjeje, por edhe si reformator i shquar. I ardhur nga Ushtria Turke, ai përshtati për kohën ato ligje që ishin të domosdoshme për të rregulluar marrëdhëniet e shtetit me ushtarakun. Po kështu pa u zgjatur mund të përmendim; Mustafa Maksutin, ushtarak me gradën major i arsimuar në Stamboll, Zija Dibra, i arsimuar në Stamboll, Shefik Kosturi, një nënkolonel i arsimuar në Turqi, Ismail Tatzati, një kolonel i arsimuar në Stamboll, Mustafa Aranitasi, kolonel i arsimuar në Stamboll si dhe Kasëm Qafëzezi, kolonel i arsimuar në Stamboll e Vjenë, Xhemal Aranitasi, kishte gradën gjeneral, ishte arsimuar në Stamboll. Duke parë në prizmin historik, por edhe në atë aktual në drejtim të institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes, mund të themi se, thelbi i lidershipit është aftësia për të dalluar dhe për të përdorur ato modele motivacionale të lidhura që i nxisin të tjerët, pra t'i bësh njerëzit që, vullnetarisht, të bëjnë gjëra që, ndryshe, nuk do t'i bënin, duke i harmonizuar këto modele me misionin sipas kohës vendit dhe subjektit.

-Nisur nga kjo cili ishte roli që luajti lidershipi ushtarak në periudhën e Monarkisë Shqiptare 1928-1939?

Në periudhën e Monarkisë u rrit prania dhe roli oficerëve organizatorë, në vitin 1927, ardhja e misionarëve ushtarakë italianë përcaktoi ndryshimin e sistemit ekzistues, të kalimit në ushtri të tipit të rregullt, të kohës. Ushtria u nda në katër komanda: Komanda e Artilerisë, Komanda e Xhenios, Komanda e Marinës së Luftës dhe Komanda e Gardës. Futja e pajisjeve dhe e armatimeve të reja, rriti fuqinë luftarake të Ushtrisë Shqiptare. Në këtë hark kohor ajo u plotësua me një varg rregulloresh, të cilat ndikuan ndjeshëm në rregullimin e veprimtarisë së përditshme të saj. Në vitet 1925-1928, pranë Ushtrisë erdhën afro 240 këshilltarë ushtarakë italianë, nën drejtimin e kolonelit Alberto Pariani. Pas punës në Shqipëri, Pariani u bë më vonë gjeneral korparmate dhe shef i

Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë italiane. Më 20 maj të vitit 1922, major Myrdac u emërua organizator dhe njëkohësisht inspektor i përgjithshëm i Ushtrisë shqiptare, që ishte në riorganizim e sipër. Në këtë post gjeneral Myrdac vijoi të punonte deri në fillim të muajit prill 1939, kur Ushtria shqiptare pushoi së vepruari dhe vendi u pushtua nga agresioni fashist. Gjatë zhvillimit të operacionit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare për çlirimin e kryeqytetit të vendit, forcat partizane kapën dhe arrestuan gjeneral Myrdacin. Ai iu dha për gjykim gjyqit special të luftës, që u zhvillua në Shqipëri pas Çlirimit të saj, në vitin 1945, që përcaktoi dhe fatin e tij. Gjenerali Myrdac shërbeu për tetëmbëdhjetë vjet në Ushtrinë shqiptare, 1922-1939 dhe 1943-1944. Një tjetër ushtarak austriak, që erdhi në Shqipëri për të ndihmuar në organizimin dhe përgatitjen profesionale të Ushtrisë shqiptare të viteve 1928-1944, ishte dhe Herman von Kirchneri, ose siç njihje ndryshe baroni Kirchneri. Por ky ushtarak austriak ndryshe nga atdhetari i tij Myrdac nuk pati fatin e tij tragjik.

-Çfarë risie solli lidhshipi ushtarak pas çlirimit të vendit?

Mbas çlirimit të vendit, ashtu sikurse folëm pak edhe në fillim të intervistës, formimi i ushtarakëve shqiptarë u bazua kryesisht në arsimimin e tyre në akademitë e ish BS deri sa u hodhën bazat për krijimin e një serie shkollash ushtarake të cilat luajtën pa dyshim rolin kryesor në përgatitjen e lidhshipit ushtarak me vlera ushtarake të pa diskutueshme për vendin, por që në prizmin doktrinar nuk kishin asnjë lidhje me strukturën që drejtë të ndërtohej në vend pas shëmbjes së komunizmit. Lufta e Ftohtë ashtu sikurse në shumë vende të lindjes sidomos mbas daljes nga Traktati i Varshavës çoi në bunkerizimin e vendit. Organizimi i fortifikimit ishte një punë kolosale, me shpenzime të jashtëzakonshme, pjesë e logjikës izoluese të regjimit. Ajo solli degradimin gradual të ish-Bashkimit Sovjetik, i cili kishte konsumuar mjaft nga energjitë e tij të brendshme, resurset ekonomike e teknologjike, kishte brejtur brënda tij gjithë strukturat si dhe kishte dëmtuar në planin e jashtëm aleancat satelitore. Këtë periudhë H. Kisinger e karakterizon me fjalët: "...Kurrë ndonjë fuqi tjetër botërore nuk është shpërbërë tërësisht dhe kaq shpejt, pa humbur në luftë". Edhe mbas çlirimit të vendit ishte Mehmet Shehu i cili ishte arsimuar në kolegjin e Napolit dhe Akademinë "Voroshilov". Ai ishte Kryeministri jetëgjatë i Shqipërisë deri në ditën që u vetvra, që shërbeu edhe si Ministër i Mbrojtjes, 1974-1981, po kështu edhe Kadri Hazbiu, si ministër në vitet 1982-1991, ishte arsimuar në Shkollën e Lartë të Sigurimit në ish-Bashkimin Sovjetik. Shqipëria është anëtarësuar në NATO, duke realizuar fitoren më të madhe të politikës shqiptare, por në këtë arritje një kontribut të madh kanë dhënë edhe FA të vendit, të cilat "de fakto", me praninë e tyre në misionet ishin prej kohësh pjesë e NATO-s, para se vendi të bëhej "de jure" i tillë. Ushtarakët shqiptarë kanë një përgatitje po aq të lartë sa ajo e vendeve të tjera të NATO-s.

-Si ka evoluar historia e lidhshipit ushtarak shqiptar dhe roli i tij në organizimin dhe drejtimin e Forcave të Armatosura parë në këndvështrimin e ditëve tona?

Ishte partneriteti midis Shqipërisë dhe NATO-s si dhe me vendet anëtare të saj, që rriti dhe intensifikoi bashkëpunimin politik dhe ushtarak, kontribuoi në angazhimin drejt parimeve të demokracisë dhe rritjes së stabilitetit, transparencës në buxhetin e mbrojtjes, thellimin e kontrollit demokratik në Ministrinë e Mbrojtjes, planifikimin e përbashkët, stërvitjet e përbashkëta ushtarake. Rol të veçantë luajti dhe pjesëmarrja direkte e ushtarakëve si në arsimim por veçanërisht pjesëmarrja direkte në operacione të përbashkëta duke

bashkëvepruar me forcat e NATO-s në fusha të tilla si paqëruajtja, operacionet e kërkim-shpëtimit dhe ato humanitare. Një nga vështirësitë e drejtimit në përgatitjen e trupave të këtij lloji, ka qënë mungesa e eksperiencës. Misionet e para paqëruajtëse e filluan përgatitjen në vitin 1995, kur pjesa më e madhe, ose gati gjithë drejtuesit ushtarakë ishin të arsimuar vetëm në shkollën shqiptare ushtarake, në një shkollë vërtet me karakteristika të spikatura, por krejt me koncepte doktrinale të tjera. Në ato kushte kërkohesh që të përballohej njëkohësisht si ngarkesa për përgatitjen dhe realizimin e misioneve të caktuara, por edhe të kaloheshin vështirësitë e reformimit të vazhdueshëm të ushtrisë. Në kujtesën tonë do të ngelen të paharuara fjalët e ish Presidentit Amerikan George Bush, i cili në Samitin e Bukureshtit me 3 prill 2008, tha se: "tre vendet ballkanike e meritojnë ftesën për t'u anëtarësuar, për rrugën e vështirë të reformave që kanë përshkruar, se, kanë ndërtuar shoqëri të lira dhe demokratike e do të japin kontributin e tyre në NATO". Pjesëmarrja në Aleancën më të madhe të të gjitha kohëve i dha siguri të madhe Shqipërisë, i dha liri më të madhe shqiptarëve, iu dha emër më të nderuar dhe lidhshipit të asaj kohe dhe atij aktual më shumë besim tek e ardhmja. Shqipëria, një vend neutral gjatë Luftës së Parë Botërore, sido që neutraliteti i saj nuk u respektua nga palët ndërluftuese, megjithëse nuk hyri në aleanca, nuk krijoi një traditë neutraliteti. Nga viti 1945 deri në themelimin e Traktatit të Varshavës, më 1955, Shqipëria nuk ishte anëtare e asnjë Aleance. Traktati i Varshavës është aleanca e vetme ushtarake ku Shqipëria ka aderuar. Anëtarësimin në Bllokun e Lindjes u ndërpre në vitin 1968, kur Bashkimi Sovjetik pushtonte ushtarakisht një vend anëtar të Traktatit të Varshavës, Çekoslovakinë. Pas vitit 1968 Shqipëria ishte një vend jashtë aleancave të mëdha e brenda izolimit të saj të mbushur me bunkerë në gjithë territorin e vogël, me ekonominë që asfiksohej dhe me liritë demokratike që gjithnjë e më shumë mungonin. Ndonëse gjatë 95 viteve ekzistencë si shtet, vetëm në 13 vite Shqipëria bëri pjesë në një aleancë ushtarake, por neutraliteti nuk hodhi kurrë rrënjë në ndërgjegjen e shqiptarëve. Pas ndërprerjes së marrëdhënieve me Kinën, Shqipëria nuk bëri pjesë në asnjë aleancë, deri në fillimin e viteve 90, kur shpalli se dëshiron të integrohet në NATO. Vendimi i vendeve anëtare të NATO-s, për të ftuar Shqipërinë i dha asaj mundësinë të finalizojë ato përpjekje dhe atë aspiratë mbarëshqiptare për anëtarësim në NATO. Ende, publiku shqiptar mbetet në treguesit më të lartë të mbështetjes së anëtarësimit të vendit në NATO dhe pjesëmarrjes në misionet e drejtura nga NATO jashtë rajonit. Sondazhet zyrtare nxjerrin një mbështetje rreth 89% të shqiptarëve për NATO. Që nga anëtarësimi zyrtar i Shqipërisë në NATO ka nisur të zbatohet plani i integritit që nënkupton reformimin e thellë të sektorit të sigurisë e mbrojtjes me qëllim ndërveprimin e plotë me NATO. Pjesë e këtij plani është paketa me 49 objektiva force të cilat janë marrë përsipër nga FASH si kapacitete operacionale të cilat vihen në dispozicion të NATO për misionet aktuale dhe të ardhshme. Thelbin e tyre e përbën "Grup batalioni i lehtë" i cili përfaqëson një "Task Forcë" me përbërje rreth 1000 veta. Në thelbin e saj është një batalion këmbësorie i lehtë, i motorizuar, i mbështetur edhe me njësi më të vogla (nivel kompanie apo toge) për shërbime zbulimi, mbështetje me zjarr, mbulim nga ajri, shërbim policie ushtarake etj. Aktualisht, FASH marrin pjesë në misionin ISAF të NATO në Afganistan në disa rajone si Herat (me kontingjentin italian), Kabul (me kontingjentin turk), Kandahar (në misionet speciale me kontingjentin amerikan.



BUXHETI 2022

Rama: Rritja e pagave me 30 për qind për Forcat e Armatosura do të ndihmojë në një performancë më të mirë

Kryeministri Edi Rama, në një takim me Forcat e Armatosura që kishte si qëllim diskutimin mbi buxhetin 2022 për Ministrinë e Mbrojtjes, tha se sot ushtria jonë nuk është më e fundit në NATO për nga pagat që marrin efektivet. Rama tha se rritja e pagave me 30 për qind për Forcat e Armatosura do të ndihmojë në një


performancë më të mirë, ndërsa tha se në 2022 do të nisë një mega-projekt për të kthyer ushtrinë në një model edhe për vende të tjera.

“Së pari dua t’ju them, meqë me jepet kjo mundësi, që jam ndjerë shumë mirë dhe krenar duke dëgjuar fjalë nga më mbresëlënëset prej gjeneralëve që ishin këtu dhe drejtuan misionin e madh, stërvitjen “Defender Europe 2021”, dhe re-

alisht ju nuk i keni dëgjuar në media se nuk kanë qenë për to, ishin fjalë admirimi për të gjithë ju dhe të tjerë të FA-së. Aktiviteti juaj zhvillohet jashtë syve të publikut, dhe duhet të kesh lidhje që ta kuptosh rëndësinë e sakrificave dhe vlerës që keni për atdheun.

Nga ana tjetër dua që sinqerisht t’i përshëndes familjet tuaja, sepse nuk ka asnjë punë të lehtë kur puna




Viti 2022 do të jetë fillimi i një megaprojekti për të kthyer ushtrinë në një model edhe për vende të tjera

është domosdoshmëria për të krijuar paralelisht me gjithë kapacitetin e gatishmërisë në terren me trupa dhe armë konvencionale”, -shtoi Rama. Sipas kreut të qeverisë, zhvillimet teknologjike nga Forcat e Armatosura do t'i shërbejnë edhe qytetarëve dhe vendit. Dhe për ta bërë këtë, Rama bëri me dije se ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi ka biseduar për të rekrutuar nëpër botë shqiptarët që punojnë si programues.

“Mundësia, potenciali dhe ambicia që ushtria jonë, gjithë sistemi i Ministrisë së Mbrojtjes, trupave tokësore të kenë në dispozicion një hapësirë ku të bëhet kërkim shkencor, duke iu dhënë mundësi vajzave dhe djemve në këto forca që të kenë mbështetje për të zhvilluar së brendshmi kapacitetet teknologjike të ushtrisë shqiptare. Dihet botërisht që sistemet e mbrojtjes janë sisteme ku janë bërë çudira nga pikëpamja teknologjike, që i kanë shërbyer pastaj gjithë vendit edhe gjithë botës. Ne pretendojmë që sistemi ynë i mbrojtjes t'i shërbejë vendit. Kemi folur me ministrin që Forcat e Armatosura të krijojnë një mekanizëm rekrutimi të këtyre talenteve shqiptare nëpër botë që punojnë si programues, kërkues shkencor në fushën e teknologjisë, për t'u vënë në dispozicion të kësaj hapësire të re në sistemin tonë të mbrojtjes”, -u shpreh ndër të tjera Kryeministri Edi Rama.

duhet bërë mirë, por puna juaj ka brenda dhe imponimin e një sakrifice shumë të madhe”, -tha Rama

“Më vjen mirë t'ju them se unë e shoh me optimizëm çdo ditë të nesërme të FA-së, sepse jo vetëm që do i krijojmë deri në fund mundësitë për të fituar nga koha e humbur por dhe për të zvogëluar hendekun me trupa të tjera të aleancës në aspektin e financave, kushteve dhe bonuseve që rrjedhin nga kontributi juaj.

Ne në aspektin e FA-së, me këtë rritje pagash, nuk kemi më ushtrinë më të pak paguar në NATO si fillim, nuk jemi as në krye as në mes dhe as nuk jemi më të fundit dhe ambicia është që brenda mandatit të tretë të jemi diku në mes, besoj bashkë do e arrijmë para, atë që do të marrim mbrapa nga ky investim. Ju e keni nderuar Shqipërinë dhe e keni vendosur qe-

verinë në pozitë që pavarësisht vështirësive që kemi, që lidhen qoftë me tërmetin apo edhe me krizën energjetike, kështu që e meritoni, se pavarësisht se ushtria në numër është modeste, ta rrisim në cilësi, që ushtria të jetë model. Tjetra ka të bëjë me bazën, hyrjen në rrugën ushtarake, dera e akademisë, dhe nuk mund të pretendojmë të jemi të mirë kur nuk kemi një bazë në lartësinë e asaj që meritojnë ata që regjistrohen aty, është inekzistente me atë që duhet të jetë për një ushtri në nivelin e NATO-s”, -u shpreh Kryeministri.

Do fillojmë në 2022 një megaprojekt me faza, e para do garantojë gjithçka sot duhet të ofrojmë, dhe pastaj dy faza që do të garantojnë ato që ne duam të plotësojmë. Do të ndërtojmë një akademi model cilësie. Pika tjetër

“Buxheti është rritur me 32.6 mld lekë më shumë”

Peleshi për FA: Historike dhe e prekshme një arritje e madhe ky buxhet, që është rritja 30% e pagave nga ushtari i parë te oficerët e gradave të larta

Objektivi është që në vitin 2024 të vendoset në dispozicion 2% e GDP. “Defender 23” do ketë vend pritës Shqipërinë!

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, gjatë prezantimit të buxhetit të viti 2022, tha se ky vit parashikon rritje për Forcat e Armatosura, rreth 32.6 mld lekë më shumë se ai i një viti më parë. Ai tha se objektivi i kësaj ministrie, kërkuar dhe nga NATO, është që në vitin 2024 buxheti të jetë 2% i prodhimit të brendshëm bruto.

Po ashtu, Peleshi tregoi se stërvitja e përbashkët e NATO-s “Defender 2023”, do të ketë vend pritës Shqipërinë, si dhe shtoi se qeveria ka parashikuar të rrisë buxhetin, e thënë në kuota buxheti i mbrojtjes është 32.6 mld lekë. Edhe më e madhe është rritja në zërin e investimeve, 102 % .

“Siç u tha dhe siç e dimë ne kemi angazhime buxhetore në aleancën tonë në NATO. Në vitin 2024 të gjitha buxhetet duhet të kapin shifrën e 2% të prodhimit të brendshëm bruto. Ne kemi depozituar në NATO një grafik mbi këtë ecure. Siç e shikoni, me 1.75% të GDP, ne i përmbahemi angazhimit që të jemi një vend dinjitoz në NATO. E cilësoj historike e të prekshme një arritje të madhe këtë buxhet, që është rritja e pagave nga ushtari i parë te oficerët e gradave të larta. Duke

pasur më shumë se 6 mijë përfitues. Është e freskët dita ku ne vlerësuam të gjithë pjesëmarrjen e efektivëve tanë, në emergjencën

e jashtëzakonshme të zjarreve të gushtit. Aty kryeministri ka bërë të njohur rritjen e pagave të ushtarakëve. Ne kemi arritur



në rritjen 30% të pagës, as unë nuk e prisja. Kështu që zoti kryeministër në emër të FA-së faleminderit.

Ne ju sigurojmë që do të ketë më shumë motivim në rekrutimet tona. Me këtë pagë dinjitoze, FA do të bëhet më e angazhuar për të rinjtë. Zyrat tona të rekrutimeve nuk janë në lartësinë e duhur. 65% është rritja për modernizim. Do të investojmë edhe në pikat tona të dobëta. Në të ardhmen me këto hapësira buxhetore duhet të ndreqim disa fusha ku kemi punë për të bërë, këtu e kam fjalën për gatishmërinë e forcave ajrore, fushore, duhet të gjejmë recetën e duhur për të pasur gatishmëri më të lartë, e për këtë kemi aplikuar së pari një bashkëpunim me një agjenci të NATO-s për mirëmbajtjen e helikopterëve. Duam ta shtrijmë këtë praktikë që na rezulton e suksesshme në të gjitha forcat tona. Duhet të aplikojmë "smart defense" duke koordinuar buri-met dhe blerjet me vendet mike, si Kosova, që është një vend i afërt me ne, jemi vëllezër e s'kemi çfarë t'i fshehim njëri-tjetrit. Unë kam bërë disa takime me homologët në rajon për të parë mundësinë e aplikimit të "smart defense". Me shumë gjasa edhe "Defender 23" do të ketë si vend pritës Shqipërinë. Kemi dalë me rekorde pozitive nga "Defender 21". Mbrojtja civile është ajo që na bën më të dukshëm, na sjell më pranë komunitetit. Jetojmë në një rajon të ekspozuar nga risqet ajrore. Ndaj na duhet të jemi më të shkathët dhe koordinues. Ky buxhet e reflekton këtë ambicë. 1.1 mld do të jetë transfertë e pa kushtëzuar për bashkitë. 800 mln të tjera do të jenë në dispozicion për bashkitë. Viti 2022 do të jetë viti ku do të jetësohet një projekt i konsiderueshëm i mbështetur nga Italia në fushën e emergjencës civile, ku do të përfitojnë edhe bashkitë që do të pajisen me mjete dhe burime financiare", -tha Peleshi.

Ministri Peleshi: Me buxhetin e vitit 2022 kemi parashikuar të shkojmë në 1,75 për qind

Ministri i mbrojtjes Niko Peleshi në projektbuxhetin e vitit 2022 parashtron qëllimet e Forcave të Armatosura për të arritur standartet e ushtrive të partnerëve të saj.

Në projektbuxhet parashikohet dhe rritja e pagave nga ushtari i parë te oficerët e gradave të larta deri në 30%.

Sipas ministrit të Mbrojtjes "Buxheti i MM ka një lloj veçantie, sepse ne kemi disa angazhime në NATO. Dhe kështu, sipas angazhimeve që kemi në këto struktura buxheti i MM i raportuar në NATO deri më 2024 duhet të pësojë një rritje graduale, sipas një grafiku të deklaruar, për të arritur në vitin 2024 në 2% të PBB. Sot jemi 1,47-1,48% të GDP. Me buxhetin e vitit 2022 kemi parashikuar të shkojmë në 1,75%; pra ky buxhet është 1,75 e PBB. Në 2023 do të shkojmë në 1,85% të PBB dhe në 2024-ën në 2%, duke përmbushur kështu edhe detyrimet në NATO".

"Detyrimi në NATO në raport në buxhetin nuk ka vetëm një shifër, nuk ka vetëm 2% ka edhe një shifër tjetër, që do të thotë: 20% e këtij buxheti duhet të përdoret për investime. Sa i përket kësaj shifres së dytë, ne e kemi kapur. Që në vitin 2021 përqindja e buxhetit të alokuar për investime është 20,46%. Në 22 shkon 31,38%. Pastaj 29% pastaj sërish 31,26%. Pra 50% me tepër se sa është kërkesa edhe detyrimi i raportuar në NATO." - theksoi z. Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes u shpreh se janë nëntë drejtime kryesore, ku është fokusuar detajimi i Buxhetit 2022:

1. Mbështetja për personelën;
2. Modernizimi dhe Infrastruktura;
3. Arsimimi dhe kualifikimi;
4. Gatishmëria dhe mirëmbajtja;
5. Stërvitjet;
6. Strukturat dhe angazhimet ndërkombëtare;
7. Mbështetja me mallra e shërbime dhe mbështetja administrative;
8. Mbrojtja Civile;
9. Operacionet brenda dhe jashtë vendit.

Z. Peleshi u shpreh se "projekti më i rëndësishëm në kuadër të infrastrukturës sonë është ndërtimi i Bazës Taktike të Kuçovës, që do të jetë një bazë taktike e NATO-s, investimi kryesor, realizohet nga fondet e NATO, tashmë të prokuruar nga Agjencia e Prokurimit të NATO-s në masën 40 milion euro. Së shpejti nisim punimet. Janë përzgjedhur nga NATO kontraktorët, ne na duhet të bëjmë, pra është detyrimi ynë të bëjmë një pjesë të punimeve, pra diçka më shumë se 10% përballohet nga buxheti ynë. Kemi gati projektin. Është parashikuar buxheti si e thashë edhe pak më lartë. Jemi në prag të fillimit të punës për ndërtimin e perimetrit të sigurisë. Si dhe punime të tjera si shpronësimet që janë detyrimi i Shqipërisë në këtë projekt."

Një tjetër investim për të cilin është menduar në buxhetin e vitit 2022 është edhe Akademia e FA. "Edukimi ushtarak është tani një prioritet për ne. Keni dëgjuar për Akademinë e FA dhe për përpjekjet për të ndërtuar partneritete të rëndësishme me Akademi të mirënjohura siç është Akademia Ushtarake e West Point-it në SHBA. Kemi zhvilluar një vizitë shumë të suksesshme me kryeministrin e vendit Rama dhe synojmë që të rimodelojmë Akademinë tonë sipas modelit të West Point-it", - tha Peleshi.

Në buxhetin e vitit 2022 janë parashikuar edhe mbi 20 milionë dollarë, ose 2,1 miliardë Lek për Emergjencat Civile, i cili do të ndahet në 1,1 miliardë si transfertë e kushtëzuar për bashkitë, sipas pesës specifike që buxheti i çdo bashkie ka në totalin e buxhetit vendor. Ndërkohë fondi prej 800 milionë lekësh për investimet në fushën e Mbrojtjes dhe parandalimit të emergjencave civile, i cili do të transferohet tek bashkitë për projekte, që do të seleksionohen nga një komitet që do të ngrihet dhe do të bëjë përzgjedhjen e propozimeve nga njësitë vendore.

Ministri i Mbrojtjes konfirmoi se pjesëmarrjen e misioneve të FA në kuadër të operacioneve të NATO-s, duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës në Kosovë apo në operacionet e BE-së në Bosnjë-Hercegovinë dhe Mali, OKB-së në Sudanin Jugor si dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndër marrë në Irak.

“Mbrojtja kibernetike”

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Sulmet kibernetike kërcënojnë të rrezikojnë thelbin e demokracive liberale, vullnetin e lirë të shoqërive moderne

“Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë humbur mjaft kohë në një sistem të gabuar para viteve ‘90, kështu që tani duhet të vrapojmë që të arrijnë vendet e përparuara në teknologji”

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi zhvilloi një vizitë zyrtare në Izrael. Bashkë me ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, morën pjesë në konferencën e nivelit të lartë, të organizuar nga IMPROVATE që u zhvillua në Jeruzalem. IMPROVATE është një organizatë që punon për avancimin e teknologjisë izraelite dhe që shërben njëherësh si një platformë për të lidhur liderët, vendim-marrësit apo investitorët me kompanitë e teknologjisë dhe inovacionit.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ishte folës kryesor në një nga panelet me temë: “Mbrojtja kibernetike”. Z. Peleshi theksoi faktin se vendet e Ballkanit Perëndimor kanë humbur mjaft kohë në një sistem të gabuar para viteve ‘90, kështu që tani duhet të vrapojmë që të arrijnë vendet e përparuara në teknologji. Ndaj ministri i Mbrojtjes, që në fillim të fjalës së tij, ftoi bizneset izraelite të kapitalit për sipërmarrje inovative. Ministri i Mbrojtjes tha se zhvillimet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit kanë sjellë përfitime të mëdha, por njëkohësisht sfida dhe kërcënime po aq të mëdha, çka e bën jetësore mbrojtjen dhe sigurinë kibernetike. Në këtë pikë, ministri kërkoi më shumë angazhim, bashkëpunim e koordinim më të madh ndërkombëtar, për të ofruar siguri kundër sulmeve kibernetike të çdo lloji.

“Vendet e zhvilluara sigurisht që do të

drejtojnë, por në të njëjtën kohë ato duhet t’i asistojnë, mbështesin dhe ndihmojnë të tjerët që të përparojnë dhe të krijojnë elasticitetin dhe mjetet e nevojshme në fushën kibernetike. Jemi dëshmitarë të shtimit të sulmeve kibernetike ndaj shërbimeve të infrastrukturës. Subjektet me qëllime keqdashëse po shfrytëzojnë përdorimin e internetit, i cili ka krijuar pika të cënueshme për sigurinë e tyre. Për më tepër, gjatë pandemisë, veçanërisht në vitin 2020, kaluam drejt punës në distancë. Kjo krijoi terren të pasur dhe tani është më e lehtë se kurrë për të ekzekutuar çdo sulm kibernetik”, - u shpreh ministri Peleshi.

Sipas Ministrit të Mbrojtjes, sulmet kibernetike kërcënojnë të sulmojnë thelbin e demokracive liberale, vullnetin e lirë të shoqërive moderne. Ai foli për përpjekjet që po bën qeveria shqiptare, e cila po investon gjithnjë e më shumë në inovacion, teknologji dhe infrastrukturë digjitale për të ofruar shërbime digjitale për qytetarët tanë.

“Si një aleat i NATO-s, Shqipëria gjithashtu nje hapësirë kibernetike si domenin e pestë të luftës, krahas tokës, detit, ajrit dhe hapësirës. Kështu, ne kemi krijuar në Forcat e Armatosura Shqiptare “Njësinë Ushtarake për Sigurinë Kibernetike” dhe mbështetemi te partnerët tanë strategjikë për ta zhvilluar më tej atë. Për më tepër, Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë synon të ndryshojë dhe të japë shembull duke krijuar qasje të re ndaj inovacionit, sinergji të re në fushat e kapaciteteve ushtarake, mbrojtjes civile dhe sigurisë kibernetike. Ne presim me padurim të ofrojmë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e zgjidhjeve inovative duke krijuar “ekosistemin e inovacionit” brenda Institucionit të Mbrojtjes”, - theksoi ministri Peleshi. Së shpejti Ministria e Mbrojtjes në Shqipëri do të marrë si pjesë të fushës së përgjegjësisë së saj politikbërjen dhe monitorimin e mbrojtjes kibernetike, duke u kthyer në institucionin qendror të politikave, rregullave, standardeve të mbrojtjes kibernetike, jo vetëm për hapësirën e sigurisë dhe mbrojtjes ushtarake, por edhe për të gjithë sistemet e tjera infrastrukturës kritike, private e publike.



“Shqipëria 109 vite shtet

Më 28 nëntor 1443 i madhi Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ngriti flamurin kombëtar në kalanë e Krujës. Ndërkaq, më 28 nëntor të vitit 1912, Ismail Qemali ngriti flamurin kombëtar në Vlorë dhe shpalli pavarësinë e Shqipërisë. Kjo ditë shënon pavarësinë e kombit shqiptar.

Pavarësia e Shqipërisë nga perandoria turke, mjerisht jo e të gjitha trevave shqiptare, u përgatit me vite e vite kryengritjesh, që filluan në viset e ndryshme Arbërore nga Malësia e Mbishkodrës, Mirdita dhe vende e vise tjera, për të përfshirë më vonë krejt Shqipërinë e atëherëshme. U desh fillimi i Luftës së Parë Botërore dhe shkatërrimi i perandorisë së xhonturqve, që shqiptarët të kurorëzonin ëndrrën e viteve për një Shqipëri “më vehte, të lirë e të mosvarme”. Kështu, më 28 nëntor t’vitit 1912, në Vlorë, u ngrit Flamuri dhe u hap Kuvendi historik Kombëtar me 37 delegatë, por u deshën vite të tjera dhe përfaqësi në Kongrese e në kancelaritë e vendeve



perëndimore, që Shqipëria të njihej si e tillë nga fuqitë e Shtetet e kohës. Prandaj, më 28 nëntor shqiptarët kujtojnë ngjarjen e 1912-tës q’ndodhi në Vlorë, ku u ngrit Flamuri Kombëtar i Kastriotëve, simbol i lirisë, i pavarësisë, i ëndrrave për një ardhmë më të mirë. Në të gjithë Shqipërinë, por dhe kudo ndodhen bashkëatdhetarët tanë famujt kuq

e zi u valvitën krenarë. Edhe Muzeu i Forcave të Armatosura si institucioni që dëshmon më së miri periudhat historike të luftës për liri dhe pavarësi, prej disa ditësh ka patur vizitorët e tij të vegjël, të cilët me shumë kërsheeri duan të mësojnë nëpërmjet pavioneve të muzeut historinë e atdheut të tyre, për të cilën ndër breza do ndihen krenarë.

Kontingjenti shqiptar në KFOR

Kontingjenti shqiptar në KFOR, nën drejtimin e kolonele Razije Mehmeti, përfaqësuesja më e lartë e FARSH në KFOR, si dhe Asistente e Shefit të Shtabit të KFOR (ACOS SPT), organizuan në Camp Film City, një pritje në nder të 109-të vjetorit të Pavarësisë dhe 77-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë. Të pranishëm në pritje ishin zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Luca Piperni, ministri i Mbrojtjes, z. Armend Mehaj, ambasadori i RSh-së në Kosovë, z. Qemal Minxhozi, atasheu i Mbrojtjes i RSh-së në Kosovë, kolonel Altin Kurti, gjeneralë dhe drejtues të lartë të Forcave të Armatosura të Kosovës dhe ushtarakë të lartë të kontingjenteve të Aleatëve që shërbejnë në KFOR.

Kolonele Razije Mehmeti përsëndeti dhe siguroi të ftuarit se Shqipëria do vazhdojë të kontribuojë krah për krah me Aleatët, për ruajtjen e sigurisë në botë. Në fjalën e tij përsëndetëse, gjeneral brigade Piperni vlerësoi lart rolin e Shqipërisë në misionet paqeruajtëse, duke u renditur përkrah aleatëve.

Ambasadori Minxhozi, ndër të

Kolonel Mehmeti: Shqipëria krah për krah me aleatët, për ruajtjen e sigurisë në botë



tjera, theksoi se shqiptarët janë popull paqedashës, ndaj dhe aspirata e tyre, vite më parë, për t’u anëtarësuar në NATO, ishte diçka e brendshme. E njëjta ndjesi vlen dhe për Kosovën, theksoi Ambasadori Minxhozi. Edhe Ministri

Mehaj u shpreh optimist lidhur me anëtarësimin e Kosovës në NATO, duke vlerësuar asistencën dhe vullnetin e Aleatëve. Krenarë për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kudo ku shërbejnë nëpër botë!

Bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Faleminderit për qasjen pozitive dhe mbështetjen e vazhdueshme që Maqedonia e Veriut po jep për shtetin e Kosovës

Bashkëpunimi midis dy vendeve, por edhe në kuadër të NATO-s, do të vazhdojë të luajë një rol mjaft të madh në sigurinë e rajonit si dhe për çështjet me interes të përbashkët

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj zhvilloi një vizitë zyrtare dyditore në Maqedoninë e Veriut. Gjatë vizitës së tij në Shkup, gjeneralmajor Begaj u takua me presidentin e Maqedonisë së Veriut z. Stevo Pendarovski, ministrin e Mbrojtjes znj. Radmila Shekerinska, si dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Vasko Gjurchinovski dhe ambasadorin e RSH, z. Fatos Reka.

Gjatë takimit me gjenerallejtënant Gjurchinovski u nënvizua rëndësia e bashkëpunimit dypalësh ushtarak, aktivitetet e përbashkëta të mbrojtjes, si dhe forcimi i mëtejshëm i këtij bashkëpunimi me pjesëmarrje në stërvitje dhe trajnime të përbashkëta. Të dy bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin qëndrim lidhur me rritjen e bashkëpunimit dypalësh ushtarak, sidomos në fushën e arsimimit, trajnimit dhe stërvitjes, mbrojtjes civile në rast emergjencash, por dhe zhvillimeve në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Në fokus të veçantë gjatë takimit ishte edhe ndërveprimi në iniciativat rajonale, si ajo Adriatik Charter A-5, SEDM, BCHODs, por edhe Qendra Rajonale për Marrëdhëniet me

Publikun.

Gjenerallejtënant Gjurchinovski gjatë takimit vlerësoi rolin e FARSH dhe lidërshiptin e saj gjeneralmajor Begaj, në rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes. Të dy shefat e shtabit ranë dakord për të rritur më tej këtë bashkëpunim midis dy forcave të armatosura.

Nga ana e tij, gjeneralmajor Begaj falënderoi ministrin e Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut për qasjen pozitive dhe mbështetjen e vazhdueshme që Maqedonia e Veriut po jep për shtetin e Kosovës.

Në takimet e tjera me presidentin e vendit z. Pendarovski dhe ministrin e mbrojtjes znj. Shekerinska, u diskutua për situatën e përgjithshme në rajonin tonë si dhe zhvillimet aktuale në mjedisin e sigurisë dhe të mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor.

Gjeneralmajor Begaj falënderoi të dy autoritetet politike për rolin e tyre dhe i siguroi ata për vendosmërinë e FARSH për të rritur dhe zgjeruar më tej bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes. Bashkëpunimi midis dy vendeve, por edhe në kuadër të NATO-s, do të vazhdojë të luajë një rol mjaft të madh në sigurinë e rajonit si dhe për çështjet me interes të përbashkët.





“Dita e Vëzhguesve”

Mbyllet me sukses stërvitja “Strong Eagle 3” e Regjimentit të Operacioneve Speciale dhe trupave britanike

Ka përfunduar me sukses stërvitja e përbashkët e forcave speciale shqiptare dhe atyre britanike, që u zhvillua në rajonet Zall-Herr, Bizë dhe Kepi i Palit. Stërvitja u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit me Britaninë e Madhe për vitin 2021. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte testimi i kapaciteteve taktike të Regjimentit të Operacioneve Speciale dhe në mënyrë të veçantë të Grupit Special të Operacioneve Tokësore (SOLGT), integrimi i reparteve dhe nënreparteve të ROS për të arritur ndërveprueshmërinë me njësitë speciale të Brigadës së Operacioneve Speciale të Mbretërisë së Bashkuar. Gjatë tri javëve të këtij trajnimi intensiv në rajone të ndryshme dhe skenarë variabël, efektivet testuan njohuritë e marra mbi procesin e vendimmarrjes dhe përgatitjes së urdhrave operacionalë, komandimkontrollin në nivel shtabi me njësitë vartëse, si dhe ndërtimin e komunikimit të sigurt në të gjitha nivelet. Në përmbyllje të stërvitjes, në



datë 12 nëntor 2021 në rajonin e Kepit të Palit, u zhvillua “Dita e Vëzhguesve” (Observer's Day) e stërvitjes “Strong Eagle 3”, në të cilën morën pjesë përfaqësues të Ambasadës Britanike të akredituar në Shqipëri si dhe ushtarake të lartë britanikë, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia si dhe përfaqësues të drejtorive në

Shtab të Përgjithshëm. Në skenarin e improvizuar të DVD u bë demonstrimi i aftësive dhe kapaciteteve operacionale të trupave ushtarake të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të FT-së dhe palës britanike. Komandanti i Forcës Tokësore falënderoi dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me palën britanike si dhe theksoi se ky bashkëpunim do të vijojë të thellohet edhe në të ardhmen.



CEREMONIA

Përfundon me sukses Kursi i 12-të i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes

Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes, u mbajt sot ceremonia e përfundimit të Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, ku morën pjesë zëvendëseshja e SHPFA, gjeneralmajore Manushaqe Shehu, komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të MM dhe SHPFA.

Ky kurs u zhvillua nga data 13 shtator dhe u mbyll më 26 nëntor 2021. Gjatë zhvillimit të kursit, pjesëmarrësit patën mundësi të merrnin leksione nga përfaqësues të lartë të trupit diplomatik të akredituar në vendin tonë dhe titullarë të institucioneve me fushë përgjegjësie, sigurinë dhe mbrojtjen. 11 ushtarakë të lartë dhe 5 civilë nga 7 vende të ndryshme si Shqipëria, Kosova, Bullgaria, Gjeorgjia, Greqia, Gjermania, Italia, ndoqën për rreth 3 muaj kursin që iu rezervohet ushtarakëve dhe civilëve me detyra të larta në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes. KLSM është kursi më i lartë institucional në hierarkinë e arsimimit të Forcave të Armatosura të RSH. Ky kurs synon të trajnojë ushtarakë me gradën kolonel/

nënkolonel ose civilë ekuivalentë me ta, jo vetëm nga institucionet e Sigurisë dhe Mbrojtjes së vendit tonë, por edhe nga vendet

e rajonit. Në fund të ceremonisë, u dorëzuan diplomat për të gjithë pjesëmarrësit që përfunduan me sukses kursin.

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, vizitë zyrtare në Rumani

Me ftesë të komandantit të Forcës Detare, kundëradmiral Mihai Panait të Rumanisë, komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, zhvilloi një vizitë zyrtare në Rumani. Në këtë vizitë zyrtare gjeneral brigade Xhebexhia shoqërohej nga atasheu ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Rumani kolonel Leonard Çoku. Gjatë vizitës në Rumani gjeneral brigade Xhebexhia zhvilloi takime me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral Daniel Petrescu dhe sekretaren e Shtetit për Mbrojtjen zonja Simona Cojocar u të Rumanisë. Gjatë takimit u nënvizua zhvillimi i bashkëpunimit në fushën e detarisë, situata e sigurisë si dhe angazhimet e dy vendeve në kuadrin e iniciativave rajonale. Gjatë takimit me komandantin e Forcës Detare kundëradmiral Panait, u diskutua bashkëpunimi i mëtejshëm mbi imbarkimin e kadetëve/oficerëve të rinj të Forcës Detare shqiptare në anijen shkollë të Forcës Detare Rumune "NS MIRCEA", vizita të ndërsjella midis Forcave Detare të dy vendeve, vizita portuale nga anijet e palës rumune në portet shqiptare, pjesëmarrja e përvitshme në stërvitjen "Sea Shield" në të cilën marrin pjesë dhe grupet e gatshme detare të NATO-s, si dhe trajnimin dhe edukimin në akademinë e Rumanisë. Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Xhebexhia, gjatë ditëve të qëndrimit në Rumani vizitoi portin ushtarak të Konstancës, fregatën "King Ferdinand", akademinë detare "Mircea cel Batran", Qendrën e stërvitjes, simulimit, vlerësimit dhe lojërave luftarake të Forcës Detare si dhe Muzeun Kombëtar të Rumanisë.

Kolonel Genci Petanaj: Akti heroik i pilotëve dhe teknikëve tanë që ne kujtojmë sot është shkruar me shkronja të arta

Në Bazën Ajrore Farkë, është organizuar një ceremoni përkujtimore me rastin e 32-vjetorit të rënies në krye të detyrës të pilotëve e teknikëve në misionin e tyre për të ndihmuar studentët e pedagogët e plagosur në aksidentin e ndodhur në Himarë. Për të përkujtuar këtë ngjarje, në ceremoni ishin të pranishëm shefi operacional i Forcës Ajrore kolonel Genci Petanaj, komandanti i Bazës Ajrore Farkë nënkolonel Julian Dulemata, përfaqësues të shoqatës "Familjet e Dëshmorëve të Aviacionit", përfaqësues të shoqatës së "Aviatorëve të Shqipërisë", veteranë si dhe shefa kryesorë e personeli ushtarak e civil të Bazës Ajrore Farkë. Fjalën e rastit në ceremoninë përkujtimore në emër të komandës së Forcës Ajrore e mbajti kolonel Genci Petanaj, i cili theksoi se: "Pilotët Agron Galanxhi, Tafil Agai, Vangjel Postoli, Veledin Resuli e teknikët Enver Haka, Pandeli Zhupa u nisën drejt misionit megjithëse u përballën me pabesinë më të egër të motit, luftuan me kurajo për të dalë nga ajo pritë e pabesë që natyra ju kishte zënë në majën e Llogorasë, ku erërat janë aq të forta, sa gjurmët e saj janë të gdhendura mbi gurë e drurë, simboli i së cilës është dhe pema flamur. Ata ranë gjatë kryerjes së detyrës, duke u bërë simboli i sakrificës në emër të humanizmit për të shpëtuar jetë. Ata janë krenaria e Forcës Ajrore dhe modeli i një brezi të ri të pilotëve që po rritet sot. Akti i tyre sublim i shërben atyre për të treguar që, profesioni i pilotit është i fisnik dhe i bukur, por i vështirë. Akti heroik i pilotëve dhe teknikëve tanë që ne kujtojmë sot është shkruar me shkronja të arta, jo vetëm në historinë e Forcës Ajrore, por edhe në memorien e popullit shqiptar", si dhe ftoi të pranishmit për të mbajtur një minutë heshtje në kujtim dhe nderim të tyre. Pjesëmarrësit në ceremoni vendosën kurora dhe tufa me lule në memorialin e Dëshmorëve në Bazën Ajrore Farkë si dhe në Varrezat e Dëshmorëve, ku prehen pilotët e teknikët e rënë në tragjedinë e 22 nëntorit të vitit 1989 në Llogora.



Ekipi ushtarak i Forcës Ajrore vizitë në Qendrën e Kontroll-Raportimit të Malit të Zi

Në kuadër të planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh, midis vendit tonë dhe Republikës së Malit të Zi, një ekip i Forcës Ajrore shqiptare, kryesuar nga shefi i Shtabit i Qendrës së Kontroll-Raportimit, nënkolonel Eduart Pllaha, zhvilloi një vizitë pune dyditore në Qendrën e Kontroll-Raportimit (QKR) të Malit të Zi.

Gjatë vizitës, ekipi i Forcës Ajrore zhvilloi takim me komandantin e QKR-së të Malit të Zi, ku fokusi ishte intensifikimi i bashkëpunimit ushtarak midis dy qendrave respektive të kontroll-raportimit, në kuadër të realizimit të policimit ajror nga NATO, si dhe shkëmbimin e informacionit mbi fluturimet e mjeteve ajrore dhe avionëve të NATO-s, të cilët realizojnë policimin ajror në hapësirat ajrore të vendeve përkatëse nëpërmjet rrjeteve të komunikimit dhe sistemit të integruar të komandim-kontrollit (ICC).

Gjithashtu ekipi i QKR-së u prit në takim edhe nga komandanti i Forcës Ajrore të Malit të Zi, nënkolonel Nenad Pavlović, i cili theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ushtarak dypalësh duke orientuar realizimin e stërvitjeve të përbashkëta sintetike (Computer Aided Exchange - shkëmbimit të informacionit me kompjuter), nëpërmjet koordinimit dhe drejtimit të Qendrës Shumëkombëshe për Operacionet Ajrore (Combined Air Operations Centre-CAOC), Torrejon si dhe realizimin e vizitave njohëse nga efektivët e këtyre njësive, por edhe mënyrat dhe procedurat e punës në përditshmërinë e tyre. Në fund të takimit komandanti i Forcës Ajrore të Malit të Zi shprehu dëshirën për realizimin e një vizite në komandën e Forcës Ajrore në të ardhmen, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës mbi modernizimin e Forcës Ajrore dhe rritjen e kapaciteteve për vëzhgimin e hapësirës ajrore, të cilin vendi ynë është duke e realizuar.

Intervistë me Kolonelin Arben Toska

Akademia e Nënoficerëve, 28 vite profesionalizëm dhe devotshmëri

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e sektorit të Botimeve

Më datë 05.11.1993, u hap Akademia e Nënoficerëve, misioni i së cilës ishte përgatitja e përqendruar e nënoficerëve të karrierës duke rikthyer një traditë të përherëshme dhe të konsoliduar.

Trajnimi i trupës së nënoficerëve e ka filluesën e saj në vitin 1919, ku u hap për herë të parë shkolla dhe kurset e nënoficerëve të cilët vijuan deri në vitin 1939. Në vitet 1950-1965 u hapën kurse të ndryshme të shërbimit për nënoficerë në komandat përkatëse.

Në vitin 2003, Qeveria Shqiptare i akordoi akademisë emrin e Kolonelit holandez Ludowik Thomson, duke e quajtur "Akademia e Nënoficerëve Thomson", në vlerësim dhe në respekt të veprës së shquar për kontributin e dhënë në Shqipëri, për përmirësimin e trupës ushtarake gjatë viteve 1911-1915, ku dhe vdiq në vendin tonë në krye të detyrës.

Në historinë e FARSH, hallka, pozicioni, dhe roli i nënoficerit të karrierës në përgjithësi është vlerësuar, por në periudha të ndryshme kohore vlerësimi është i ndryshëm. Kështu, në vitet 1912 - 1914, 1920 - 1966 dhe 1994 - 2002 nënoficeri ka pasur një rol të rëndësishëm në strukturën organizative dhe ka gëzuar një rol të dorës së parë në stërvitjen, menaxhimin, dhe komandimin e nënrepartëve, e më rrallë të repartëve të shkallëve të vogla taktike.

Pas vitit 1945 dhe deri nga mesi i viteve '60, në ushtrinë shqiptare vazhdonte të mbizotëronte mendimi i mëparshëm që të ruhej i njëjti konceptim në lidhje me numrin, rëndësinë dhe rolin e nënoficerëve në jetën dhe përgatitjen e repartëve dhe nën-



repartëve të saj. Me vlera ishte roli i tyre në stërvitjet e vogla. Por me heqjen e gradave nga viti '60 deri në '90 numri i nënoficerëve ra ndjeshëm. Pas viteve '60 nënoficerët merreshin në shërbim përmes një kontrate që nënshkruhej nga titullari i repartit përkatës dhe natyrisht pasi plotësonte disa kriterë.

Demokratizimi i jetës së vendit dhe transformimet e ristrukturimit e ushtrisë shqiptare pas viteve 90' sollën si domosdoshmëri të kohës themelimin dhe konsolidimin e përgatitjes së nënoficerit, dhe në nëntor 1993, me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, u krijua Akademia e Nënoficerëve.

Arsimimi, trajnimi dhe kualifikimi i trupës së nënoficerëve ka bërë një rrugëtim jo të lehtë ndër vite që prej fillimit të saj dhe konkretisht, shkollat e Nënoficerëve në Shqipëri nga viti 1912 - 2002 janë si më poshtë:

Viti 1919 - Shkollat e xhandarmërisë dhe aspirantëve për nënoficerë;

Viti 1925 - Shkolla e Nënoficerëve në Durrës, kishte 1 kurs çdo vit, me

kohëzgjatje 6 muaj;

Viti 1929 - Shkolla e Nënoficerëve për këmbësori, artileri, xhenio;

Viti 1931 - Shkolla e Perfeksionit të Nënoficerëve në Durrës, (Merrte nënoficerë nga ushtria pasi kishin kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak dhe i kualifikonte si nënoficerë karriere);

Viti 1950 - Shkolla e përgatitjes së nënoficerëve të Prapavijës, më pas u emërua Shkolla e Intendencës;

Në vitet '60, '70, '80 - U hapën shkolla të përkohshme për Artilerinë, Tanket dhe Xhenion në Elbasan.

Më pas, vazhduan shkolla të njëjta me kohë dhe programe të reduktuara për nënoficerë jo të karrierës, që përgatishnin nënoficerë jo me rrogë dhe që u ngritën pranë Korpuseve dhe Komandave të Forcës Detare, Mbrojtjes Kundër Ajrore, pranë Grupimit në Elbasan.

Mbi bazën e Shkollës së Instruksionit në Zall Herr, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, më 5.11.1993, u hap Akademia e Nënoficerëve.

Cili është misioni i QAPN (Aka-

demisë së Nënoficerëve)?

Misioni i Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve (ANO) është: "Formimi, kualifikimi dhe përgatitja e nënoficerëve të të gjithë niveleve të FARSH-së dhe personelin e mesëm civil të administratës, ekuivalent të nënoficerëve, si dhe bashkëpunon me strukturat e FARSH për specializimin e nënoficerëve.

Përgjegjësitë dhe detyrat themelore e Qendrës Arsimit Profesional të Nënoficerëve (ANO) janë:

- Zhvillimi dhe certifikimi i kurseve institucionale dhe funksionale;
- Hartimi i planeve dhe programeve mësimore;
- Testimi dhe përzgjedhja e kandidatëve për ndjekjen e kurseve sipas ligjeve në fuqi e kritereve të miratuara nga instancat eprore;
- Kualifikimi i personelit të mesëm civil të administratës në strukturat e FA-së;
- Testimi e përzgjedhja e kandidatëve për instruktorë pranë QAPN (ANO);
- Kryerja e studimeve dhe dhënia e ekspertizës në fushën e zhvillimit të personelit nënoficer në FARSH;
- Testimi/Certifikimi i nënoficerëve që përfundojnë fazën e dytë të kursit bazë dhe kursit të Avancuar pranë të gjitha Qendrave Stërvitore në Komanda dhe Repartet e FA-së;
- Bashkëpunimi me struktura të tjera në FA në interes të kualifikimit (specializimit) të personelit nënoficerëve.

Cili është koncepti i Arsimit Ushtarak Profesional dhe si realizohet ai?

Kurset mësimore organizohen dhe zhvillohen sipas kritereve të përcaktuara në dokumentin "Politika e Arsimit dhe kualifikimit të ushtarakeve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për përpunimin në gradë, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr.765 datë 08.06.2021.

QAPN trajtohet si strukturë varëse e AFA-së, në përputhje me ligjet, urdhrat dhe udhëzimet përkatëse për arsimimin ushtarak, parimet themelore të punës në institucion, për mënyrën e organizimit dhe drejtimit, zbatimin e konceptit të arsimit ushtarak profesional për nënoficerët në FA dhe të punonjësve të mesëm (C2) civilë, që kryejnë detyra, funksione në radhët e FA.

Cilat janë procedurat dhe kriteret për rekrutimin e nënoficerëve aktivë në Forcat e Armatosura?

Në kushtet e një profesionalizmi më

të lartë të FA-së dhe një angazhimi gjithnjë e më të madh në përmbushje të detyrave në mbrojtje të vendit dhe në interes të Aleancës, rekrutimi i nënoficerëve me një profil sa më cilësor është thelbësor, ka një impakt të rëndësishëm mbi të ardhmen e FA-së. Një gjë e tillë mund të arrihet nëpërmjet përsosjes së sistemit të përzgjedhjes dhe instrumenteve të vlerësimit, si dhe motivimit të tyre nëpërmjet pagës dhe mundësive për karrierë. Procedurat dhe kriteret që do të zbatohen nga strukturat përgjegjëse për përzgjedhjen e Ushtarit/Detarit të IV për ndjekjen e Kursit Fillestar të Nënoficerit. Sipas nenit 5, pika 5, të ligjit 59/2014, "nënoficer aktiv është ushtaraku i titulluar si i tillë me urdhër të SHSHP të FA"

Rekrutimi i nënoficerëve bëhet nëpërmjet konkurrimit të brendshëm. Në konkurrim mund të marrin pjesë vetëm ushtarët/detarët e IV-të që plotësojnë kriteret e përcaktuara. Struktura përgjegjëse për zhvillimin e testimit është AFA/Akademia e Nënoficerëve. Aplikimi bëhet pranë komandave ku ushtarët/detarët e IV-të kryejnë shërbimin, sipas formatit të kërkesës që tërheqin pranë zyrave të personelit të Forcave. Konkurrimi nuk është i hapur ndaj publikut jashtë FA-së. Pozicionet organike në TOP janë të hapura si për meshkujt dhe femrat. Preferohen kandidatët që kanë arsim të lartë dhe njohuri në gjuhët e huaja. Kriteret e konkurrimit për të ndjekur kursin fillestar të nënoficerit janë:

1. Ushtari/Detari i IV-të për të ndjekur Kursin Fillestar të Nënoficerit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) Në momentin e aplikimit, të ketë jo më pak se dy vite si ushtar/detar i IV-të;
 - b) Në momentin e aplikimit, të mos jetë më shumë se 32 vjeç;
 - c) Të jetë vlerësuar jo më pak se "mbi mesatar" në dy vlerësimet e fundit vjetore (vlerësimet i referohen vlerësimit të superiorit);
 - d) Të ketë kryer arsimin parauniversitar;
 - e) Të jetë vlerësuar kalues në testin e përgatitjes fizike;
 - f) Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
 - g) Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe 160 cm për femrat;
2. Zhvillimi i konkurrimit përfshin:
 - a) Testimin intelektual;
 - b) Testimin fizik;
 - c) Ekzaminimin mjekësor;
 - d) Testimin e njohurive në njohjen e gjuhës angleze;
 - e) Testimin psikologjik;

f) Vlerësimin e titujve të meritës.

Kriteret e përshkruara më lart duhet të plotësohen dhe mbahen deri në datën e fillimit të Kursit Fillestar të Nënoficerit, në të kundërt, kandidati ndërpret konkurrimin ose kursin.

Pranimi kryhet në bazë të Udhëzimit të MM Nr.03, datë 18.02.2016, "Për procedurat dhe kriteret për rekrutimin e nënoficerëve aktivë në FARSH", pika 15 "Procedurat e titullimit "nënoficer aktiv" dhe gradimin "nëntetar", germa b, "Në përfundim të kursit, Komandanti i QAPN-së, i përcjell SHSHP të FA, nëpërmjet Komandantit të AFA-së, propozimin për titullimin e kursantëve".

Cilët janë kurset që zhvillohen në Akademinë e Nënoficerëve?

Kurset që zhvillohen pranë Qendrës së Arsimit Profesional të nënoficerëve janë:

- Kurset Institucionale
- Kursi Fillestar i Nënoficerit, 5 javë në QAPN;
- Kursi Bazë i Nënoficerit, faza e parë 8 javë në QAPN dhe faza e dytë 8 javë pranë Qendrave Stërvitore në njësi e reparte;
- Kursi i Avancuar i Nënoficerit, faza e parë 8 javë në QAPN dhe faza e dytë 8 javë pranë Qendrave Stërvitore në njësi e reparte;
- Kursi i Lartë i Nënoficerit, 8 javë në QAPN;
- Kursi i Kryekapitit, 8 javë në QAPN.
- Kurset Funksionale
- Kursi i Administratës së Mesme Civile, 2 javë në QAPN;
- Kursi i Instruktorit, 3 javë në QAPN.

1. Kursi Fillestar i Nënoficerit (KFNO) ka si qëllim hedhjen e bazave për karrierën e nënoficerit, ofrimin e njohurive teoriko-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njësuarave me të, si dhe shikëputjen nga përgjegjësia individuale në aftësi dhe përgjegjësi si drejtues. Në këtë kurs marrin pjesë Ushtarë/Detarë IV, të cilët kanë rezultuar fitues në procesin e konkurrimit dhe përzgjedhjes. Përfundimi i këtij kursi është kriter për marrjen e gradës "Nëntetar".

2. Kursi Bazë i Nënoficerit (KBNO), ka si qëllim përgatitjen e drejtuesve në rol të komandantit të skuadrës në specialitetin përkatës. Ai u ofrohet të gjithë nënoficerëve që mbajnë gradën N/tetar, të cilët janë kualifikuar nga komisioni përkatës i karrierës për ndjekjen e këtij kursi. Kursi zhvillohet në dy pjesë:

2.1 Pjesa e parë (leadershipi) ka si qëllim zhvillimin e elementëve themelore të personalitetit të Tetarit,

si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe detyrave të njësuara me të, edukimin dhe përgjegjësinë ndaj detyrës dhe gatishmërisë luftarake, në zbatimin e urdhrave dhe forcimin e disiplinës vetjake. Kjo pjesë zhvillohet në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve dhe zgjat 8 javë.

2.2 Pjesa e dytë (specialitet) ka si qëllim përgatitjen me njohuri teorike, teknike, menaxhuese në një specialitet ushtarak, me aftësitë bazë drejtuese për komandimin e skuadrës në operacione. Ajo zhvillohet 8 javë pranë qendrave stërvitore në njësitë dhe repartet e FA-së, dhe zgjat 8 javë. Përfundimi i këtyre dy kurseve është kriter për marrjen e gradës "Tetar".

3. Kursi i Avancuar i Nënoficerit (KANQ), ka si qëllim përgatitjen e nënoficerit në rol të zëvendëskomandantit të togës në specialitetin përkatës. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerët me gradën "Tetar", të cilët janë kualifikuar nga komisioni përkatës i karrierës për ndjekjen e këtij kursi. Kursi zhvillohet në dy pjesë:

3.1 Pjesa e parë (lidhshipi) ka si qëllim zhvillimin e elementëve themelorë të personalitetit të "Rreshterit" si drejtues në rol të zëvendëskomandantit të togës dhe detyra të njësuara me të, zotëruar i teknikave të punës dhe ndihmës kryesor për stërvitjen e togës, si dhe zhvillimin e aftësive komunikuese dhe drejtuese. Kjo pjesë zhvillohet në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve dhe zgjat 8 javë.

3.2 Pjesa e dytë (specialitet) ka si qëllim përgatitjen e Tetarëve me njohuritë e nevojshme teorike, teknike, menaxhuese në specialitetin përkatës ushtarak, si dhe jep aftësi bazë drejtuese në rol të zëvendëskomandantit të togës ose detyra të njësuara me të. Zhvillohet 8 javë pranë qendrave stërvitore në njësitë dhe repartet e FA-së (në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve dhe zgjat 8 javë). Përfundimi i këtyre dy kurseve është kriter për marrjen gradës "Rreshter".

4 Kursi i Lartë i Nënoficerit (KLNO), ka si qëllim zhvillimin e elementëve themelorë të personalitetit të Kapterit si këshilltar i komandantit të nënrepartit ose repartit dhe detyrave të njësuara me të. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerët me gradën "Rreshter", të cilët janë kualifikuar për ndjekjen e kursit nga komisioni përkatës i karrierës. Zhvillohet në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve dhe zgjat 8 javë. Përfundimi i këtij kursi është kriter për marrjen e gradës "Kapter".

5. Kursi i Kryekapterit (KKK), ka si

qëllim zhvillimin e elementëve themelorë të personalitetit të Kryekapterit, si këshilltar i komandantit të forcës dhe njësisë dhe detyrave të njësuara me të. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerët me gradën "Kapter", të cilët janë kualifikuar nga komisioni përkatës i karrierës për ndjekjen e kursit. Kursi zhvillohet në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve dhe zgjat 8 javë. Përfundimi i këtij kursi është kriter për marrjen e gradës "Kryekapter".

Kurset funksionale në QAPN (ANO)

6. Kursi i instruktorit, kryhet në QAPN për një periudhë 3 javë. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerët me gradën tetar, rreshter. Kapter. Në këtë kurs marrin pjesë instruktorët të stërvitjes që shërbejnë në strukturat e Forcave të Armatosura.

7. Kursi i administratës së mesme civile, kryhet në QAPN për një periudhë 2 javë. Në këtë kurs marrin pjesë punonjësit të administratës së mesme civile që shërbejnë në strukturat e Forcave të Armatosura, në përputhje me kërkesat e funksionit organik të njehsuara me detyrën e nënoficerit.

Si realizohet përzgjedhja e kandidatëve, për t'u bërë pjesë e kurseve të Akademisë suaj?

Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve (ANO), është ushtaraku apo civili i cili frekuenton një kurs, në bazë të një akti administrativ për periudhën kohore të kursit përkatës të përcaktuar në dokumentin "Politika e Arsimimit dhe kualifikimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për përpunimin në gradë", miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr.765 datë 08.06.2021.

Procedurat dhe kriteret që do të zbatohen nga strukturat përgjegjëse për përzgjedhjen e Ushtarit/Detarit të IV për ndjekjen e Kursit Fillestar të Nënoficerit kryhet në përputhje me nenin 5, pika 5, të ligjit 59/2014, "nënoficer aktiv është ushtaraku i titulluar si i tillë me urdhër të SHSHP të FA". Në konkurrim mund të marrin pjesë vetëm ushtarët/detarët IV që plotësojnë kriteret e përcaktuara.

Kursi Bazë i Nënoficerit, Kursi i Avancuar i Nënoficerit, Kursi i Lartë i Nënoficerit, përzgjedhja e kandidatëve për ndjekjen e këtyre kurseve është objekt shqyrtimi i komisionit të zakonshëm të karrierës.

Kursi i Kryekapterit, përzgjedhja e kandidatëve për ndjekjen e Kursit Kryekapterit është objekt shqyrtimi i komisionit të lartë të karrierës.

Kursi i Instruktorit të Stërvitjes, përzgjedhja e kandidatëve për ndjekjen e kursit të instruktorit të stërvitjes bëhet me propozim të

komandave të forcave, njësisë dhe reparteve dhe miratim të SHSHP të FA-së.

Kursi i Administratës së Mesme Civile, përzgjedhja e kandidatëve për ndjekjen e kursit të Administratës së Mesme Civile bëhet me propozim të komandave të forcave, njësisë dhe reparteve dhe miratim të SHSHP të FA-së.

Cilat janë kurrikulat e implementuara në programin tuaj mësimor?

Hartimi i programeve mësimore në QAPN, është mbështetur kryesisht në dhënien e njohurive bazë kursantëve për të përvetësuar format dhe teknikat e drejtimit në nivele të ndryshme duke filluar nga niveli i grupit, e deri në atë të togës. Gjithashtu kursantët marrin njohuritë e duhura për teknikat, format dhe metodat e punës në shtabet e njësisë dhe reparteve.

Njëkohësisht, prioritet iu jepet implementimit në programet mësimore edhe të STANAG-ve, të cilat kryesisht konsistojnë në: Rregullore dhe Ligjshmëri, Operacionet luftarake dhe humanitare dhe ato paqeruajtëse, barazinë gjinore, Planin Kombëtar të kërkim-shpëtimit etj.

A ka pasur probleme në implementimin e koncepteve të arsimimit ushtarak profesional në kurset që ju zhvillonin? Nëse po, cilat janë ato?

Gjatë gjithë periudhës së funksionimit të këtij institucioni janë bërë rishikimet e programeve mësimore me qëllim implementimin e koncepteve të reja mësimore duke përditësuar dhe përmirësuar nivelin e tyre, mbështetur në mësimet e nxjerra nga kurset e zhvilluara, STANAG-ët e implementuar dhe sugjerimet e vendeve partnere.

Konkretisht, ne kemi propozuar dhe është miratuar zgjatja e programit mësimor të kursit të kryekapterit nga 4 javë në 8 javë, për arsye të zgjerimit të njohurive në disa fusha të cilat konsiderohen si domosdoshmëri për funksionet ku këto nënoficerë përgatiten për të shërbyer në të ardhmen si këshilltar të komandantit të reparteve dhe zotërimit të teknikave të punës në shtab.

Si ka ndikuar arsimimi dhe trajnimi i trupës së nënoficerëve për rritjen e tyre profesionale dhe si ka evoluuar kjo në vite?

Nisur nga kurset sipas niveleve, që zhvillohen në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerit si dhe eksperiencat që marrin gjatë kohës që ata ushtrojnë detyrën funksionale në reparte ku ata shërbejnë si dhe

informacionit të marrë nga komandat, vërehet një ndryshim shumë pozitiv në ngritjen e aftësive të tyre profesionale.

Nënoficeri i njohur si "shtylla kurizore e ushtrisë" është i përfshirë direkt në stërvitjen dhe trajnimin e trupave ndaj arsimit dhe kualifikimit të tyre këto vitet e fundit ka dhënë një impakt shumë pozitiv në rritjen e performancës së Komandave/njësisve ku ato shërbejnë.

Duke qenë se QAPN është i vetmi institucion arsimor për të gjithë korpusin e nënoficerëve në FA, çdo nënoficer, pas një periudhe 3-4 vjeçare, rikthehet përsëri pranë këtij institucioni për kryerjen e kurseve të radhës, për të marrë njohuri dhe dije të një niveli më lartë, e cila është një domosdoshmëri për ecurinë e tyre në grada dhe karrierë.

Gjithashtu dera e QAPN (ANO) është e hapur për secilin prej tyre, që kërkon ekspertizë në një fushë të

Siç dihet, duke filluar nga viti 2010, shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv filloi të aplikohet jo më mbi bazën e detyrimit, por mbi baza vullnetare, fillimisht si ushtar me pagesë ndërsa sot me emërtim "ushtar/detar aktiv".

Kalimi i Forcave të Armatosura nga ushtri aktive në ushtri profesioniste, është një risi dhe hap shumë pozitiv, pasi e gjithë eksperiencia e fituar ndër vite nga personeli ushtarak ushtar dhe nënoficer, ruhet kultivohet dhe implementohet në të gjithë brezat në FA.

Mundësinë që ofrojnë FA-të për një karrierë dhe jetë të sigurt për të rinjtë e të rejtat që dëshirojnë të bëhen pjesë e FA-së, anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në NATO, kalimi në një ushtri tërësisht profesioniste, ka krijuar hapësira dhe avantazhe për të gjithë shtetasit.

Kjo i ka bërë Forcat e Armatosura

e Arsimit Profesional të Nënoficerëve (ANO), nëpërmjet të cilëve mundëson, punonjësve civilë të FA-së, në përmbushjen e përgjegjësisë të funksionit organik.

Kursi i administratës së mesme civile. Në këtë kurs marrin pjesë punonjës të administratës së mesme civile që shërbejnë në strukturat e Forcave të Armatosura, në përputhje me kërkesat e funksionit organik të njehsuara me detyrën e nënoficerit.

Për herë të parë Kursi i administratës së mesme civile është hapur në vitin 2010 dhe deri tani janë arsimuar 77 personel i mesëm civil.

Si qëndron raporti mes mësimve teorike dhe stërvitjes praktike, duke ditur se kurset janë të niveleve të ndryshme?

Programi mësimor është i ndërtuar në mënyrë të tillë ku përqindja e teorisë dhe asaj praktike t'i përgjigjet vetë nevojave që kanë funksionet organike ku këto nënoficerë shërbejnë.

Konkretisht nëse do flasim për kursin fillestar dhe kursin bazë të nënoficerit, afërsisht 68% e këtij programi është trajnim/stërvitje (Praktikë) dhe 32% e zë pjesa teorike. Për kursin e Avancuar 58.3% është trajnim/stërvitje (Praktikë) dhe 41.7% pjesa teorike. Kursi i Lartë i Nënoficerit 64.2% Teori dhe 35.8% Praktikë. Kursi i Kryekapitullit, 80.08% Teori dhe 19.2% praktikë.

Sa i rëndësishëm është për një ushtarak profesionist arsimimi i tij?

Si në çdo profesion tjetër, edhe në atë të ushtarakut, arsimimi, përgatitja dhe kualifikimi i tij janë shumë të rëndësishëm duke e parë këtë në shumë dimensione.

Sfidat me të cilat përballen FA-të, vendi dhe gjithë Aleanca, janë në evolucion të përhershëm, sikurse duhet të jetë edhe arsimimi ushtarak, mënyra se si do të përballohen sfidat. Këto sfida na rrisin ndjeshmërinë dhe përgjegjshmërinë për misionin dhe rolin e FA-së, përfaqesin në adresimin e problemeve me të cilat përballemi, si dhe kërkesat e detyrat që duhet të përmbushë arsimimi ushtarak. Edukimi dhe trajnimi duhet të jetë komplementar e që shfrytëzon gjithë mundësitë që ofrojnë institucionet e ndryshme të FA-së dhe vetë forcat. "Sistemi i sotëm arsimor, është guri i themelimit të suksesit apo dështimit tonë, në të ardhmen. Arsimimi cilësor reflektohet në performancën, rritjen e kohëzimit social, mirëkuptimit dhe ndërveprimit efektiv mes vetë ushtarakëve dhe botës përqark".



caktuar.

Nisur nga historiku i ekzistencës së këtij institucioni arsimor/profesional për Nënoficerë ndër vite, QAPN (ANO) ka pësuar një ngritje dhe ndryshim rrënjësor pozitiv, qoftë edhe në mënyrën e organizimit, përzgjedhjes së personelit Instruktor.

Vlen të theksohet se i gjithë procesi mësimor në QAPN zhvillohet nga vetë nënoficerët çka tregon ngritjen e tyre nga ana profesionale.

Gjithashtu bashkëpunimi me vendet Aleate, konkretisht me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, SHBA, ka dhënë një rritje shumë cilësore në arsimimin dhe trajnimin e trupës së nënoficerëve, më e theksuar kjo në këto dy-tre vitet e fundit.

Çfarë do të thotë për ju kalimi i Forcave të Armatosura nga ushtri aktive në ushtri profesioniste?

të jenë më tërheqëse për të rinjtë e të rejtat, për faktin se nëse rekrutohesh dhe bëhesh pjesë e FA-së, përfitimet dhe mundësitë janë më të mëdha, pasi bëhet pajisja me një kontratë pune të rregullt dhe të sigurt, përfitohet shërbim shëndetësor falas për vete dhe familjen, krijohet mundësi arsimimi dhe kualifikimi brenda e jashtë vendit pa pagesë, fitohen aftësi të reja profesionale, bëhet pajisja me vlerën e ushtarit profesionist, i cili përfiton të gjitha të drejtat që parashikon Statusi i Ushtarakut të Republikës së Shqipërisë.

Në Akademinë e Nënoficerëve janë trajnuar jo vetëm nënoficerë por edhe punonjës të Administratës të Mesme Civile, sa është numri i tyre në këto 20 vite?

Kurset funksionale janë pjesë e sistemit të arsimimit që ofron Qendra

Barazia si koncept

Duket shumë e çuditshme se në femrat tani jemi përballur me humbjen e të drejtave të fituara në dekada më parë, dhe se ne kemi bërë shumë pak progres në marrjen këtyre të drejtave. Shoqëria jonë duhet të arrijë atë pikë, që femrat të vijnë në gjendje të jetojnë jetën që ato zgjedhin për veten e tyre, të kenë qasje në kujdesin dhe burimet për të qenë të shëndetshme dhe të qëndrueshme në kuadër të komuniteteve të tyre, të jenë në gjendje të përmbushin potencialin e tyre individual dhe krijues në bazë të dëshirave dhe kapacitetit të tyre, mos të kenë frikë nga burrat apo strukturat e ashpra politike në çdo aspekt të jetës. Duhet të punojmë së bashku kundër diskriminimit gjinor dhe të përqafojmë diversitetin, kultivimin dhe përdorimin e talenteve femërorë, përvojat unike kulturore dhe politike, aftësitë dhe angazhimin në solidaritet me femrat e tjera. Mendoj se feminizmi nuk ka vdekur, është i nevojshëm dhe ka potencialin për ta bërë botën një vend më human për të gjithë.

“Nga pikëpamja e së vërtetës absolute, ajo çfarë ndjejmë dhe përjetojmë në përditshmërinë tonë është një iluzion. Nga të gjitha llojet e iluzioneve, ndjesia e diskriminimit mes një qenie njerëzore dhe një tjetre, është forma më e keqe që nuk të krijon asgjë veçse një shije të hidhur pakënaqësie të thellë”.

Profesione në të cilat gratë ose burrat mund të punojnë deklarohen



“Çdo femër që më në fund e kuptoi vlerën e saj, ka marrë valixhet e saj të krenarisë dhe ka hipur në një fluturim drejt lirisë, i cili zbarkoi në luginën e ndryshimit”

Duhet të punojmë së bashku kundër diskriminimit gjinor dhe të përqafojmë diversitetin, kultivimin dhe përdorimin e talenteve femërorë, përvojat unike kulturore dhe politike, aftësitë dhe angazhimin në solidaritet me femrat e tjera.

në mënyrë gjuhësore, vetëm për burrat. Titujt e profesioneve si ministër, kryetar bashkie apo drejtor drejtorie mbeten ende në gjininë

mashkullore, në aktet zyrtare pasi në jetën e përditshme njerëzit përdorin të përdorin edhe gjininë femërore kur i referohen këtyre titujve. Megjithatë, përdorimi i një interpretimi të ngushtë gjuhësor në disa prej artikujve të kushtetutës bën që këto artikuj të shihen si neutral në terma gjinorë. CEDAW, i miratuar nga Shqipëria në vitin 1993, deklaron në nenin 11 se “palët duhet të marrin të gjithë masat e nevojshme për eliminimin e diskriminimit kundër grave në punësim, në mënyrë që atyre t’i ofrohen të njëjtat të drejta mbi bazën e barazisë ndërmjet burrave dhe grave”. Ndaj, gratë duhet të kenë të drejtën të zgjedhin lirisht profesionin dhe vendin e tyre të punës,

të kenë të drejtën të promovohen, të kenë siguri në punë, trajnim dhe përgatitje profesionale ndër të drejtat e tjera. Barazia gjinore mund të arrihet vetëm kur, si rezultat i aplikimit të ligjit, si burrat ashtu edhe gratë kanë të njëjtat përfitime, të drejta dhe përgjegjësi. Është e një rëndësie parësore të kuptohet se fuqizimi i grave dhe barazia gjinore nuk janë çështje të izoluar që i përkasin një gjinie, por kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të njeriut. Ndaj, diskriminimi ndaj grave duhet trajtuar si abuzim me të drejtat e njeriut,

Ligji nr. 9970, mbi barazinë gjinore në shoqëri, datë 24.07.2008, deklaron parimin kryesor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave në jetën publike dhe

private. Qëllimi i tij është garantimi i mbrojtjes së përshtatshme kundër diskriminimit me bazë gjinore; përcakton garancitë për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave për të eliminuar diskriminimin me bazë gjinore; përkufizon përgjegjësitë e organeve shtetërore në mbështetjen e barazisë gjinore; dhe përcakton mbrojtjen kundër diskriminimit dhe ngacmimit duke ofruar masa speciale për të garantuar të paktën 30% përfaqësim për gjininë më pak të përfaqësuar në pozicione politike apo publike vendimmarrëse. Më tej, ligji parashikon barazinë gjinore në arsimim, punësim dhe media. Ligji ka si qëllim kryesor "garantimin e mbrojtjes efikase kundër diskriminimit gjinor dhe çdo formë sjelljeje që inkurajon diskriminimin gjinor" si edhe "përcakton masat që ofrojnë mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave, duke eliminuar çdo formë diskriminimi gjinor".

Burri i fortë për mijëra vjet ka dashur ta ndërtojë botën përreth tij duke vendosur veten në qendër, pra ka ndërtuar sisteme racionaliste, të cilët krijohen dhe rrotullohen, vërviten rreth një aksi qendror vlerash. Kurse gruaja në tërë këtë histori ka synuar të nxisë e të hapë një hapësirë debati, për të bërë që edhe zëri i saj, i aktorit më të dobët të dëgjohet në shoqëri. Lëvizjet feministe kanë sjellë argument edhe për të ndryshuar hapësirën familjare. Ideologët e tyre, duke e pranuar se ndarja e familjes nga hapësira shoqërore, duke qenë një parakusht i demokratizimit të jetës, përsëri mbetet një rrethanë jo e mjaftueshme për të siguruar jetën dhe statusin e lirë të gruas brenda familjes. Familja duke u bërë një hapësirë autonome, në krahasim me shoqërinë, ligjet, shtetin, e hedh pas modelin totalitar të saj ku shteti ndërhynte në jetën intime të njerëzve. Por edhe demokratizimi është larg të qenit pa problemet e veta shumë të mprehta. Këtë qëndrim të ri kritik ne ia detyrojmë në radhë të parë lëvizjeve feministe. Sipas tyre edhe përvoja e vërtetohet se kështu ka ndodhur,

kur familja ia mbyll tërësisht derën shoqërisë, mediave, të drejtave të grave dhe kthehet në një hapësirë krejtësisht të pavarur deri në izolim, atëherë brenda saj del përsëri pushteti i më të fortit fizik, i burrit që nis të bëhet autoritar. Gratë dhe fëmijët kështu rrezikojnë të kalojnë nga një model i dhunës dhe i arbitraritetit shtetëror, në modelin e arbitraritetit mashkullor brenda një familje që gjoja quhet e demokratizuar, meqë hapësira e saj është bërë autonome, pra konsiderohet si hapësirë private.



Duke kërkuar që kjo situatë të përmirësohet, ideologët feministe jo vetëm e ruajnë autonominë e familjes, por edhe e konsiderojnë familjen si një hapësirë, ku sistemi i së drejtës mund të veprojë duke krijuar barazinë midis aktorëve familjarë që kanë krijuar familjen. Feminizmi është një mënyrë e re e të parit të botës. Është rasti që në kuadrin e përpjekjeve për t'i lënë gjithnjë e më shumë hapësira grave në jetën publike, të mendohet se mbi të gjitha ka vend të zhvillohet një këndvështrim më femëror mbi botën, më pluralist, më negociues, më pak përfaqësues dhe më shumë pjesëmarrës, për të pasur më pak

hierarki abstrakte nga lart poshtë, për një ligjërim publik më pak të vendosur mbi thirrjen burrërore "Kështu duhet!" gjithnjë e më e mbështetur mbi kërkesën femërore "Kështu dua!" Feminizmi nuk duket aq si një perspektivë që dëshiron ta bëjë gruan burrë në emër të barazisë gjinore, përkundrazi, shihet më shumë si një mekanizëm, me anë të të cilit burri të "feminizohet" në shumë kuptime dhe të dyja gjinitë të bëhen komplementare, jo nëpërmjet humbjes së dallimeve dhe barazisë mekanike, por nëpërmjet

zhvillimit të specifikave brenda një bote të larmishme.

1. Përse forcat e armatosura kanë nevojë për gra dhe diversitet? Në mbarë botën, forcat e armatosura janë duke e njohur kontributin e rëndësishëm që gratë japin në radhët e tyre, dhe fakti i rritjes së përfaqësimit të personelit të gjinisë femërore në të gjitha gradat është themelor për aftësinë dhe efektivitetin operacional në të ardhmen. Derisa sigurimi i mundësive të barabarta për gratë dhe burrat është detyrim ligjor për forcat e armatosura, forcat gjithashtu e njohin nevojën për të joshur burra dhe gra nga më të

mirët dhe më të talentuarit. Kur forcat e armatosura dështojnë të shfrytëzojnë 50 për qind të talentit të fuqisë punëtore për shkak të pamundësisë për t'i joshur gratë, dhe kur nuk arrijnë që t'i mbajnë gratë që i kanë trajnuar dhe zhvilluar, forcat rrezikojnë të përballen me boshllëqe në aftësinë e tyre. Për më tepër, përvoja operative e kohëve të fundit, për shembull në Afganistan, ka treguar se personeli i gjinisë femërore sjell përfitime të veçanta operative, siç janë kontaktimi në terren i komunitetit.

2. Gjinia dhe Mekanizmat për Ankesa e informatave të inteligjencës

Organizatat me personel të larmishëm në aspektin e gjinisë, përkatësisë etnike, orientimit seksual, kualifikimeve dhe karakteristike tjera, janë më të efektshme. Studimet demonstrojnë se ekipet e larmishme dhe të balancuara gjinore japin rezultate më të mira, veçanërisht kur inovacioni dhe zgjidhja e problemeve janë të rëndësishme. Forcat e armatosura të larmishme kanë një gamë të gjerë të aftësive dhe përvojës për t'u përballur me sfidat e mjedisve gjithnjë e më komplekse dhe fluide të mbrojtjes. Për më tepër, është parim i rëndësishëm që një forcë e armatosur duhet të jetë përfaqësuese e shoqërisë të cilës i shërben. E drejta për të shërbyer në forcat e armatosura është aspekt i së drejtës së personit për pjesëmarrje të plotë si qytetar. Në trajtimin e barrierave të pjesëmarrjes së plotë të grave në forcat e armatosura, një prioritet kyç duhet të jetë parandalimi i diskriminimit, ngacmimit, bullizmit dhe abuzimit me bazë gjinore - me fjalë të tjera, për t'u siguruar që i gjithë personeli, burra dhe gra, shërbejnë në një mjedis që është i shëndetshëm, i sigurt dhe i respektueshëm, dhe i mbështet të drejtat e tyre të njeriut. Mekanizmat efektivë dhe të besueshëm të ankesave janë komponentë të rëndësishëm të një ambienti të tillë. Ekspozimet në media dhe skandalet tregojnë

rreziqet për besueshmërinë dhe respektin ndaj institucioneve ushtarake, kur mekanizmat e parandalimit dhe ankesave nuk janë të efektshme. Një gjë jo aq e dukshme, por e rëndësishme është se gratë dhe burrat të cilët largohen nga ushtria si pasojë e diskriminimit, ngacmimit, bullizmit apo abuzimit, ndihen të tradhtuar dhe në disa raste, i bartin vragat gjatë gjithë jetës së tyre. 3. Gjinia është bërë një shprehje që diskutohet shumë në kuadër të NATO-së, e cila ka zhvilluar politika dhe udhëzime rreth integritit të perspektivës gjinore në operacione, dhe në një numër të forcave të armatosura. Megjithatë, shumë njerëz nuk janë të sigurt se çka do të thotë "gjinor", apo supozojnë gabueshëm se ajo ka të bëjë vetëm "me gratë". Po kështu, edhe pse barazia gjinore nuk është koncept i ri, ajo shpesh përzihet se çka ajo lejon dhe kërkon në aspektin e veprimit afirmativ për përfitim të grave. Kjo pjesë fokusohet në sqarimin e terminologjisë së re në lidhje me gjininë dhe forcat e armatosura, duke filluar me një diskutim të shprehjes "gjinor" dhe "perspektivë gjinore", dhe projektim të marrëdhënive në mes të "perspektivës gjinore" dhe detyrimeve e zotimeve të forcave të armatosura ndaj barazisë gjinore.

Barazia si koncept?

Barazia mes burrave dhe grave kërkon jo vetëm barazi formale (de jure) - se gratë dhe burrat duhet të trajtohen njëjtë; por barazi substanciale (de facto) - se grave dhe burrave duhet t'iu jepen mundësi të barabarta dhe të fuqizohen nga një mjedis i përshtatshëm për ta arritur barazinë e rezultateve.² Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas kërkon që shtetet - dhe Forcat e Armatosura, si pjesë e shtetit - të ndër marrin hapa për ta siguruar zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave dhe realizimin e plotë të të drejtave të grave, duke e përfshirë edhe barazinë e mundësive të grave dhe burrave. Kjo do të thotë se nuk mjafton që grave t'i garantohet trajtimi identik me burrat; dallimet

e ndërtuara biologjike, shoqërore dhe kulturore ndërmjet grave dhe burrave duhet të merren parasysh, të cilat mund të kërkojnë trajtim jo identik për t'i trajtuar këto dallime.

• Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave në mënyrë specifike thotë se shtetet duhet t'i krijojnë kushtet e nevojshme për gratë që t'i "zhvillojnë aftësitë e tyre personale, ta ndjekin karrierën e tyre profesionale dhe të bëjnë zgjedhje pa kufizimet e vendosura nga stereotipet, rolet e ngurta gjinore dhe paragjykimet". • Inkurajohet shfrytëzimi i veprimeve afirmative (i quajtur edhe "veprim pozitiv") si mjet për ta realizuar barazinë substanciale midis burrave dhe grave.

Disa ushtri i kanë përdorur shprehjet "neutrale gjinore" ose "i verbër gjinor" për të treguar se nuk ka rëndësi nëse je grua ose burrë - të gjithë trajtohen njëjtë dhe i ndajnë mundësitë e barabarta si pjesëtarë të ushtrisë. Duhet të rekomandohet gjuha neutrale gjinore: për shembull, duke iu referuar personelit si "ai/ajo" ose "ata/ato" e jo vetëm "ai". Megjithatë, kur është fjala për zhvillimin e politikave, të qenit "neutral gjinor" ose "i verbër gjinor" thjesht i mjegullon barrierat e rrënjësura strukturore ndaj mundësive të barabarta të grave. Efektiviteti operacional kërkon ekspozim dhe heqje të pengesave të tilla. Për ta shmangur diskriminimin, duhet analizuar në mënyrë aktive se si politikat dhe praktikat e ndryshme kanë gjasa që të ndikojnë mbi burrat dhe gratë, dhe të formësohen ndërhyrjet në përputhje me rrethanat për ta promovuar barazinë.

Çka kërkon "barazia gjinore" sa i përket testeve të performancës? Shumë forca të armatosura kanë bërë përpjekje për t'i vendosur testet e qëndrueshmërisë fizike që janë të drejta për burrat dhe gratë, dhe si e tillë kjo çështje kërkon vëmendje të veçantë. Barazia gjinore nuk do të thotë ulje të standardeve, ku këto standarde do të ishin të përshtatshme për rolin në fjalë. I gjithë personeli duhet të jetë i aftë

që në çdo kohë ta realizojë një gamë të gjerë të detyrave të përgjithshme ushtarake, përveç detyrave specifike që lidhen me profesionin e tyre. Testet duhet të bazohen mbi qëllimin e ligjshëm të punës, që është vlerësimi i aftësive dhe kualifikimeve në nivelin e nevojshëm për të qenë në gjendje për ta kryer punën me sukses. Nëse gratë largohen në numër më të madh nga një vlerësim i veçantë, atëherë duhet parashtruar pyetjet e mëposhtme.

- A është shkathtësia ose aftësia, që po vlerësohet në fakt, e nevojshme për pozicionin për të cilin ka aplikuar personi? • Nëse është e nevojshme, a ka ndonjë mënyrë alternative për të.

Gjinia dhe mekanizmat e vlerësuar në një kandidate femër i ka aftësitë ose kualifikimet, që nuk i vë gratë në pozitë jo proporcionalisht të pafavorshme?

- Nëse nuk ka ndonjë mënyrë alternative për vlerësimin e aftësive ose kualifikimeve, a është minimizuar ndikimi negativ mbi gratë në masën më të madhe të mundshme? Për shembull, disa njësi ushtarake në të cilat gratë e kanë konsideruar më të vështirë për t'i përmbushur kërkesat e fitnesit fizik, a vijnë gratë trajnimin disa javë më herët për t'ua ofruar atyre trajnimin e fitnesit fizik para kursit. Të tjerët ofrojnë trajnime të fitnesit fizik vetëm për gra, që rrjedh në ritëm pak më të ngadalshëm, por e arrijnë të njëjtin standard në fund të kursit (që ilustron se udhëzimi "i përgjithshëm" fizik iu është përshtatur aftësive fizike të meshkujve). Zhvillimi i testeve të fitnesit fizik mund të kërkojë një baraspeshë "diskriminimin pozitiv", siç janë kuotat për gratë.

- Diskriminimi në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor, është trajtimi i padrejtë apo dallimi arbitrar në bazë të orientimit aktual apo të perceptuar jo-heteroseksual seksual të një personi (për shembull, të qenit lezbike, gej ose biseksual), ose në bazë të asaj se si personi e identifikon dhe e shpreh gjininë e vet në aspektin e

paraqitjes, manierizmit dhe sjelljes. Diskriminimi në bazë të identitetit gjinor përfshin (por nuk kufizohet vetëm në) diskriminimin kundër një personi i cili është transgjitor - do të thotë personi vetë-identiteti i të cilit nuk përputhet qartë me nocionet konvencionale të gjinisë mashkullore apo femërore. Edhe pse forcat e armatosura e të paktën 50 vendeve kanë politika të qarta. Aplikimi i perspektivës gjinore në mekanizmat e ankesave që konfirmojnë se personat lezbike, gej dhe biseksualë mund të shërbejnë, dhe së paku 18 shtete (duke përfshirë 11 anëtarë të NATO-së) i lejojnë personat transeksualë që të shërbejnë. Mbesin edhe forca të armatosura, ku të gjitha pozicionet janë të mbyllura për personat lezbike, gej, biseksualë dhe transeksualë (LGBT).

- Ngacmimi seksual, zakonisht përkufizohet brenda politikave institucionale. Një përkufizim tipik është: ...çdo avancim i padëshirueshëm seksual, kërkesë për favor seksual, sjellje verbale apo fizike apo gjest i natyrës seksuale, ose çdo sjellje tjetër e natyrës seksuale që në mënyrë të arsyeshme pritet ose perceptohet se i shkakton ofendim ose poshtërim personit tjetër, kur ajo sjellje ndërhyr në punë, bëhet kusht për punësim, ose krijon një mjedis frikësues, armiqësor ose ofendues pune. Ngacmimi seksual njihet si problem në shumë forca të armatosura, jo vetëm që shkelin të drejtat e viktimave, por e dëmtojnë kohëzimin, disiplinën dhe moralin. Në shumicën e forcave të armatosura është shkelje disiplinore ose penale, varësisht nga pesha e aktit. Gratë në përgjithësi janë në rrezik më të lartë për t'u ngacmuar seksualisht sesa burrat, ku shumica e rasteve kryhen nga një koleg mashkull apo nga komandanti. Megjithatë, viktimat dhe kryerësit mund të jenë burra dhe gra. Për shembull, Anketa e vitit 2012 për klimën e ushtrisë finlandeze gjeti se 14 për qind e rekrutëve burra dhe 35 për qind e rekruteve gra kanë përjetuar

ngacmim seksual gjatë shërbimit të tyre. Një studim anonim i personelit të ushtrisë britanike gjeti se 12 për qind e grave dhe 6 për qind e burrave thanë se dikush kishte bërë përpjekje të padëshirueshme për t'i prekur

- Ngacmimi në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor, gjithashtu është problem në forcat e armatosura. Megjithatë, ngacmimi i tillë nuk është as universal e as i pashmangshëm. Kur Kanadaja dhe Mbretëria e Bashkuar (MB) e hoqën ndalesën për homoseksualët dhe lezbiket që të shërbejnë në forcat e armatosura, frika se kjo do të rezultojë në rritje të nivelit të ngacmimeve dhe bullizmit nuk u jetësua. E DIVERSITETI E FORCON AFTËSINË USHTARAKE

Edukimi dhe trajnimi, normat ndërkombëtare diktojnë që personeli ushtarak duhet të marrë pjesë në trajnim dhe edukim për të drejtat e njeriut, të drejtat gjinore dhe çështjet e diversitetit të përshtatshme për përgjegjësitë e tyre udhëheqëse. Për t'i ndërtuar njohuritë dhe aftësitë për parandalim të sjelljeve të pahijshme që i kanë shkakuar ankesat me bazë gjinore dhe, më gjerësisht, për ta promovuar një kuptim dhe përkushtim për barazinë gjinore në ushtri, duhet të realizohen një gamë e iniciativave të edukimit dhe trajnimit. Çështjet gjinore nuk duhet të trajtohen në mënyrë të izoluar: çdo trajnim dhe edukim duhet të rishikohet për t'u siguruar se çështjet përkatëse gjinore janë adresuar në tërësi. I gjithë personeli ka nevojë për trajnim, duke filluar nga rekrutimi dhe trajnimet e rregullta azhurnuese për temat në vijim. • Barazia, diversiteti dhe standardet e mirësjelljes. • Përdorimi i moderuar dhe i përgjegjshëm i alkoolit, pasi që teprica lidhet shpesh me sjelljen e pahijshme.

Në emër të jetës, vlerave morale, integritetit profesional, fuqisë për të ndryshuar botën, me fizik të brishtë por vitalitet të madh jemi ne, Femrat!...



PLANIFIKIM, LËVIZJE DHE MIRËMBAJTJE E FORCAVE USHTARAKE

Komanda Mbështetëse e FA-së, krijimi dhe transformimi

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Në vend të hyrjes, në fillim të këtij shkrimi do të doja të përmendja se ndërsa termi “logjistikë” mund të përfshijë kuptime të ndryshme, në thelb ka të bëjë me të pasurit gjënë e duhur, në vendin e duhur, në kohën e duhur. Logjistika përkufizohet si shkencë për planifikimin dhe kryerjen e lëvizjes dhe mirëmbajtjes së forcave. Ajo është e një rëndësie jetike për çdo operacion ushtarak dhe pa të, operacionet nuk mund të kryhen dhe të mbahen. Logjistika mund të shihet si urë lidhëse midis forcave të dislokuara dhe bazës in-

dustriale, e cila prodhon materialin dhe armët që i nevojiten FA-së për të përmbushur misionin e saj. Transformimi i përhershëm i sistemit të Forcave të Armatosura në të njëjtën kohë gjeneroi modernizimin e ushtrisë dhe logjistika në vetvete u perceptua jo vetëm si pika qendrore e së ardhmes së veprimeve ushtarake, por edhe si pikë mbështetëse për forcat që zhvillojnë përpjekjen për t’u trajnuar dhe përgatitur në paqe me të njëjtën logjistikë e mbështetje dhe në të njëjtat kushte si në fushën e betejës. Mbështetja me logjistikën e nevojshme e FA-së nga ana tjetër, është vazhdimisht në zhvillim e sidomos edhe për shkak të ndryshimeve moderne të teknikës luftarake dhe

veprimeve ushtarake shumëkom-bëshe. Për këtë arsye, mbështetja e FA-së zhvillohet në mënyrë të ngjashme, shpejt dhe me efikasitet. Komanda Mbështetëse është pikërisht ajo që përshtat kapacitetin dhe aftësinë e saj operative sipas nevojës, për të mbështetur objektivat e Strategjisë Ushtarake, në përputhje me prioritetet, për të siguruar mbështetjen e duhur dhe në kohë të forcave. Komanda Mbështetëse, si forca e pestë e Forcave tona të Armatosura, ka një mision tepër të rëndësishëm për ushtrinë shqiptare siç është sigurimi i kapaciteteve për mbështetjen me logjistikë, infrastrukturë, shërbim shëndetësor dhe shërbime të tjera të FA-s në interes



Logjistika
përkufizohet
si shkencë
për
planifikimin
dhe kryerjen
e lëvizjes dhe
mirëmbajtjes
së forcave.

njësitë e mbështetjes logjistike të FA-së, ndërkohë sot, në një rrugëtim të gjatë, 74 vjeçar, por tashmë nën një modernizim të vazhdueshëm, përpiqen të jenë në gjendje të përm-bushin kërkesat për të mundësuar mbështetjen logjistike të operacioneve ushtarake në çdo lloj mjedisi. Duke kthyer kokën pas, Komanda e Mbështetjes shënon datën e parë historike të saj 14 nëntorin e vitit 1947, me krijimin e Depos Qendrore të Intendencës, por që në vitin 1948, Depoja Qendrore e Intendencës do të emërtohej Magazinat Qendrore të Ushtrisë dhe vetëm një vit më vonë, pikërisht në vitin 1949, Magazinat Qendrore të Ushtrisë, do të emërtoheshin Reparti me numër 8770, numër të cilin e mbajtën deri në vitin 1993. E në vitin 1993, Magazinat Qendrore të Ushtrisë, emërtohen Bazat e Furnizimit të Ushtrisë në Tiranë, Elbasan, Berat dhe Rrëshen dhe në vitin 2000, krijohet Komanda e Mbështetjes Logjistike, e cila mori në përbërje dhe Bazat e Furnizimit të Ushtrisë. Në vitin 2003, në kuadër të riorganizimit të Komandës së Mbështetjes Logjistike, Bazat e Furnizimit të Ushtrisë në Tiranë, Elbasan, Berat dhe Rrëshen, suprimohen dhe mbi bazën e tyre krijohet Brigada e Furnizimit të Ushtrisë. Viti 2007, do të ishte koha kur Komanda e Mbështetjes Logjistike, do të riorganizohej në Komandë Mbështetëse me përbërje, Brigadën Logjistike (krijuar nga suprimimi i Brigadës së Furnizimit dhe Brigadës së Transportit), Regjimentin e Mbështetjes së SHP, Regjimentin e Infrastrukturës, Qendrën e Personel-Rekrutimit, Spitalin Ushtarak Qendror Universitar dhe Batalionin e Policisë Ushtarake. Ishte viti 2010, kur mbi bazën e urdhrit të shefit të SHP të FA-së, nr. 31 datë 24.02.2010, Komanda Mbështetëse suprimohet dhe mbi bazën e saj riorganizohet Brigada Logjistike. Ndërsa në vitin

të plotësisht të misionit të tyre kushtetues si dhe sigurimin e kapaciteteve të nevojshme operacionale për kryerjen e operacioneve luftarake, emergjencave civile, kërkim-shpëtimit, operacioneve humanitare dhe ato në ndihmë të komunitetit në bashkëpunim me strukturat e tjera të FA-së. Të konsoliduar tashmë, këtë forcë e kemi parë tekса siguron në çdo kohë aftësi operacionale dhe gatishmëri luftarake në kapacitetet e nevojshme, për t'iu përgjigjur, sfidave, kërcënimeve dhe rreziqeve të kohës. E kemi parë tekса kryen detyrat e saj kur mbështet aktivitetet e FA-së të RSH me klasat e furnizimit dhe me shërbimet logjistike, kur ka siguruar kapacitetet e nevojshme operacionale për kryerjen e operacioneve luftarake, (stërvitjet), emergjencave civile, kërkim-shpëtimit, operacioneve humanitare dhe ato në ndihmë të komunitetit në bashkëpunim me strukturat e tjera të FA. KM ka siguruar gjithashtu kapacitete të nevojshme operacionale për përmirësimin e infrastrukturës së FA-së, por edhe kapacitetet e nevojshme operacionale për kërkimin, zbulimin, çminimin dhe asgjësimin e municioneve të rrezikshme dhe lëndëve plasëse të zbuluara në vend apo dhe mbështetje të strukturave të FA-së me riparime, e mirëmbajtje

të mjeteve motorike tokësore, në operacione dhe stërvitje apo në sfidat e emergjencës civile, si përmbytjet dhe zjarret e kohëve të fundit në vend. E rëndësishme për t'u përmendur është edhe mbështetja me transport e strukturave të FA-së brenda dhe jashtë vendit, apo siguri me mbështetjen shëndetësore të personelit ushtarak aktiv në rezervë dhe pension, familjeve të tyre dhe punonjësve civil të FA-së. Por në të njëjtë kohë Komanda Mbështetëse administron, menaxhon municionet, armatimin, teknikën dhe pajisjet rezervë të FA-së të RSH por edhe ruan, administron materialet, vlerat monetare, pajisjet në përdorim e rezervë, sipas klasave dhe niveleve të furnizimit, siguron nëpërmjet BCU-së, trajnimin dhe përgatitjen e personelit ushtarak dhe civil për detyra specifike. Ajo arsimon, trajnon, stërvit, kualifikon oficerët, nënoficerët dhe ushtarët e strukturave të FA-së në specialitetet e ndryshme në interes të përmbushjes së misionit të tyre.

Krijimi dhe transformimi, fillesat e Komandës Mbështetëse të FA-së

Komanda Mbështetëse dhe

2014, mbi bazën e urdhrat të ministrit të Mbrojtjes nr. 603, datë 23.07.2014 Brigada Logjistike, Brigada e Mbështetjes Rajonale suprimohen dhe mbi bazën e tyre riorganizohet Komanda Mbështetëse.

Funksionimi, njësitë dhe rrugëtimi i tyre historik

Për të mbështetur FA-të në kohë paqeje, krize dhe lufte, KM ka njësi të lëvizshme dhe aftësi për të mbështetur pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura në përmbushjen e misioneve të tyre, duke përfshirë angazhimet dypalëshe dhe shumëpalëshe si dhe ato me forcat e NATO-s. Prandaj si një strukturë e rëndësishme e FA-së, KM sot, kryen funksionet e saj nëpërmjet Komandës dhe Shtabit, i cili drejton me profesionalizëm aktivitetin ditor me degët e tij si, Dega e personelit (G1), Dega e zbulimit (G2), Dega e operacioneve (G3), Dega e logjistikës (G4), Dega e planifikimit (G5), Dega e ndërlidhjes (G6) dhe Dega e bashkëpunimit civilo-ushtarak (G9). Logjistika, transferimi i personelit dhe materialeve nga një vend në tjetrin, si dhe mirëmbajtja e materialeve, është thelbësore që një ushtri të jetë në gjendje të mbështesë një dislokim të vazhdueshëm ose t'u përgjigjet në mënyrë efektive kërcënimeve emergjente. Forcat logjistike të Ushtrisë përdorin asetet dhe burimet e tyre për të siguruar gatishmërinë operacionale, qëndrueshmërinë, lëvizshmërinë dhe akomodimin për të gjithë FA-në. Komanda Mbështetëse fokusohet në sigurimin e të gjitha llojeve të furnizimeve, duke përfshirë karburantin dhe municionin, si dhe në mirëmbajtjen e pajisjeve ushtarake. Po cilat janë njësitë me të cilat kjo komandë operon në lufte dhe paqe? Cili është aktiviteti i tyre ushtarak? Le t'i sjellim më poshtë shkurtimisht.

Qendra Stërvitore e Komandës Mbështetëse është qendra që synon arsimimin, trajnimin, stërvitjen dhe kualifikimin e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve profesionistë të strukturave të FA-së, në specialitetet furnizim, transport, mirëmbajtje, xhenio, personel, administratë, armatim-municion, dhe shëndetësi. Kjo qendër harton programe dhe materiale mësimore të kurseve dhe trajnimeve në bashkëpunim me komandat e forcave, njësitë reparteve

SHT, KDS, dhe institucione të tjera arsimore ushtarake në përputhje me kërkesat e kapacitetit të arsimimit ushtarak profesional në FA. Ajo zhvillon kurse institucionale, kurse funksionale dhe trajnime të tjera afatshkurtra sipas fushave përkatëse dhe sipas nevojave të strukturave të FA-së. Qendra Stërvitore e KM ka ardhur si rrjedhojë e përgatitjes dhe nevojës për trajnim dhe kualifikimin e personelit të FA-së dhe ka dalë nga Shkolla e Trupës së KDS-së si rrjedhojë e ndryshimit të strukturave në organizimin e FARSH, për të trajnuar personelin në shërbimin e mbështetjes logjistike të trupave të luftimit.

Batalioni i Furnizimit është njësi ushtarake që merret me mbarëva-

dhe skrapit. Batalioni i Furnizimit është krijuar me urdhër të MM nr. 22 datë 11.06.2003, "Për riorganizimin e Komandës Logjistike", në vartësi të Brigadës së Furnizimit me vend-dislokim në Surrel; Në kuadër të riorganizimit të Forcave të Armatosura me urdhër të ministrit të Mbrojtjes nr. 295/1, datë 22.06.2010 "Për riorganizimin e Brigadës Logjistike u bë riorganizimi i batalionit të Furnizimit në vartësi të Brigadës Logjistike me vend-dislokim në Brar; Në zbatim të urdhrat të ministrit të Mbrojtjes nr. 704/1, datë 19.09.2014 "Për riorganizimin e Komandës Mbështetëse u bë riorganizimi i batalionit të Furnizimit në vartësi të Komandës Mbështetëse me vend-dislokim në Pezë Helmës; Në zbatim të urdhrat të MM, nr.



jtjen e mbështetjes me furnizime sipas klasave të furnizimit dhe shërbime fushore të strukturave të Forcave të Armatosura të RSH, në kohë paqe, krize e lufte, kryen administrimin e armatimit, municioneve e pajisjeve të tepërta dhe rezervës në FA, në përputhje me urdhrat dhe planet e KM-së. Ky batalion siguron mbështetjen me furnizime (klasa I-V), mbështetjen me shërbime fushore të strukturave të FA-së për realizimin e aktivitetit të përditshëm dhe zhvillimin e operacioneve ushtarake. Këto kapacitete përfshijnë marrjen, magazinimin, administrimin, shpërndarjen sipas klasave të furnizimit dhe sigurimin e shërbimeve fushore, ruajtjen dhe administrimin e armatim-municionit rezervë të FA-së. Kapacitetet e batalionit të Furnizimit janë depot e përhershme të furnizimit edhe ambientet për vendosjen dhe magazinimin e materialeve të tepërta

1173, datë 24.11.2016 "Për suprimimin dhe mbylljen e veprimtarisë ekonomiko financiare të Batalionit të Municioneve dhe riorganizimin e Batalionit të Furnizimit" u bë riorganizimi i batalionit të Furnizimit në vartësi të Komandës Mbështetëse me vend-dislokim në Pezë Helmës. Pra Batalioni i Furnizimit është pjesë e strukturës së FA-së, në vartësi të KM.

Një strukturë tjetër po aq e rëndësishme është Batalioni i Transportit, që do të thotë komandim, kontroll, trajnim dhe mirëmbajtje e një niveli të lartë gatishmërie dhe operacionale e mjeteve por dhe që siguron transport të personelit dhe ngarkesave në mbështetje të operacioneve të FA-së, në ndihmë të komunitetit e në të gjithë spektrin e operacioneve. Realizon mbështetjen me transport të strukturave të FA-së, për përballimin e operacioneve

të emergjencave, krizave fatkeqësive natyrore, ndihmave humanitare dhe operacioneve paqeruajtëse. Transporton personelin, pajisjet, kontejnerët dhe ngarkesat në mbështetje të operacioneve të FA-së të RSH. Administron dhe mirëmban infrastrukturën, pajisjet dhe teknikën. Merr pjesë në stërvitje të përbashkëta me qëllim realizimin dhe mbështetjen me transport sipas standardeve të NATO-s. Historiku i këtij shërbimi lidhet me krijimin e batalionit të parë të transportit më 13 prill 1945. Në maj 1945, në vazhdim u krijua batalioni i dytë i transportit. Pas një procesi risstrukturimi që zgjati afërsisht 40 vjet, në 1983 u krijua regjimenti i transportit. Si pasojë e faktit që specialiteti i transportit ishte bërë një nga kompetentet kryesore të FA të RSH, në vitin 1993 për herë të parë u krijua Brigada e Transportit. Që nga viti 2007 deri më sot, trupat e transportit janë të organizuara në nivel batalioni.

E ndërsa përmendim transportim s'mund të lëmë pa përmendur Qendrën e Riparimit dhe Mirëmbajtjes të Teknikës së FA-së, që siguron riparim të përgjithshëm dhe mirëmbajtje të mjeteve motorike në inventar të FA-së. Kjo qendër përgjigjet për prodhimin dhe rigjenerimin e detaleve, nyjeve dhe aggregateve të mjeteve motorike të FA-së. Por ajo koordinon mbështetjen logjistike në përputhje me prioritetet e Qendrës dhe propozon nxjerrjen jashtë përdorimit të mjeteve duke kryer procesin e shpërbërjes së tyre. Kryen kontrollin teknik periodik dhe vjetor të mjeteve motorike të FA dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e riparimin e armëve të lehta dhe artilerisë së FA. Ajo organizon punën për pritjen, detektimin, kontrollin e riparimit dhe dorëzimit të mjeteve të riparuar si dhe organizon mbledhjet mësimore për administrimin dhe menaxhimin e materialeve. Infrastruktura ekzistuese e kësaj qendre është krijuar si Uzina e Tankeve dhe deri në vitin 1992 ajo ka funksionuar si repart ushtarak. Në korrik të vitit 2007 ky repart u cilësua si Qendra e Riparimit të Nivelit të 3 dhe të 4 të mjeteve dhe aggregateve të FA. Qendra me emërtimin që mban aktualisht u krijua në vitin 2011 dhe në vitin 2013, ndryshoi strukturën e saj duke shtuar dy reparte të reja, Repartin e Riparimit të Armatimit dhe Repartin Ndërlidhje Elek-

tronikë. Në vitin 2014 kësaj qendre iu shtua edhe reparti i evakuimit, të tre këto reparte funksionojnë të ndërthurura midis tyre dhe bëjnë të mundur riparimin e mjeteve, aggregateve dhe pajisjeve të strukturave të FA.

Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura (LQFA), strukturë tjetër e rëndësishme, është mbështetja më shërbime laboratorike të FA-së, që kryen nëpërmjet metodave analitike identifikimin e agjentëve kimikë dhe biologjikë të fushës së luftës, analizat fiziko-kimike në mënyrë sistematike të municioneve dhe lëndëve plasëse, kontrollin dhe monitorimin e mjedisit në vend-dislokimet dhe zonat ku operojnë FA-të, mbështet pushtetin lokal në rast të incidenteve kimike. Kryen shërbime laboratorike për të testuar, analizuar, vlerësuar dhe siguruar kontroll cilësor të të gjitha materialeve logjistike, sipas klasave të furnizimit (I-V), ku përfshihen pajisje NBC dhe pajisje të vëna në përdorim në FA të RSH në baza ditore. Në FA lindi nevoja e kryerjes së një sërë analizash për testimin e ambienteve, kimikateve toksike, lëndëve ndotëse, municioneve, karburant-lubrifikanteve, ushqimeve etj. Nisur nga kjo nevojë e domosdoshme MM ka krijuar Laboratorin e Karburant-Lubrifikanteve, Laboratorin Kimik dhe Laboratorin e Municioneve. Laboratori i Karburanteve dhe Lubrifikanteve u krijua në vitin 1954 duke realizuar detyrat me një laborator fushor, ku kryente të gjitha analizat e karburant-lubrifikantëve të FA-së në përdorim, ruajtje dhe rezervat e shtetit. Ky laborator një herë në 6 muaj kryente analizat e karburanteve të aviacionit dhe një herë në vit ato të lubrifikantëve. Nga ana tjetër Laboratori Kimik u krijua në vitin 1965. Qëllimi i ngritjes së këtij laboratorit ishte fillimi i punës studimore për aplikimin në FA të të rejave lidhur me ADM dhe mbrojtjen prej tyre, sidomos në drejtim të armës së kimisë dhe mjeteve djegëse. Në mars të vitit 1996 Laboratori i Kimisë, Laboratori i Intendencës dhe Laboratori i Municioneve u bashkuan në një të vetëm dhe u emërua Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura (LQFA) me vartësi nga drejtoria Logjistike në MM. Me krijimin e Komandës së Mbështetjes Logjistike në vitin 2000 LQFA kaloi nën vartësinë e saj. Në vitin 2014 si rezultat i riorganizimit të FA-së, LQFA kaloi në vartësi të Qendrës së Menaxhim Materialeve dhe në janar të vitit 2017 LQFA kaloi në vartësi të KM. Batalioni i Mbështetjes Ra-

jonale, nga ana e tij siguron kapacitetet e nevojshme operacionale për kryerjen e operacioneve luftarake të emergjencave civile, të kërkimshpëtimit, operacioneve humanitare dhe ato në ndihmë të komunitetit. Por ai gjithashtu përgatit dhe stërvit personelin në interes të detyrimeve që kërkon misioni i BMR, për ta aftësuar atë për t'iu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit. Batalionit i Xhenios (bXH) është gjithashtu një strukturë tepër e rëndësishme e KM, që siguron dhe mban në gatishmëri kapacitetet e nevojshme operacionale për kryerjen e operacioneve të EC, humanitare dhe ato në ndihmë të popullsisë, mbështetjen e strukturave të FA-së për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës, kërkimin, zbulimin, çminimin, dhe asgjësimin e municioneve të rrezikshme dhe lëndëve plasëse në operacione brenda dhe jashtë vendit. Siguron dhe mbështet përmirësimin e infrastrukturës të FA, poligone stërvitje dhe rrjetin rrugor. Por dhe siguron kapacitetet për riparimin dhe ndërtimin e urave në interes të FA-së dhe komunitetit etj. dhe nëse shohim pas, Batalioni i Xhenios është vazhdim i Batalionit Xhenier-Ndërtues, i cili u krijua më 20 korrik 1968, si vazhdimësi e batalionit të mekanizmave të rëndë, ose Rep. Usht. Nr. 2261 i pajisur me teknikë xheniere dhe gërmuese e mjete transporti që kryente punime të ndryshme speciale, për t'u ardhur në ndihmë reparteve të tjerë xhenierë, në vendosje të reparteve të FA-së në kazerma dhe veçanërisht në punimet fortifikuese mbrojtëse. Pas viteve 1990 struktura e batalionit xhenier ka pësuar ndryshime të shpeshta strukturore, në përshtatje edhe me ndryshimet e bëra në strukturën e FA-së. Reparti Ushtarak 2261 mori numrin Reparti Ushtarak 1025 dhe në vitin 2014 batalioni i xhenios ka thithur edhe nënrepartin EOD, nga i cili janë kontrolluar dhe pastruar nga municionet dhe minat me dhjetëra zona të "ndotura", duke kontribuar ndjeshëm në rritjen e sigurisë në vend. Krahas përmirësimit të infrastrukturës në njësitë dhe repartet e FA-së, batalioni xhenios ka kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës në disa komuna e bashki të vendit për ndërtimin e rrugëve dhe urave mekanike, pastrimin e zonave (hotspot) dhe asgjësimin e municioneve tepër dhe jashtë FA-së.



IN MEMORIUM

Dr. Ibrahim Rugova, Presidenti historik i Kosovës

Ibrahim Rugova lindi më 2 dhjetor 1944 në fshatin Cercë, komuna e Istogut. Më 10 janar 1945 komunistët jugosllavë ia pushkatuan të atin, Ukën dhe gjyshin Rrustë Rugova, që kishte qenë luftëtar i njohur kundër çetave çetnike që po depërtonin në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Fakultetin Filozofik – Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe e kreu në Prishtinë. Gjatë vitit akademik 1976-77 qëndroi në Paris, në Ecole Pratique des Hautes Etudes, nën mbikëqyrjen e Prof. Roland Barthes-it, ku ndoqi interesimet e veta shkencore në studimin e letërsisë, me përqendrim në teorinë letrare. Doktoroi në fushën e letërsisë në Universitetin e Prishtinës, më 1984. Në vitin 1996 Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës. Në fillim ishte redaktor në gazetën e studentëve Bota e re dhe në revistën shkencore Dituria (1971-72), që botoheshin në Prishtinë. Dr. Ibrahim Rugova veprimtarinë e vet shkencore e zhvilloi në Institutin Albanologjik si hulumtues i letërsisë. Me krijimtari letrare u mor që nga fillimi i viteve gjashtëdhjetë. Dr. Ibrahim Rugova më 1988 u zgjodh kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, që u bë bërthamë e fuqishme e lëvizjes shqiptare, e cila kundërshtoi sundimin komunist serb dhe jugosllav në



Kosovë.

Si intelektual me nam që i jepte zë kësaj lëvizjeje intelektuale e politike Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh, më 23 dhjetor 1989, nga themelimi kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, partisë së parë politike në Kosovë që sfidoi drejtpërdrejt regjimin komunist në fuqi. LDK, nën udhëheqjen e Dr. Ibrahim Rugovës, u bë shpejt forca politike prijëse në Kosovë, duke mbledhur shumicën e popullit rreth vetes. Në bashkëpunim me forcat e tjera politike shqiptare në Kosovë si dhe me Kuvendin e atëhershëm të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova dhe LDK-ja përmbyllën kornizën ligjore për institucionalizimin e pavarësisë së Kosovës. Deklarata e pavarësisë (2 korrik 1990), shpallja e Kosovës Republikë dhe miratimi i kushtetutës së saj (7 shtator 1990), referendumi popullor për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, mbajtur në fund të shtatorit 1991, qenë prelud për zgjedhjet e para shumëpartiake për Kuvendin e Kosovës, mbajtur më

24 maj 1992. Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh President i Republikës së Kosovës. Dr. Ibrahim Rugova u rizgjodh President i Republikës së Kosovës në zgjedhjet e mbajtura në mars të vitit 1998.

Nën udhëheqjen e Dr. Ibrahim Rugovës LDK-ja fitoi shumicën e votave në zgjedhjet e para lokale të sponsorizuara ndërkombëtarisht në Kosovën e pasluftës në tetor të vitit 2000 si dhe zgjedhjet e para nacionale në vitin 2001 dhe në zgjedhjet e dyta lokale të vitit 2002. LDK fitoi edhe zgjedhjet e fundit nacionale më 2004.

Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh President i Kosovës në mars të vitit 2002 dhe u rizgjodh edhe më 2004. Dr. Ibrahim Rugova vdiq më 21 janar 2006 në Prishtinë dhe u varros në Bregun e Diellit me nderimet më të mëdha të popullit të Kosovës. Në përvjetorin e vdekjes së Ibrahim Rugovës, më 21 janar 2007, Presidenti i Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu, dekoroi Presidentin historik



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani emëron komandantin e ri të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kurti: Ushtria jonë është e re, por me pjekuri të thellë e histori të lavdishme

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, njëherësh komandante supreme e Forcave të Sigurisë së Kosovës, ka emëruar gjeneralmajor Bashkim Jasharin komandant të ri të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në përputhje me kompetencat kushtetuese. Të pranishëm në ceremoni ishin kryeministrit Kurti dhe ministri i mbrojtjes Mehaj.

Në fjalën e tij kryeministri Kurti do të shprehë: Ushtrisë që i shër-

ben popullit, i duhet ushtari me zemrën plot dashuri për atdheun, ushtari që të përbashkëtën e vetëmohimin i lartëson në detyrën që i besohet, ushtari që të ardhmen e sheh përmes idealit të dëshmorit. Të gjitha këto vlera i zotëron gjeneralmajori Bashkim Jashari, nipi i Komandantit Legjendar, i Kryekomandantit Adem Jashari. E, nga sot ai është Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ushtria jonë është e re, por me pjekuri të thellë e histori të

lavdishme. Vazhdimësia e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përmes Forcës së Sigurisë së Kosovës, është shtylla jonë e fortë mbi gurthemelin e Republikës.

Komandantit Jashari i dëshiroj punë të mbarë në detyrën e tij të re. Gjenerallejtnant Rahman Ramën e falënderoi për kontributin e tij dhe po ashtu i dëshiroj suksese në angazhimin e mëtutjeshëm si përfaqësues yni në RACVIAC.

të Kosovës me Urdhrin "Hero i Kosovës", titulli më i lartë në vendin tonë që u jepet figurave historike shqiptare dhe të Kosovës që kanë bërë "vepra trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës".

Çmimet dhe titujt ndërkombëtarë të Ibrahim Rugovës:

– Më 1995, Dr. Ibrahim Rugovës iu dha Çmimi për paqe i Fondacionit Paul Litzer në Danimarkë.

– Më 1996, Dr. Ibrahim Rugova u shpall Doktor Nderi (Honoris Causa) i Universitetit të Parisit

VIII, Sorbonë, Francë.

– Më 1998, Dr. Ibrahim Rugovës iu nda Çmimi Saharov i Parlamentit Evropian.

– Në vitin 1999, Dr. Rugova mori Çmimin për paqe të qytetit Mynster, Gjermani, ndërsa u shpall qytetar nderi i qyteteve italiane: Venedik, Milano dhe Breshia.

– Në vitin 2000, Dr. Ibrahim Rugova mori çmimin për paqe të Unionit Demokratik të Katalonisë "Manuel Carrasco i Formiguerra"

në Barcelonë, Spanjë.

– Në vitin 2004 Dr. Ibrahim Rugova u nderua me Çmimin e Evropës, Senator Nderi nga Fondacioni panevropian Coudenhove-Kalergi.

– U nderua gjithashtu nga Komonuelthi i Pensilvanisë (SHBA), "Mik i Shteteve të Bashkuara të Amerikës".

– Më 2004, Dr. Ibrahim Rugova u shpall Doktor Nderi (Honoris Causa) i Universitetit të Tiranës.

Ministrja Shekerinska: Ushtarë me karakter dhe motivim të fortë

Pjesëtarët e Armatës që morrën pjesë në luftimin e zjarreve që përfshiu Maqedoninë e Veriut këtë verë, sot u shpërblyen me çmime në të holla dhe masa stimuluese.

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska në fillim të fjalës së saj në kazermën Ilinden u bëri thirrje pjesëtarëve të Armatës që me një minutë heshtje t'i nderojnë viktimat e aksidentit në Bullgari.

“Çdo qytetar i Maqedonisë së Veriut bashkëndjen me këtë pikëllim. Çdo pjesëtar i Armatës që ka ndihmuar shumë herë në shpëtimin e jetëve të qytetarëve tanë, për të parandaluar një katastrofë më të madhe, vuan ndoshta edhe më shumë sepse në atë tragjedi – askush nga ju nuk kishte mundësi të ndihmonte. Por sa herë që keni pasur mundësi e keni shfrytëzuar atë shans dhe keni qenë të parët që keni ndihmuar bashkëqytetarët tuaj”, tha ministrja.

Ajo shprehu mirënjohje për të gjithë pjesëtarët e Armatës që këtë verë në 13 lokacione në Koçan, Berovë, Dellçevë, Kumanovë dhe kudo që kishte nevojë, nga toka dhe nga ajri pamëshirshëm u përfshinë në shuarjen e zjarreve.

„Faleminderit që treguat se jeni njerëz të vërtetë me parime, integritet dhe shumë guxim në të trembëdhjetë vendet ku rrezikoheshin zjarret. Ushtarë me karakter të fortë dhe motivim të fortë. Liderë që edhe në kohët më të vështira keni treguar se fjala “dorrëzim” nuk ekziston në fjalorin e tyre”, tha ministrja.

Për profesionalizmin dhe suksesin e tyre në përballjen me zjarret, mbi 1000 pjesëtarë të Armatës u shpërblyen me çmime në të holla, pushime shpërblyese apo lavdërime. Por, çmimet nuk ishin motiv për guximin dhe sakrificën e pjesëtarëve të Armatës, por fjala e tyre e dhënë në shërbim të shtetit dhe qytetarëve – tha Shekerinska.

„E di që atë që bëtë dhe sakrificën që bëtë nuk e bëtë për para, për falenderim apo ditë pushimi, por për fjalën tuaj, se do të shërbeni dhe do të bëni gjithçka për të mbrojtur



vendin dhe për të mbrojtur popullin e tij. Ne nuk e bëjmë këtë sot as për para, as për falenderim dhe as për ditë pushimi, por sepse fjala juaj dhe shërbimi juaj kërkon që ne ta mbajmë fjalën dhe të justifikojmë shërbimin tonë. Ajo që shpallëm në Ditën e Armatës tregoi se nuk është thjesht një fjalë e lehtë, por

një detyrim që e kemi marrë përsipër dhe e dinim se do të përmbushej. Më lejoni edhe një herë t'ju falënderoj në emër të gjithë Qeverisë, sepse qëndruat të fortë dhe me guxim kur të gjithë kishin nevojë për guximin dhe forcën tuaj. Faleminderit dhe urime!”, përfundoi ministrja Shekerinska.

Kryeministri Zoran Zaev, në prezencë të ministres së Mbrojtjes Radmilla Shekerinska dhe të gjeneralit Simeon Trajkovski, priti komandantin e Komandës Supreme të Forcave Aleate të NATO-s për transformim, gjeneralin Filip Lavinj, pak para ceremonisë së nënshkrimit të deklaratës së përbashkët për integrimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO.

Me nënshkrimin e kësaj deklaratë të përbashkët, zyrtarisht nis procesi i integritit ushtarak të Republikës së Maqedonisë së Veriut në strukturat komanduese dhe në strukturën e forcave të Aleancës. Maqedonia e Veriut me përkushtim punoi në proceset që e mundësuan integrimin ushtarak, gjë që e bën vendin të qëndrojë krah për krah me aleatët tanë në NATO.

Kryeministri Zaev, ministrja e Mbrojtjes Shekerinska dhe gjenerali Lavinj, në takim biseduan edhe për përfiti-

Osmani: Perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor – investimi më i sigurt në stabilitetin e rajonit

Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, gjatë pjesëmarrjes në takimin e rregullt të Ministrave të Punëve të Jashtme të NATO-s, i cili u mbajt në Riga e theksoi nevojën për veprim të përbashkët strategjik dhe qasjen e NATO-s dhe BE-së në Ballkanin Perëndimor si parakusht bazë për stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit.

Siç kumtojnë nga MPJ, gjatë sesioneve dyditore të punës u diskutuan çështje me rëndësi strategjike për Aleancën, si situata në Afganistan, adresimi i sfidave aktuale dhe të ardhshme të sigurisë, si grupimi ushtarak i Rusisë përgjatë kufirit me Ukrainën dhe sfidat hibride që vijnë nga Bjellorusia.

Gjithashtu, siç thuhet në kumtesë, temë e takimit ishte situata në Ballkanin Perëndimor dhe interesat gjeostrategjike të Aleancës për një rajon të qëndrueshëm, progresiv dhe demokratik duke e riafirmuar perspektivën evropiane dhe euroatlantike të vendeve të rajonit.

Ministrat e Jashtëm diskutuan edhe për Konceptin Strategjik të NATO-s, si një dokument i rëndë-



sishëm për rolin e ardhshëm gjeostrategjik të Aleancës.

Në seancat e punës, shtojnë nga MPJ, ministrat miratuan disa vendime dhe dokumente. Të njëjtat janë të rëndësishme për veprimin dhe forcimin e ardhshëm të Aleancës, por edhe për përgatitjen e Samitit të Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive të NATO-s, që do të mbahet vitin e ardhshëm në Madrid. Osmani ndër të tjerash theksoi se jemi dëshmitarë të përkeqësimit të mjedisit strategjik global dhe degradimit të rendit

juridik ndërkombëtar. Ai theksoi nevojën për veprim të përbashkët strategjik dhe qasjen e NATO-s dhe BE-së në Ballkanin Perëndimor si parakusht bazë për stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit.

Ministri i Jashtëm Osmani u takua edhe me Ndihmësekretaren e Shtetit të SHBA-së Karen Donfried, Ministrat e Punëve të Jashtme të Sllovenisë, Anzhe Logar, Mbretërisë së Norvegjisë, Aniken Sh. Hjtiflet, Francë, Zhan-lv Le Drian dhe të Republikës Çeke, Jakub Kulhanek.

CEREMONIA E NËNSHKRIMIT TË DEKLARATËS SË PËRBASHKËT PËR INTEGRIMIN

Zaev: Ditë historike për Maqedoninë e Veriut, prej sot jemi plotësisht të integruar në NATO

met nga anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO, si kontribut për stabilitet në rajon që garanton investime në shtet, por edhe për kontributin e Maqedonisë së Veriut në misionet e NATO-s.

Në takim u theksua se nënshkrimi ceremonial i deklarates së përbashkët është demonstrim i nderit dhe krenarisë nga përkushtimi i të gjithë atyre që morën pjesë në këtë proces.



Rusia rrit tensionet dhe rrezikun

Riga, Letoni, 30 nëntor-1 dhjetor 2021: Sekretari i

Përgjithshëm thërret në takim ministrat e Jashtëm të NATO-s

Çdo agresion i ardhshëm rus kundër Ukrainës do të ketë një çmim të lartë

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Me të mbërritur në Qendrën e Konventës ATTA në Riga më 30 nëntor 2021, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg përshkroi agjendën përpara zhvillimit të takimit të ministrave të Jashtëm të NATO-s në kryeqytetin Letonez, të thirrur në datat 30 nëntor dhe 1 dhjetor 2021. Ai theksoi para medie, tre çështje në veçanti; situatën në dhe rreth Ukrainës, situatën e Bjellorusisë dhe mësimet e nxjerra nga angazhimi i NATO-s në Afganistan. “Është e mrekullueshme të kthehesh në Riga, në Letoni. Letonia është një aleate shumë e vendosur dhe e përkushtuar e NATO-s. Është e mrekullueshme të jesh këtu në Takimin e ministrave të Jashtëm që nis sot dhe që do të zhvillohet sot dhe nesër. Ministrat e Jashtëm kanë një agjendë shumë të plotë. Ata do të trajtojnë një gamë të gjerë çështjesh të ndryshme. Sidomos situata në dhe rreth Ukrainës. Ne shohim grumbullimet e ushtrisë ruse, shohim armaturë të rëndë, shohim dronë dhe trupa të gatshme luftarake”, -tha ai. “Ne i bëjmë thirrje Rusisë që të jetë transparente sepse kjo është e paprovokuar dhe e pashpjegueshme. Prandaj, Rusia duhet të jetë transparente, dhe ata duhet të ulin tensionet dhe të de-përshkallëzojnë. Sigurisht që do të trajtojmë edhe situatën në kufirin me Bjellorusinë, ku shohim se



regjimi i Lukashenkos përdor njerëz të cenueshëm për të ushtruar presion mbi vendet fqinje. Ne qendrojmë në solidaritet me të gjithë aleatët e prekur dhe ne gjithashtu punojmë shumë ngushtë me BE-në. Sepse as BE dhe as NATO nuk i kanë të gjitha mjetet në kutinë e veglave. Por së bashku ne mund të japim një përgjigje të fortë ndaj asaj që shohim” dhe z. Stolteberg tha demonstrimin e këtij uniteti NATO-BE, e pa “kur udhëtova së bashku me Presidentin e Komisionit Evropian në rajon, në Lituani dhe Letoni”, dhe “kjo tregon se të dy organizatat qëndrojnë së bashku në solidaritet me aleatët dhe vendet anëtare të BE-së të prekura. Ne kemi gjithashtu një diskutim mes ministrave për Afganistanin. Ne duhet të diskutojmë mësimet e nxjerra.”, tha ai kur bëhet fjalë për atë që kemi arritur. “Për 20 vjet

ne kemi parandaluar çdo sulm terrorist kundër një aleati të NATO-s nga Afganistani. Ne kemi arritur shumë në degradimin e organizatave ndërkombëtare terroriste dhe parandalimin e Afganistanit nga të qenit një strehë e sigurt për terroristët ndërkombëtarë. Por në të njëjtën kohë, ka mësimet për të mësuar. Disa mësimet të vështira për t'u mësuar nga prania 20 vjeçare e NATO-s në Afganistan.”

**Stoltenberg – Blinken:
SHBA përkushtim
ndaj Sigurisë Evropiane**

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg e priti Sekretarin Amerikan të Shtetit Antony Blinken në Riga më 30 nëntor 2021, përpara takimeve të ministrave të Jashtëm të NATO-s. Jens Stoltenberg falënderoi Sekretarin Blinken

për udhëheqjen e tij dhe angazhimin e SHBA-së ndaj Aleancës. "Faleminderit për udhëheqjen tuaj, për angazhimin tuaj dhe që jeni një mbështetës kaq i fortë i NATO-s. Do të doja t'ju falënderoja gjithashtu që Shtetet e Bashkuara u konsultuan me aleatët për një gamë të gjerë çështjesh të rëndësishme. Për çështjet bërthamore, çarmatimin, për Afganistanin dhe shumë çështje të tjera gjatë javëve të fundit. Përfshirë Rishikimin e ri të Qëndrimit Amerikan", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. "Ne mirëpresim rezultatin ku SHBA-të demonstrojnë edhe një herë përkushtimin e tyre ndaj Sigurisë Evropiane, jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra, në fakt duke rritur praninë e SHBA në Evropë. Duke demonstruar mbështetjen tuaj të fortë për NATO-n, për unitetin transatlantik". Por ai tha se "kemi një gamë të gjerë çështjesh për të diskutuar në takimin ministror të Jashtëm, sigurisht, grumbullimet e ushtrisë ruse në Ukrainë dhe rreth saj". Në deklaratën përpara takimeve të ministrave të Jashtëm të NATO-s, Riga të dy sekretarët mbajtën deklarata para medias. "Ne i bëjmë thirrje Rusisë që të jetë transparente, të de-përshkallëzojë dhe të ulë tensionet", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg dhe dënoi edhe njëherë përdorimin "e papërgjegjshëm dhe çnjerëzor të njerëzve vulnerabël nga regjimi i Lukashenkos për të ushtruar presion mbi vendet e tjera, në kufirin midis Bjellorusisë dhe disa aleatëve të NATO-s", tha ai. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, u shpreh se SHBA-të janë mirënjohës dhe falënderues ndaj Sekretarit të Përgjithshëm për "udhëheqjen e tij të jashtëzakonshme të Aleancës". "Ne jemi veçanërisht të përqëndruar në sigurimin që Koncepti Strategjik për të cilin u ra dakord në parim në Samitin e kaluar tani të realizohet plotësisht. Ne kemi shumë punë për të bërë gjithashtu gjatë dy ditëve në vijim për çdo gjë, nga kontrolli i armëve dhe çarmatimi, mospërhapja e armëve të sfidat në Ballkanin Perëndimor, natyrisht aktivitetet e Rusisë në kufirin me Ukrainën, si dhe atë që kemi parë në Bjellorusi dhe përdorimin e emigrantëve si armë politike". Blinken tha se "ky takim është jashtëzakonisht i mirë në kohë, si për sa i përket vazhdimit dhe thellimit të

punës që tashmë ka filluar në Samitin e fundit, si dhe për t'u siguruar që po adresojmë sfidat me të cilat po përballemi në këtë moment si aleatë, si partnerë. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken e mbylli deklaratën e tij duke u shprehur se, angazhimi i Presidentit Biden ndaj NATO-s, ndaj Aleancës, është shumë i njohur dhe ai e ka bërë misionin dhe prioritetin e tij numër një rivitalizimin e angazhimit amerikan në aleancat tona, duke filluar me NATO-n, dhe kështu është veçanërisht mirë të jemi këtu për të vazhduar atë përpjekje, për të punuar në konsultim të ngushtë me të gjithë aleatët tanë dhe me Sekretarin e Përgjithshëm".

Diskutimet mbi Rusinë dhe Ukrainën, Bjellorusinë dhe kontrollin e armëve

Jens Stoltenberg, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s edhe në 30 nëntor 2021, i bëri thirrje Moskës që të jetë transparente, të de-përshkallëzojë dhe të reduktojë tensionet, pas vendosjeve ushtarake të Rusisë pranë Ukrainës. "Çdo agresion i ardhshëm rus kundër Ukrainës do të kishte një çmim të lartë dhe do të kishte pasoja të rënda politike dhe ekonomike për Rusinë", tha Stoltenberg, pas ditës së parë të takimit të ministrave të Jashtëm të NATO-s në Riga. Në konferencën për shtyp ai iu tha medieve se ministrat trajtuan edhe fushatën hibride të Bjellorusisë kundër aleatëve, si dhe rolin udhëheqës të NATO-s në kontrollin e armëve. "Ne sapo kemi pasur një diskutim shumë të mirë dhe thelbësor mes ministrave të Jashtëm të NATO-s. Ministrat trajtuan tre çështje: Vendosja ushtarake e Rusisë në Ukrainë dhe rreth saj, veprimet e regjimit në Bjellorusi, dhe rolin udhëheqës të NATO-s në kontrollin e armëve.", informoi mediet Sekretari i Përgjithshëm. "Situata në dhe rreth Ukrainës mbetet e rrjedhshme dhe e paparshtueshme", tha ai. "Nuk ka siguri për qëllimet e Rusisë. Ne shohim një përqendrim të konsiderueshëm dhe të pazakontë të forcave, e cila është e pajustificuar dhe e pashpjegueshme dhe e shoqëruar me retorikë dhe dezinformata të shtuara dhe ne e dimë se Rusia ka përdorur forcë më parë kundër Ukrainës dhe fqinjëve të tjerë". Stoltenberg tha se ministrat dis-

kutuan situatën, "ne qëndrojmë të bashkuar në qëllimin tonë për të penguar Rusinë nga çdo veprim i mëtejshëm agresiv. Ne i bëjmë thirrje Rusisë që të jetë transparente, të de-përshkallëzojë dhe të ulë tensionet. Çdo agresion i ardhshëm rus kundër Ukrainës do të kishte një çmim të lartë dhe do të ketë pasoja të rënda politike dhe ekonomike për Rusinë", tha Sekretari i Përgjithshëm. Ai tha se ministrat ishin të qartë se nuk duhet të ketë asnjë keqkuptim apo llogaritje të gabuar për vendosmërinë e NATO-s. "Ne qëndrojmë së bashku për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët. Ne do të vazhdojmë të vlerësojmë në mënyrë aktive situatën dhe të sigurojmë se kemi të gjitha planet e nevojshme. Në të njëjtën kohë, ne ruajmë mbështetjen tonë politike dhe praktike për partnerin tonë Ukrainën. Ne përgëzojmë Ukrainën për reagimin e saj të matur ndaj provokimeve të vazhdueshme të Rusisë", tha Stoltenberg.

Edhe ne ditën e dytë të takimit me Ukrainën dhe Gjeorgjinë ministrat e Jashtëm të NATO-s shkëmbyen mendime mbi zhvillimet aktuale, por qasja e dyfishtë e NATO-s ndaj Rusisë mbetet gjithashtu e pandryshuar, "mbajtja e fortë e mbrojtjes dhe parandalimit përballë modelit të veprimeve agresive të Rusisë. Por "Ne gjithashtu besojmë se dialogu është jetik", tha Stoltenberg. "Fatkeqësisht, Rusia kohët e fundit ka vendosur të ndërpresë marrëdhëniet diplomatike me NATO-n. Ne i bëjmë thirrje Rusisë të anulojë këtë vendim dhe për t'u riangazhuar në Këshillin NATO-Rusi, për të mirën e paqes dhe sigurisë", tha ai Lidhur me Bjellorusinë dhe "përdorimin e njerëzve vulnerabël nga regjimi i Lukashenkos për të ushtruar presion mbi Poloninë, Letoninë dhe Lituaninë", Stoltenberg përsëriti se "Kjo është cinike dhe çnjerëzore" dhe se "ministrat e NATO-s e bënë të qartë se ne qëndrojmë në solidaritet të plotë me aleatët e prekur. NATO gjithashtu po bashkëpunon ngushtë me BE për të kundërshtuar këtë fushatë hibride.", tha Sekretari i Përgjithshëm dhe solli shembullin e vizitës së tij të dielën në Vilnius dhe Riga me presidenten e KE-së Ursula von der Leyen. Ministrat e Jashtëm diskutuan gjithashtu kontrollin e armëve, çarmatimin dhe mospërhapjen. "Ky është një prioritet për NATO-n. Të gjithë ale-

atët e NATO-s mbështesin një botë pa armë bërthamore”, tha shefi i NATO-s. “Që nga fundi i Luftës së Ftohtë, ne kemi reduktuar ndjeshëm arsenalin tonë bërthamor dhe vazhdimisht promovojmë marrëveshjet kryesore të kontrollit të armëve. Por ne shohim tendenca shumë shqetësuese. Rusia dhe Kina po rrisin ndjeshëm arsenalet e tyre. Traktatet kryesore janë duke u dëmtuar dhe teknologjitë e reja dhe përçarëse po ndryshojnë rrënjësisht natyrën e konfliktit. Aleatët e NATO-s janë të vendosur të udhëheqin një përpjekje të ripërtërirë për të forcuar kontrollin e armëve. Sepse në një botë më të rrezikshme, ne kemi nevojë për më shumë parashikueshmëri dhe më shumë transparencë.”

Mësimet e nxjerra nga angazhimi i NATO-s në Afganistan

Në takimin në Riga, në 1 dhjetor 2021, miniseri i Jashtëm i NATO-s diskutoi mësimet e nxjerra nga angazhimi i Aleancës në Afganistan, për gati dy dekada. Pas rënies së shpejtë të qeverisë dhe forcave afgane në gusht, vlerësimi gjithëpërfshirës politik dhe ushtarak u krye gjatë vjeshtës, me përfshirjen aktive të aleatëve dhe ekspertëve. Vlerësimi zbuloi se “angazhimi i NATO-s në Afganistan demonstroi një kapacitet dhe aftësi të jashtëzakonshme ushtarake dhe se në një mjedis gjithnjë e më kompleks të sigurisë, menaxhimi i krizës duhet të mbetet një detyrë thelbësore për NATO-n”. Ai gjithashtu arriti në përfundimin se niveli i ambicies së komunitetit ndërkombëtar në Afganistan shtrihej shumë përtej degradimit të strehëve të sigurta të terroristëve dhe se në të ardhmen, “aleatët duhet të vlerësojnë vazhdimisht interesat strategjike, të vendosin qëllime të arritshme dhe të mbeten të vetëdijshëm për rreziqet e zgjerimit të misionit”. Vlerësimi jep një sërë rekomandimesh të tjera, përfshirë ruajtjen e ndërveprimit me partnerët operativë; duke marrë parasysh normat politike dhe kulturore të kombeve pritëse, si dhe aftësinë e tyre për të përvetësuar ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimin; dhe sigurimin e raportimit në kohë dhe konsultimeve kuptimplotë. Ai gjithashtu sugjeron që NATO duhet të marrë parasysh

se si të forcojë aftësitë e saj për të kryer operacione evakuimi në shkallë të gjerë në të ardhmen. Përfundimet dhe rekomandimet kryesore të vlerësimit synojnë të informojnë liderët politikë dhe ushtarakë të NATO-s ndërsa ata shqyrtojnë dhe drejtojnë operacionet e ardhshme të menaxhimit të krizave.

Kriza e Balltikut, Jens Stoltenberg dhe Ursula von der Leyen vizitë të përbashkët

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, përpara ministerialit të Jashtëm të NATO-s, vizitoi Lituaninë dhe Letoninë më 28 nëntor 2021 së bashku me Presidenten e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen, për të demonstruar solidaritet me aleatët e NATO-s dhe shtetet anëtare të BE-së në rajonin Balltik dhe për të forcuar më tej bashkëpunimin mes NATO-s dhe BE-së. Në Lituani, Sekretari i Përgjithshëm zhvilloi diskutime me Presidentin Gitanas Nausėda dhe kryeministren Ingrida Šimonytė rreth zhvillimeve në kufirin e Lituanisë dhe grumbullimeve ushtarake të Rusisë pranë Ukrainës. Sekretari i Përgjithshëm tha se, ndërsa regjimi i Lukashenkos po shfrytëzon njerëzit e cenusur për të ushtruar presion mbi vendet fqinje, “asnjë aleat i NATO-s nuk qëndron i vetëm”. Ai tha se të gjithë aleatët kanë shprehur solidaritet me Lituaninë dhe kanë ofruar ndihmë praktike, duke përfshirë një ekip ekspertësh të NATO-s të vendosur së fundmi në Lituani për të shkëmbyer informacione, analiza dhe përvijë në luftën kundër kërcënimeve hibride. Stoltenberg shpjegoi se bashkëpunimi midis NATO-s dhe BE-së është thelbësor për të kundërshtuar këtë fushatë hibride. “Kjo krizë prek si NATO-n dhe BE-në”, tha ai, duke shtuar se “Lituania është anëtare e të dyja organizatave, kështu që është e rëndësishme që presidentja von der Leyen dhe unë të jemi këtu së bashku sot.” Ai kujtoi se “NATO dhe BE-ja punojnë së bashku për një sërë çështjesh të sigurisë, duke përfshirë kundërvënien e kërcënimeve hibride”, dhe theksoi se “sot, ne diskutuam se si mund të rritim punën tonë të përbashkët, përfshirë edhe një deklaratë të re të përbashkët NATO-BE, sepse ne jemi më të fortë dhe më të sigurt kur ne punojmë së bashku”.

Bashkëpunimi NATO-BE

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s takohet me ministrat e Mbrojtjes të BE-së

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, iu bashkua takimit të ministrave të Mbrojtjes të BE-së, më 16 nëntor 2021 për të trajtuar çështje, përfshirë Bjellorusinë, Ukrainën, Rusinë dhe bashkëpunimin NATO-BE.

Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi se NATO qëndron në solidaritet të plotë me Poloninë dhe aleatët e tjerë të prekur nga përdorimi i emigrantëve nga regjimi bjellorus si një taktikë hibride. “Për çështjen e situatës në kufirin midis Bjellorusisë dhe Polonisë, por edhe në kufirin midis Bjellorusisë dhe dy aleatëve të tjerë të NATO-s, Letonisë dhe Lituanisë, natyrisht, ne jemi thellësisht të shqetësuar për mënyrën se si regjimi i Lukashenkos po përdor emigrantët e cenusur si një taktikë hibride kundër vendeve të tjera, dhe kjo në fakt po rrezikon jetën e emigrantëve dhe është një mënyrë e përdorimit të njerëzve, instrumentalizimit të njerëzve, në taktikë hibride kundër vendeve të tjera. Ne e ndjekim këtë nga afër dhe qëndrojmë në solidaritet me Poloninë dhe aleatët e tjerë të prekur. Ne jemi gjithashtu të gatshëm të vazhdojmë të mbështesim dhe konsultojmë ngushtë me aleatët e përfshirë”, -tha Jen Stoltenberg.

Zoti Stoltenberg tha gjithashtu se NATO vazhdon të monitorojë një grumbullim të forcave ruse pranë kufijve të Ukrainës dhe se Aleanca vazhdon të ofrojë mbështetje politike dhe praktike për Ukrainën. Aleatët e NATO-s do të vazhdojnë të monitorojnë nga afër. Ne do të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje politike dhe praktike për Ukrainën. Dhe sigurisht, ne dërgojmë gjithashtu një mesazh shumë të qartë të vendosmërisë në mbrojtjen e të gjithë aleatëve në rajon. “Ne po vazhdojmë nga afër ngritjen ushtarake nga Rusia. Ne shohim forca të pazakonta të mëdha dhe përqendrim të forcave afër kufirit të Ukrainës. Këtë e kemi parë edhe më parë. Dhe ne mendojmë se është jashtëzakonisht e rëndësishme tani që t’i dërgojmë një mesazh të qartë Rusisë për uljen e tensioneve, të jemi transparent dhe të shmangim çdo lloj përshkallëzimi të situatës në dhe rreth Ukrainës”.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi gjithashtu fuqinë e bashkëpunimit NATO-BE dhe se si ai mund të zgjerohet për të përfshirë fusha të reja bashkëpunimi në të ardhmen, të tilla si qëndrueshmëria, teknologjitë në zhvillim dhe shkatërruese dhe ndikimi i sigurisë i ndryshimeve klimatike.

Shqiponjat fluturojnë lart

Gjeneral Astrit Jaupi: “Riza Lahi, njerëzit e ajrit nuk qëndrojnë dot mbi tokë”

Riza Lahi, ka kryer disa kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit gjatë kohës që ka qenë pilot. Është autor i 31 librave dhe publicist. Është ftuar disa herë jashtë atdheut si shkrimtar dhe gazetar. Ka dhënë kontribut të pandërprerë në çështjen e romëve, duke mos pasur asnjë lidhje gjaku me ta apo interesa materiale.

Ka qenë anëtar i “Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë”, i Bordit drejtues së “Shoqatës Botërore të Poetëve” (World Poet Society - WPC) dhe anëtar i Kongresit të “IWAA” (Shoqatës Botërore të Shkrimtarëve dhe Artistëve).

Ishte anëtar i “Albanian – American Academy of Arts and Sciences”. Krijimtaria dhe shkrime të tij janë botuar në Sllovaki, Greqi, SHBA, Indi, Iran, Itali, Kosovë, Ceki, Zvicër, Koreja e Jugut, Maqedoni e ndokund tjetër.

Fitues i disa çmimeve të niveleve lokale dhe kombëtare, zëvendës President i ansambllit folklorik “Shqiponjat” dhe në stafin drejtues të revistës kulturore “Obelisk”.

Shkruante pandërprerë në shtypin e përditshëm dhe ruante me kujdes pozicionin e shkrimtarit të pavarur.

Në vitin 2012 është certifikuar me diplomë nga IWAA – Shoqata Botërore e Shkrimtarëve dhe Artistëve me këtë motivacion: “This Diploma is to certify that in 2012, RIZA LAHI, who has demonstrated distinguished achievement within the principles and purposes of the International Writers and Artists Association, is recognized as THE



— Lindi më 16 tetor 1950 në Shkodër dhe u nda para kohe nga jeta, më 31 Dhjetor 2013, Tiranë.

— 1998 - 2007 ka punuar si përkthyes në OSBE — ODIHR;

— 2000 — 2002, gazetar profesionist në shtypin ushtarak;

— 1970 — 2000, oficer — pilot i klasit të dytë në FA;

— 1997 (21 ditë), përkthyes në OSBE në kuadrin e fushatës së zgjedhjeve;

— 1994 (dy muaj), përkthyes pranë trupave amerikane në aerodromin e Gjadrit;

— 1977 — 1979 studioi Filozofi;

— 1968 — 1970 kreu Shkollën Ushtarake e Aviacionit.

BEST TRANSLATER INTO ALBANIAN OF ALBANIA"

Kontributet në letërsi – Poezi për të rritur dhe fëmijë, tregime për të rritur dhe fëmijë, shqipërime poetike, artikuj kritikë, ese dhe romane.

Riza Lahi ka punuar për tridhjetë vite pilot në Forcat Ajrore të vendit, dy vite gazetar në shtypin ushtarak, si edhe, disa kohë në OSBE. Tematika që ai ka rrahur më shumë në prozë dhe publicistikë është ajo e aviacionit, ngjarjeve heroike, dramave të njerëzve të ndershëm e të dëshpëruar dhe e çështjes kosovare. Në poezi ushtronte më shumë lirikën, poezinë meditative dhe atë luftarake; operon me vargje të rregulla dhe të lira.

Ka mbajtur gradën ushtarake të nënkolonelit.

"DINOSAURËT E FUNDIT"

- RIZA LAHI (16 TETOR 2016)

Autori i këtij libri, shkrimtari, publicisti dhe përkthyesi i njohur brenda dhe jashtë vendit, anëtar i "Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë", i bordit drejtues së "Shoqatës Botërore të Poetëve", anëtar i "Akademisë së shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane", gazetar profesionist në shtypin Ushtarak, ka kryer Shkollën e Aviacionit Vlorë, dega Pilot 1968-1970 si dhe Shkollë Filozofie 1977-1979.

Riza Xhevdet Lahi, ka qenë para së gjithash një pilot, i dashuruar përjetësisht me aeroplanin, qiellin, librin dhe i përket fatmirësisht botës së pilotëve por dhe të shkrimtarëve e poetëve.

Si në librat e tij të mëparshëm me temën e aviacionit, si tek vëllimi i parë dhe në këtë vëllim të dytë "Dinosaurët e fundit", ka punuar me vullnet, dëshirë, mirësi e zemër të pastër, si ajo e pilotëve, për të pasqyruar në mënyrë sa më reale jetën, profesionin, vullnetin dhe karakterin e fortë të burrave që qëndruan një jetë të gjatë në aerodrome, fusha aviacioni, në ajër mbi metalin prej duralumini e çeliku pa iu trembur syri para asgjëje.

Rizai u nda para kohe nga jeta (31 Dhjetor 2013) por vullneti e dëshira e tij për ta botuar librin ishte shumë e madhe, ndonëse hasi në shumë pengesa e vështirësi. Megjithatë ky libër qëllimin e tij për të dalë në dritë e pati si një amanet "pa dashje" për familjen e

Veprat e botuara

Tregime, përralla për fëmijë:

"Legjenda e Zerdelisë", 1985;

"Ledia në një natë me hënë" 1995;

"Aventurat e rosës Monda" (Shqipërim nga E. Bosse) 2001.

Vëllime me poezi gërshetuar me tregime:

"Kosova, e fejuara ime", 1994;

"Drenica, qeleshja kosovare", 1998;

"Trëndafilë", 1996;

"Trëndafila nga Tirana", 2009;

"Hannibal Antes Portas" – poems and stories in English and 8 other languages – Tirana, 2011.

Tregime

"Ëngjëjt me krahë duralumini", 2000;

"Fluturime mbi qilimin persian", 1998;

"Nën hënë e Ulqinit", 2001;

"Ylli që sheh mbi sheshin "Skënderbej", 2001.

Romane

"Të shtunën në mesnatë në një yll", 1997 – roman për fëmijë;

"Vorri i Ashikut", në katër volume, 2005;

"Serenatë korçare në Nju Jork", 2009.

Biografi artistike

"Një violinë në Panteonin e Orfeut", 2008;

"Dinosaurët e fundit", 2003;

"Maratonomaku nga Shkodra", 2008;

"Piloti i katër presidentëve".

Shqipërime

"Poezi për fëmijë nga vendet anglisht-folëse" (dy vëllime) – 2006;

"Në shiun e argjentë" (vëllimet e mësipërme, botuar në një të vetëm, në Rep. e Maqedonisë), 2005;

"Mbrëmë i pëshpërita një Ylli" – Poezi të zgjedhura nga Xhelaludin Rumi, 2002;

"Fluturoi qielli nga cepi i velit tim" - poezi të zgjedhura nga F. Forughazd, 2006;

"Golgota shqiptare" nga Leo Freundlich, 1990;

"Ikja masive" nga Hans Peter Rulmann, 1997;

"Ëngjëlli i Mostarit" nga Sally Becker, 2000;


"Nuk ka ëngjëj në këtë botë" nga Sally Becker, 2007.

Në Konkursin Kombëtar, 1994, ka fituar vendin e parë në Republikë, me pjesën teatrale për fëmijë, botuar më pas nën titullin "Të shtunën në mesnatë në një yll".

tij, për botuesin e shtypshkronjës "Ada" (Roland Lushi), në përkujdesjen e ndihmën financiare të Haxhi Dede Baba Edmond Brahimaj, Kryegjyshit Botëror të Bektashinjëve, duke e përjetësuar kështu këtë vepër në ditëlindjen e tij të 16 tetorit, por të vitit 2016, dhe në

promovimin duke përsëritur se për Rizain ka vetëm lindje.

Rizai në këtë vepër thekson se Aviacioni nuk mund të kuptohet pa teknikë e aeroplanë bashkëkohorë, shkollë aviacioni, mjete navigimi-drejtimi, logjistikë, teknikë-specialistë të shfrytëzimit, teknikë-



specialistë të mirëmbajtjes, pa repartet e oficinave, të uzinës së aviacionit, bankëprovën moderne për testimin e motorëve luftarakë etj. Në vendin tonë, të gjitha u krijuan, zhvilluan dhe ecën drejt majave më të larta të kohës nga mendja, forca, përkushtimi, sakrificë, djersa dhe gjaku i derdhur nga pilotët, teknikët e specialistët që nga fillimet fill pas viteve 1945. Kujtojmë e respektojmë fluturimin e parë, më 24 prill 1951, nga piloti Peco Polena e tekniku i aeroplanit Jak-9P, Nr-13, Koli Cobo.

Rolin kryesor për krijimin dhe zhvillimin e aviacionit e kanë luajtur furnizimi me aeroplanët e parë Jak-9P e PO-2 në vitet 51-52, Mig-15 në 1955. Shkollat e aviacionit jashtë vendit por në veçanti ajo e Vlorës nga përpjekjet e para në vitet 1958, me praktikën e fluturimit të kursit të parë, me komandant kursi Areteo Konomini në skuadriljen e Laprakës dhe instruktorë fluturimi Irakli Grazhdani, Petrit Malindi, Hektor Lako, Refit Jazo, Flamur Micko, Agim Spahiu dhe Zebo Dyrmishi.


Me krijimin më 11 Maj 1962, në Vlorë, shkolla e aviacionit u bë shembull frymëzimi, përgatitje teorike dhe praktike fluturuese në nivele të larta bashkëkohore, plot vështirësi por dhe plot krenari, guxim dhe cilësi të lartë. Në shkollën e aviacionit, u përgatitën dhe u diplomuan mbi 1300 pilotë, teknikë e specialistë të talentuar. Mirënjohje e respekt të veçantë për përkujdesjen e shtetit shqiptar, por dhe mbështetjen tekniko-luftarake, shkollimin e edukimin profesional, akademik në çdo aspekt të ish-Jugosllavisë, ish-Bashkimit Sovjetik, R. P. Ki-

nës si dhe shumë shtete të tjera pas viteve 1992 si SHBA, Turqia, Greqia, Gjermania, Franca, Anglia etj. Me respekt e përlulje kujtohen pionierët e aviacionit tonë, ish-partizanëve të patrembur që morën të parët udhët qiellore të atdheut duke risjellë në vëmendje se gjatë zhvillimit të tij, ecjes përpara, aviacioni ynë u desh të paguante kostot e këtij përparimi, si të ashtuquajtura "haraçe të përgjakura"; të gjakosura me gjakun e edukatorëve, kolegëve dhe shokëve të pilotimit. Disa nga këta pionierë të Forcave Ajrore Shqiptare ranë jashtë kufijve të atdheut; eshtrat e tyre ende nuk kanë ardhur të prehen në tokën e tyre. Piloti Ibush Vokshi (Dëshmori i parë Aviacionit Shqiptar), rënë në një katastrofë ajrore në Lubjanë, në vitin 1947, gjatë provimeve në fund të programit, Qemal Mërtiri rënë më 12 tetor të vitit 1951, në një katastrofë ajrore në periferi të Novosibirskut të ish Bashkimit Sovjetik.

"Eshtrat e aviatorëve tanë dëshmorë, ndodhen në varrezat e dëshmorëve, veprat dhe aktet e tyre janë nderuar dhe respektuar. Por jeta e përditshme e pilotëve, teknikëve dhe specialistëve shqiptarë nuk ka qenë vrasje, fikje motorësh, defekte në ajër apo vështirësi të tjera të ndryshme. Jeta jonë ka qenë e bukur...pafundësisht e bukur, e bukur dhe heroike...Jeta dhe heroizmi i pilotëve shqiptarë ka të përbashkëtat e veta por edhe veçoritë e specifikat e veta, që ndrijnë si një tog xhevahresh gjithfarësh", -këto cilësi Xakja na i paraqet në këtë vepër plot emocion e veçori

të ralla". Autori i librit, ka ditur të vlerësojë e të japë me zgjuarsi e profesionalizëm, duke vëzhguar plot sqimë, këto të veçanta aq të bukura, që të përthithin dhe nuk të lënë ta heqësh nga dora "Dinosaurët".

Të shkruash për aviacionin është një nder, por të paraqitesh tek lexuesi kërkohen ditë e vite për të përshkruar aktivitetin e heroizmin e të gjithëve dhe për këtë, autori e ka pasur shumë të vështirë të përzgjidhte. Gjithsesi është bërë një përzgjedhje me përpjekjen e dhembshur për të pikturuar disa figura nga më përfaqësueset, pasi një pjesë e tyre janë dhënë në vëllimin e parë edhe pse Rizai kishte hedhur shkrimet e para për vëllimin e tretë por për fat të keq nuk u arrit të realizohej. Aviacioni ndër vite eci në rrugë të reja duke u ndeshur me shumë pengesa e vështirësi për zhvillimin, modernizimin, stërvitjet taktike operacionale dhe strategjinë ushtarake, eci përpara me guxim e me një armatë të tërë profesionistësh. Vështirësitë e teknologjisë, ngjarjet, ndërpreja e marrëdhënieve diplomatike me ish Jugosllavinë në vitet 1948, ish Bashkimin Sovjetik në vitet 1960, me Kinën më 1978 dhe ngjarjeve tragjike në mars 1997 e rënduan dhe e rrezikuan shumë aviacionin, por shpirti, dashuria për armën e aviacionit bënë që personeli i saj, me dituri, shkencë, zgjuarsi, eksperiencë e profesionalizëm, i kaluan situatat, ruajtën e futën në gatishmëri repartet e aviacionit, prodhuan karburantet në Shqipëri, krijuan, fuqizuan oficinat, uzinën dhe shkollën e aviacionit. Le të krenohemi jo vetëm me detyrat luftarake, mbështetjen e operacioneve të forcave tokësore, detare por dhe për kontributet në situatat e krijuara gjatë krizës së vitit 1997, në luftën e Kosovës 1999, në stërvitjet e përbashkëta me vendet partnere e të NATO-s, dhe në veçanti, për kryerjen e operacioneve të kërkimshpëtimit në rastet e fatkeqësive natyrore për popullatën, por dhe në ndihmë të aksidenteve dhe ndihmës mjekësore në të gjithë vendin. Janë të shumta rastet plot heroizëm e shpirt sakrifice,



Loro Boriçi, emblema e sportit shqiptar

Loro Boriçi u lind më 22 gusht 1922, në qytetin e Shkodrës. Loro Boriçi ka qenë një figurë e jashtëzakonshme e futbollit shqiptar, por jo vetëm e futbollit, por edhe e sportit shqiptar. Ai ishte një njeri i palodhur, altruist, njeri me një shpirt të madh, tepër komunikues e i sjellshëm. Si lojtar ai ishte një lojtar universal, lojtari që u shpall më i miri i Ballkanit në vitin 1946, kapiteni që mori Kupën e Kampionit Ballkanik.

Në vitin 1949 shkon te Partizani dhe mbetet ithtar i përjetshëm i tij. Klubi i kuq bëhet shtëpia e tij e parë. Partizani shpallet kampion i vendit dhe Boriçi golashënuesi më i mirë i kampionatit me 12 gola. Luan dhe drejton Partizanin njëkohësisht në vitet 54-57, ku kurorëzohet me kupa e kampionate.

Te Partizani ai pati kulmin e tij. Në vitet 1950 -1956 ai ishte një nga lojtarët më të mirë të "Partizanit" dhe njëkohësisht është edhe një nga goleadorët më të mirë të asaj kohe, krahas Refik Resmes, Panajot Plakut dhe Përnaskës. Në vitet 1964, '66, '68, '70 do të bëhej fitues i Kupës së Republikës.

Por ai fitoi dhe trofe ndërkom-

bëtare, si kampionin ballkanik midis klubeve, në vitin 1970 me "Partizanin" dhe medaljen e argjendtë (vendin e dytë) në Spartakiadën e Ushtrive të Vendeve të Lindjes në Hanoi (Vietnam, 1963). Me "Partizanin", Boriçi do të merrte pjesë edhe në kupat e Europës. Mjafton të kujtojmë se ai ka drejtuar kombëtaren në 24 ndeshje me disa ndërprerje, për një periudhë 25-vjeçare. Ka marrë pjesë në eliminatorët e kampionateve evropiane e botërore.

Në derbin Dinamo-Partizani, në vitin 1954, kur takimi po mbaronte në barazim 0-0, ndodhi një episod që nuk kishte ndodhur ndonjëherë. Një nga futbollistët e Partizanit krosin topin në zonën e portës së Dinamos, që mbrohej nga mjeshtri Qemal Vogli, i cili kërcën në lartësi dhe e zotëron atë. Por ndaj tij pati një ndërhyrje trupore nga futbollisti Merja. Qemali hodhi vështrimin nga arbitri, që nuk dha ndonjë sinjal për faull. I nervozuar, ai lëshon topin përtokë dhe shkon drejt arbitrit për të protestuar. Këtë veprim e pa Loro, që ishte 6-7 hapa larg topit, vrapon dhe e çon topin në rrjetë.

Gjyqtari këtë veprim e quan të

rregullt dhe kërkoi që topi të vendoset në qendër të fushës, duke e quajtur gol të rregullt. Ky gol u quajt goli i zgjuarsisë, i njohjes perfekte të rregullores së futbollit nga Boriçi. Ai gol e shpalli Partizanin kampion të Shqipërisë.

Ai është emblema e ekipit të madh të Partizanit në vitet 1949 deri në vitin 1957, ku në rolin e qendërsulmuesit që bombardonte portat kundërshtare dhe trajnerit, i solli skuadrës kryeqytetase një varg kupash të kampionit e të Kupës së Republikës. Me emrin e tij në sferën e trajningut lidhet fitimi i medaljeve të argjendta në turneun e Hanoit dhe në fitimin e Kupës Ballkanike me Partizanin në vitin 1971. Ai është trajneri i madh i përfaqësueses shqiptare, që sigloi rezultatet sensacionale me Irlandën e Veriut 1-1, në Tiranë në vitin 1965, barazimin "varrmihës" ndaj RFGJ-së së Helmut Shënit në vitin 1967, që solli eliminimin e nën-kampiones së notës nga finalët e Kampionatit European të Romës në vitin 1968. Apo i fitores së thellë 3-0 ndaj skuadrës përfaqësuese të Turqisë në vitin 1971.

Ai luan shumë ndeshje më përfaqësuesen në një hark kohor

7-vjeçar (24 ndeshje), ku shënon gjashtë gola, kundër Jugosllavisë (2-4) në Tiranë në vitin 1946, Bullgarisë (2-1, qershor, 1950 në Tiranë), Çekoslllovakisë (2-1, dhjetor, 1952, Tiranë), Polonisë (2-0, nëntor 1953, Tiranë) si dhe dy gola në Ballkaniadën e 1946-s.

Ai ishte një tip centërfori i veçantë, i tipit Pele, që organizonte lojën, jepte topa të bukur, gjuante fort e shkëlqyeshëm, luante me kokë shumë bukur, pasi loja në atë kohë bëhej me krosime.

Ndeshja më e madhe e tij është ndeshja Jugosllavi-Shqipëri, e luajtur në Beograd në vitin 1948, që përfundoi 0-0. Të gjitha gazetat jugosllave shtronin pyetjen: "Bobek apo Boriçi, kush ishte më i miri i ndeshjes, shqiptari apo jugosllavi i famshëm?"

Loro Boriçi i përket futbollit shkodran, ku sigloi dy kampionatet e para të pasluftës, në vitet 1945, 1946. Ai është ndër të paktët futbollistë shqiptarë që luajti me një ekip italian të Serie A, siç ishte Lazio në kampionatet e viteve 1941, 1942. Kapiteni Boriçi udhëhoqi skuadrën përfaqësuese të Shqipërisë në fitoren historike të Ballkaniadës të vitit 1946 në Tiranë, duke sfumuar skuadra me emër si Rumania e Bullgaria.

Pavarësisht se e ëma e tij, Marija, nuk donte që Loroja të bëhej futbollist, ai e gjente përsëri kohën të luante fshehurazi futboll me shokët e tij. Por ai karrierën si futbollist do ta niste pas 5 vitesh nga debutimi i tij i parë. Por kësaj here jo në Shqipëri, por në Itali.

Në vitin 1941 Loro Boriçi kishte shkuar për të studiuar në Fakultetin e Drejtësisë në Romë. Por gjatë kohës së qëndrimit të tij në Itali ai nuk mund të qëndronte pa luajtur dot futboll, pasi ai ishte shumë i pasionuar pas këtij sporti. Prandaj duke mos pasur më edhe pengesën e së ëmës së tij, ai iu drejtohet zyryave të klubit sportiv të Lazios.

Pas një takimi të shkurtër, drejtuesit e klubit italian vendosën që ta provojnë djaloshin shqiptar, dhe fillimisht e aktivizojnë me ekipin B të Lazios. Gjatë ndeshjeve të kontrollit, Loro zhvilloi lojë të bukur gjë që bëri që ai t'u binte në sy specialistëve të Lazios. Ai spikati për manovrimet që ai bënte me topin, hapin galopant si edhe gjuajtjet që ai mund të kryente me të dyja këmbët në distanca të ndryshme.



Në moshën 86 vjeçare ndahet nga jeta legjenda e Partizanit dhe njëkohësisht president nderi i Federatës Shqiptare të Futbollit. Miço Papadhropulli i cili njihet si një njeri i urtë, që me dijen e tij mbi sportin e veçanërisht futbollin, ka dhënë kontributin e tij në zhvillimin e kësaj discipline.

Miço Papadhropulli lindi më 11 mars 1933, në Tiranë, në një familje sportdashëse. Që në vegjëli, ai tregoi dashuri për futbollin duke u bërë pjesë më vonë e ekipeve të asaj kohe. Talentin e tij e pikasën te klubi sportiv "Partizani", aty ku është pashmangshmërisht i lidhur. Sezoni i parë me të kuqtë ishte ai i vitit 1957-1958, që do të rezultonte dhe vendimtar për të ardhmen e djaloshit. Partizani shpallej kampion i Shqipërisë atë vit dhe Papadhropulli do të merrte një shtysë më shumë për të luajtur titullar. Sezonet e tjera pasardhëse do të ishin të suksesshme si në aspektin personal, ashtu edhe ekipor. Me ekipin e Partizanit, ai luante në rolin e mbrojtësit dhe do të ishte i pakalueshëm për kundërshtarët. Më vonë, bashkëkohësit do e kujtonin si një mbrojtës kalibri, që ishte e vështirë t'i kaloje me top.

Si pjesë e ekipit të kuq, Papadhropulli fitoi gjashtë tituj kampion të Shqipërisë. Përkatësisht në vitet 1957, 1958, 1959, 1961, 1963, 1964. Me Partizanin ai nuk do të mjaftohej vetëm me titujt, pasi në fushë ishte një lider që shtynte ekipin drejt sukseseve. Përgjatë kësaj periudhe, Miço Papadhropulli ka mbajtur edhe shiritin e kapitenit në klubin e Partizanit. Me skuadrën e lavdishme të asaj kohe Papadhropulli fitoi medaljen e argjendtë në turnetë ndërkombëtar në Laipciq të Gjermanisë(1958) dhe në Hanoi të Vietnamit(1963).

Papadhropulli do të mbante edhe disa poste në organizmin e futbollit të asaj kohe. Ai ka qenë specialist futbollit gjatë diktaturës dhe e ka vijuar punën edhe pas vitit 1990. Në vitin 1997 deri në 2002 ai do të mbante postin e Presidentit të Federatës së Futbollit, në vitet e vështira kur askush nuk mendonte për lojën më të ndjekur në botë. Gjatë këtyre viteve në krye të institucionit të futbollit, me dëshirën dhe vizionin e tij ai ka hedhur themelet për avancimin e sportit në vend.

Pas vitit 2002 Federata e Futbollit do e nderonte për angazhimet në sport, duke i dhënë titullin "President Nderi i FSHF-së", "Mjeshtër i madh", "Mjeshtër i Merituar", Miço Papadhropulli i fitoi të gjitha në jetën e tij profesionale, por mbi të gjitha respektin e të gjithë komunitetit dhe qytetarëve që e njihnin, si një njeri të qeshur dhe shumë human.

Ish-lojtar i Partizanit dhe skuadrës kombëtare, pedagogu dhe drejtuesi i futbollit, Miço Papadhropulli. "Daja" i futbollit shqiptar, ka lënë pas një "mal" me arritje në fushën e sportit e veçanërisht në futboll, duke qenë një nga emrat më të spikatur të topkëmbës në Shqipëri. Miço Papadhropulli, trajner dhe pedagog, mbante titullin Profesor Doktor dhe ishte, padyshim, një nga figurat më të spikatura në futbollin dhe sportin shqiptar, me një imazh mjaft pozitiv, intelektual dhe njeri që ka rrezatuar dashamirësi në komunitetin e futbollit, dëshmuar me impaktin e tij të rëndësishëm në zhvillimet futbollistike në Shqipëri. Në fakt, Miço Papadhropulli ka lënë shenjë në drejtimin e futbollit në vend nga viti 1997-2002,

Papadhropulli pati mundësinë që në karrierën e gjatë futbollistike t'i provojë të gjitha, nga të rinjtë, tek Partizani, Kombëtarja, shef teknik i Federatës, përgjegjës i sektorit të futbollit të federatës, president i Federatës (1998-2002), si dhe pedagog pranë Institutit të Lartë të Kulturës Fizike "Vojo Kushi", sot Universiteti i Sporteve të Tiranës. "Daja" ishte personalitet në sport dhe njeri me humanizëm të shprehur në shoqëri dhe duhet thënë se kontributet e tij në futbollin shqiptar janë vërtet të mëdha.

109 vite ushtri shqiptare

Krenaria e kombit shqiptar feston 109-vjetorin e krijimit të saj

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të një shteti të pavarur, në Shqipëri, u formua më datën 4 maj 1913 në Vlorë. Formimi i Shtabit Madhuer u bë me miratimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ai mban fillimisht emërtimin Shtati Madhuer dhe më tej u emërua "Shtabi Madhuer", kryetar i të cilit ishte major Ali Shefqet Shkupi. Shtabi Madhuer e kishte qendrën në Vlorë, pranë Ministrisë së Luftës të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës që kryesohej nga Ismail Qemal Bej Vloja.

Në verën e vitit 1913 ky shtab ishte fare i vogël, ai përfaqësohej nga një zyrë që emërohej Zyra e Shtatit Madhuer të Ushtrisë, pranë Ministrisë së Luftës dhe ishte në përbërje e në varësi të kësaj ministrie. Në pikëpamje organizative Shtabi Madhor përbëhej nga "pjesët e nënzëshme", që emërtohej në terminologjinë e fillim shekullit të kaluar si: "Qarqet e Shtatit Madhuer, Sekretaria e Shtatit Madhuer, Komisioni i rregulloreve e i ushtrimeve, Komisioni i trajnimit të policisë e të xhandarmërisë, Komisioni i ndërtimit". Shtabi Madhor ishte konceptuar, ndërtuar, por edhe veprimi teorikisht e praktikisht si një organ bazë i Ministrisë së Luftës. Shtabi ishte përgjegjësi kryesor për organizimin, përgatitjen dhe drejtimin profesional të veprimtarisë luftarake të FA Shqiptare.

Në janar 1925, pas shpalljes së Republikës së parë të Shqipërisë, në bazë të Statutit Themeltar ose Kushtetutës, si një strukturë përbërëse, gjithsesi modeste, mbeti Shtabi Madhor. Me vënien në zbatim të organikes së re të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, në postin e kryetarit të Shtabit u emërua koloneli austriak Gustav Von Myrdac, i cili kryente njëherësh edhe detyrën e organizatorit të Ushtrisë Shqiptare, që e kryente që prej vitit 1922. Kryetari i Shtabit Madhor përzgjidhej nga radhët e oficerëve të lartë të karrierës, që të zotëronte përvojë të spikatur për organizimin, drejtimin, stërvitjen dhe planifikimin dhe njëherazi të ishte një prej organizatorëve të Ushtrisë.

Pas vitit 1932 Shefi i Shtabit Madhor u rrit në gradë, për vetë rëndësinë e postit dhe të detyrave që ai kryente në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare. Është fakt historik se vetëm në vitin 1922 ka pasur nënministër Mbrojtje dhe gjithë periudha deri në 1939-40



ka qenë pa zëvendësministra. Në vitet 1941-1942, ka pasur vetëm Sekretar të Përgjithshëm por pa të drejtë për firmosje në qeveri. Në mungesë të ministrave mund të firmoste vetëm një ministër qoftë edhe i një ministrie tjetër, por jo sekretari i Përgjithshëm. Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, më 7 prill 1939, Ushtria dhe krejt forcat e Armatosura Shqiptare, ashtu si dhe Shteti dhe institucionet e tjerë të tij u bashkuan dhe u njësuam me ato Italiane. Pra nuk flitej dhe nuk ekzistoni më Forcat e Armatosura Kombëtare. Përpjekje për të bërë "... rikrijimin e Ushtrisë Shqiptare të Shtetit Shqiptar", duke ngritur edhe "Komandën e Përgjithshme të fuqive të armatosura", u bënë nga Këshilli i Naltë i Regjencës, në nëntor të vitit 1943. Për këtë arsye Komiteti Ekzekutiv Provizor shpalli se "rihynte në fuqi Kodi Penal Shqiptar dhe gjithë ligjet e rregulloret e dhëna për Ushtrinë Shqiptare, përpara datës 7 prill 1939".

Në gusht 1946 Kryetar i Shtatmadhorisë u emërua Mehmet Shehu, në vend të gjeneralmajor Spiro Moisiut. Që nga 1 tetori i vitit 1946, pasi u suprimuan Komandat dhe disa seksione dhe u krijuan drejtoritë e seksionet e reja, kaluan në vartësi të drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm 7 Drejtori: Prapavija, Artileria, Ndërlidhja,

Xhenio, Mbrojtja Bregdetare, Operative dhe e Organizim-Mobilizimit, si dhe 10 seksione: i Zbulimit, Sekretariati i Shefit të Shtatmadhorisë, Shërbimi i Brendshëm i Shtatmadhorisë, i Prapavijës i Shtatmadhorisë, i Kimisë, i Tankeve dhe Autoblindave, i Aviacionit, i Stërvitjes Luftarake, i Shifrës, i Topografisë. Në vitin 1952, gjeneralmajor Petrit Dume emërohet Shef i Shtabit të Përgjithshëm, i cili u zëvendësua nga gjeneralmajor Arif Hasko në vitin 1954. Në vitin 1956 gjenerallejtënant Petrit Dume riemërohet Shef i Shtabit të Përgjithshëm, i cili qëndroi në këtë post deri në korrik 1974. Më vonë realizoheshin detyrat e gatishmërisë luftarake, të plotësimit, të drejtimit dhe të përgatitjes së komandave e shtabeve. Me riorganizimin në 1966, Shtabi i Përgjithshëm përbëhej nga katër drejtori e gatishmërisë luftarake, të Zbulimit, e Organizim-Mobilizimit dhe e Ndërlidhjes; dhe nga shtatë degë autonome: e MKK, e Shifrës, e Topografisë, e Administratës, Ekonomike, e Stërvitjes luftarake dhe e Shërbimit, strukturë e cila nuk ndryshoi deri në vitet '80-të. Nga Shtabi i Përgjithshëm nuk vareshin Komandat e Korpuseve, Drejtoria Politike, Drejtoria e Xhenios, Komanda e MBL, Komanda e Artilerisë, Prapavija dhe Forcat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

26 SHEFAT E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM



1. Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi, personalitet në Ushtrinë osmane, ish-komandanti i garnizonit të Stambollit me gradën “binbash”. Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi ka qenë shef i Shtatmadhorisë së parë Shqiptare me funksionet e komandantit suprem të ushtrisë shqiptare në qeverinë e Ismail Qemal Vlorës.

Akademisë Ushtarake, në vitin 1906. Më 1908 kreu studimet në Akademinë e njohur të Shtatmadhorisë në Vjenë.



5. Gjeneral Gustav Von Myrdac me origjinë austriake, ishte në postin e kryetarit të Shtabit madhor, i cili kryente njëherësh edhe detyrën e organizatorit të Ushtrisë Shqiptare, që e mbante qysh prej vitit 1922. Ai kishte lindur më 7 dhjetor 1876 në Vjenë.



2. Gjeneral Ali Riza

Kolonja përveç detyrës si Ministër Luftime, në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare në vitet '20, pas Kongresit të Lushnjës me Kryeministër Sulejman Delvinën, ka kryer edhe detyrën e Kryetarit të Shtabit Madhor si dhe njëherësh edhe detyrën e Komandantit të vetëm të Divizionit që kishte në atë kohë Shqipëria. Ai ishte

lindur në Kolonjë, më 1880 dhe u arsimua në Manastir, në Stamboll ndërsa akademinë e shtabit e kishte kryer në Gjermani. Kishte kulturë të gjerë ushtarake, prirje në diplomacinë ushtarake dhe zotëronte pesë gjuhë të huaja. Në 1922 ishte pjesëtar në Komisionin Ndërkombëtar të Katër Fuqive nënshkruese për kufijtë e Shqipërisë.



6. Gjeneral Spiro Moisiu

lindi në vitin 1900 në qytetin e Kavajës. Pasi mbaroi shkollën unike në qytetin e Kavajës dhe Durrësit, Spiro u dërgua për të ndjekur gjimnazin në Vjenë të Austrisë. Pas kthimit nga Austria, aty nga viti 1918-1919, ai mbaroi një kurs disa mujor në shkollën e plotësimit të oficerëve në Tiranë.



7. Gjeneralkolonel Mehmet

Shehu lindi më 10 janar 1913, në fshatin Çorrush të Mallakastrës. Në vitin 1932 përfundon shkollën teknike. Shkon në Napoli për të studiuar në Kolegjin Ushtarak, ku përjashtohet për ide revolucionare nga ky kolegji.



3. Major Xhavid Leskoviku ka lindur më 2 maj 1882 në Leskovik. Ndoqi studimet në Akademinë e Luftës në Stamboll për degën e këmbësorisë (Pyade). Është titulluar oficer më 1 gusht 1907, duke shërbyer për gjashtë vite me radhë në ushtrinë osmane në disa detyra. Por, më 1 janar 1913 hyn në shërbim të Ushtrisë Kombëtare shqiptare.

Ai shërbeu në qeverinë e Ismail Qemalit si dhe në ushtrinë e Vilhelm Vidit. Me krijimin e ushtrisë, nga fundi i vitit 1920, emërohet kryetar i Shtatmadhorisë, ndërkohë që ministër Luftime ishte gjeneral Ali Riza Kolonja.



4. Major Bajram Fevziu

ka qenë i njohur si një nga drejtuesit e Shtabit Madhor, por njëherësh edhe si personalitet politik i botës shqiptare së cilës i përket. Bajram Fevziu u lind më 1884 në Kolonjë. Me përfundimin e shkollës së mesme shkoi në Stamboll ku përfundoi studimet në



8. Gjenerallejtënant

Beqir Balluku lindi më 14 shkurt 1917 në Tiranë. Studioi në Shkollën Teknike të Tiranës. U përfshi në lëvizjen komuniste qysh gjatë kohës që kryente shërbimin ushtarak 1940 deri 1942. Më 20 maj 1943 u caktua komandant i batalionit partizan “Krujë-Ishëm”, më 18 shtator 1943 komisar i brigadës së tretë dhe më pas komandant i Br2S.

Më 28 janar 1948 ishte emëruar kryetar i Shtatmadhorisë së Ushtrisë. Kreu në Moskë Akademinë Ushtarake “Voroshilov”.



9. Gjenerallejtënant Arif

Hasko Mema lindi në Tërbaç të Vlorës dhe i njohur gjatë LIIB me pseudonimin “Patrioti”, gjatë luftës për çlirimin e vendit. Pasi mbaroi filloren në vendlindje, vazhdoi shkollën tregtare në Vlorë. Ai ka udhëhequr në LANÇ formacione të rëndësishme partizane që nga Vlora e deri në veri të Shqipërisë . Në dhjetor të

1943-it, inkadrohet në BrIS, duke kryer detyra të ndryshme, deri komisar politik i kësaj brigade. Mbas çlirimit kryen Akademinë e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm në Bashkimin Sovjetik.



10. Gjenerallejtënant Petrit

Dume lindi më 20 maj të vitit 1920, Partizan, Komandant brigade, Komandant divizioni, shpallur Hero i Popullit me vendim të Qeverisë Politike e Byrosë së PPSH-së, e më pas në vitin 1974 u shpall Armik i Popullit.



11. Sami Meçollari ishte Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, për një periudhë të shkurtër në vitin 1974; ka qenë drejtues i spikatur i Formacioneve të mëdha ushtarake. Lindi në Marjan të Oparit në Korçë, më 10 mars 1937. Ka kryer shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” dhe SHBO me rezultate të shkëlqyera, ku u titullua oficer.



12. Veli Llakaj ka lindur më 18 shkurt 1935 në Kras të Tepelenës. Në vitin 1951 mbaron shkollën 7-vjeçare në vendlindje. Në vitet 1951-1954 punon në gjeologji e tregti në Memaliaj. Në vitin 1954 shkon student në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, të cilën e mbaron më 1957 me rezultate të shkëlqyera dhe i jepet grada më e lartë toger. Me mbarimin e shkollës në vitin 1957 emërohet në Shkollën e Bashkuar komandant Toge,



13. Kiço Mustaqi ishte një ushtarak karriere që kishte lindur më 22 mars 1938, në një fshat pranë Delvinës, Sarandë. Në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes vjen pasi kishte kryer detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare për nëntë vite rresht. Në shkurt të vitit 1991 ngarkohet me detyrën e Ministrit të Mbrojtjes të Shqipërisë në përbërje të qeverisë së Kryeministrit Fatos Nano dhe u largua nga detyra me dorëheqjen e qeverisë, në qershor të po atij viti.



14. Kolonel Halim Abazi ka lindur në dhjetor të vitit 1944 në Tërbaç të Vlorës. Ka kryer të gjithë llojet e arsimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera. Kështu në vitet 1953-1960 kreu studimet në shkollën ushtarake “Skënderbej”; në vitet 1960-1964 ka kryer Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe në vitet 1970-

1972 Akademinë e Mbrojtjes. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake.



15. Gjeneralmajor Kostaq Karoli,

lindi në dhjetor të vitit 1945 në Korçë. Ka qenë ushtarak i talentuar, ka kryer të gjithë llojet e arsimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera. Në qershor 1991 deri në gusht 1992 ka kryer detyrën madhore të shefit të SHP. Ka komanduar FA-të kur kishin një efektiv të madh, si aktiv ashtu edhe rezervist, me rreth 16500 oficerë, 9000 nënoficerë, 60000 ushtarë e 8000 civilë, rezervistë rreth 450000

vetë dhe 230000 forca vullnetare. Me 22 divizione dhe tre forca që ishin: mbrojtja kundërajrore, flota luftarake-detare dhe aviacioni. SHP kishte nën komandë 127 brigada këmbësorie, brigada artilerie dhe brigada sulmuese; rreth 1050 tanke, rreth 4000 gryka zjarri artilerie tokësore; 34 regjimente të artilerisë kundërajrore, pa llogaritur artilerinë kundërajrore të brigadave, etj. Në kufi, mitralozat e rëndë (armët roje), bateritë e gatshme të artilerisë kundërajrore, hapnin zjarr për 2-3 minuta. Për 20-30 minuta, batalionet mitraljerë në vijën e kufirit ishin bërë gati për luftim; për 15-20 minuta, artileria tokësore e gatshme kishte hapur zjarr. Ka punuar dhe punon në sektorët shkencorë ushtarakë me titullin akademik “profesor”.



16. Gjeneral Ilia Vasho ka lindur më 10 korrik 1944, në Leskovik. Ka kryer të gjithë llojet e arsimit ushtarak shqiptar, si dhe kualifikimet më të larta ushtarake. Kështu në vitet 1962-1964 ka kryer Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe në vitet 1976-1978 Akademinë e Mbrojtjes. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Mbante gradën shkencore “Doktor Shkencash”.



17. Gjeneral me katër yje, Sheme Kosova. Në periudhën 1994-1997 ka kryer detyrën madhore, shef i Shtabit të Përgjithshëm. Sheme Kosova lindi në 24 mars 1949. Ndoqi studimet në Shkollën e Mesme Pedagogjike në 1967 dhe Shkollën e Lartë të Bashkuar në vitin 1971, ndërsa në vitet 1979-1981 ka përfunduar studimet në Akademinë Ushtarake. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare deri në shef i

Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Shqiptare. Në 2 mars 1997 lirohet nga kjo detyrë madhore.



18. Gjeneralmajor Adem Çopani ka lindur në korrik të vitit 1944 në Tiranë. Ka kryer të gjithë llojet e arsimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera si shkollën ushtarake “Skënderbej”; Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe Akademinë e Mbrojtjes. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në vitet 1991 deri në mars 1997 ka kryer detyrën e Këshilltarit ushtarak të Presidentit të Republikës.



19. Gjeneral brigade Aleks Andoni ka lindur më 8 qershor 1956 në fshatin Vuno të Vlorës. Ka kryer arsimin ushtarak në shkollën ushtarake “Skënderbej”; në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve; në Akademinë e Mbrojtjes si dhe kualifikimin pasuniversitar për pedagogji e psikologji. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në vitet 1992 deri në gusht 1997 ka dalë oficer në rezervë si rezultat i reformës ushtarake.



20. Gjenerallejtënant Pëllumb Qazimi ka lindur në vitin 21.10.1957 në Skrapar. Në vitin 1981 ka përfunduar Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve; në 1991 u diplomua në Akademinë e Mbrojtjes, në 1992 kreu kursin për “Refugjatët”, Hungari, kursin për “Ligjshmërinë Ndërkombëtare për Refugjatët”, në Itali; në 1994 kreu kursin për “Orientimin dhe planëzimin e operacioneve”, në Turqi; në

1995 kursin “Zbulimi Strategjik”, SHBA; në 1996 u diplomua në Kolegjin e Mbrojtjes, Tiranë; në 1996 kursin e NATO-s “Oficer shtabi për operacionet”, Holandë; në 1998 kursin për “Ligjin e Luftës”, Itali;



21. Gjeneralmajor Luan Hoxha ka lindur më 28 mars 1960 në Shkodër dhe ka qenë Shef i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura nga viti 2006-2008. Pas diplomimit në 1983 e deri në 2008 ka kryer detyra të larta deri në shef shtabi, si dhe kualifikime të shumta por shpërthimi që ndodhi në 15 mars 2008 i ndërpreu edhe karrierën ushtarake, kur ishte ngjitur deri në

detyrën më madhore të ushtarakut..



22. Gjeneralmajor Maksim Malaj ka lindur më 13.12.1958. Ka përfunduar Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve si dhe më vonë shumë kualifikime. Në 1981-1982 ka qenë instruktor i Përgatitjes së Zjarrit në Shkollën e Instruksionit, Zall Herr; më tej për pesë vite ishte instruktor Stërvitjeje; Instruktor në Degën e Stërvitjes në Divizionin e 8-të të Këmbëorisë; Komandant Batalioni këmbësorie e territorial;

në vitin 1992-1993 instruktor në Degën e Stërvitjes në Divizionin e 8-të të Këmbëorisë; në 1993-1994 Shef Operacional në Njësinë Ushtarake Nr. 1105; në 1994-1997 instruktor në Degën e Stërvitjes në Divizionin e 8-të të Këmbëorisë; në 1997-2005 inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Ministrisë të Mbrojtjes në 2005-2007, Shef Shtabi dhe në 2008, Komandant i Br.R.SH.



23. Gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi ka lindur në Peshkopë, më 30 janar 1963. Ai filloi jetën ushtarake në vitin 1977 në SHMU “Skënderbej”. Në vitin 1985 u diplomua nga Akademia Ushtarake, ku pas saj filloi karrierën e tij ushtarake si komandant toge. Gjatë karrierës së tij, ka qenë komandues, toge, kompanie, batalioni, brigade. Ka kryer kolegjin e Luftës së Forcave Tokësore në Turqi, ku u diplomua në vitin

1998. Nga viti 1998 deri në vitin 2004 ka kryer detyra të ndryshme në Shtabin e Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Ai ishte Atashe i Mbrojtjes Shqiptare në Turqi që nga viti 2004 deri në vitin 2007. Në vitin 2007, u diplomua në Kolegjin e Mbrojtjes.



24. Gjeneralmajor Jeronim Baze, Lindi në Tiranë, në maj 1960. Mbaroi studimet universitare në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, në Tiranë, në vitin 1985 dhe u titullua oficer aktiv. Kolonel Baze u emërua në 2012 këshilltar ushtarak i Presidentit të Republikës Nishani dhe më pas Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në nëntor 2013.



25. Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, Shefi i Shtabit i 25-të, i 105 viteve ushtri shqiptare. Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku ka lindur më 05 qershor 1967, në Pëllumbas, Berat. Ka përfunduar studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin “zbulim”, në vitin 1990. Gjatë karrierës së tij ushtarake

ka kryer Kolegjin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, Tiranë, Kolegjin e Shtabeve të Bashkuara, si dhe Kolegjin e Komandës dhe Shtabit në SHBA. Ka përfunduar studimet për master shkencor në Administrim Publik (UT), në bashkëpunim me Universitetin e Nebraskës, si dhe ka mbrojtur doktoratën në fushën e Mbrojtjes. Gjeneral brigade Kollçaku ka përfunduar gjithashtu Kursin e Lartë Ndërkombëtar të Menaxhimit të Mbrojtjes, si dhe Kursin Ndërkombëtar të Oficerit për Taktikë dhe Inteligjencë në SHBA.



26. Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj

Gjeneralmajor Bajram Begaj ka lindur më datë 20 mars 1967, në Rrogozhinë. Në vitin 1989, gjeneralmajor Begaj ka përfunduar studimet pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, Dega Mjekësi e Përgjithshme dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin “Mjekësi”

në vitin 1998. Përpara se të merrte detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, për një periudhë tre vjeçare, ka shërbyer në detyrën e komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes..

Gjatë karrierës së tij ushtarake, gjeneralmajor Bajram Begaj ka shërbyer në pozicione të ndryshme drejtuese në Forcat e Armatosura, si: zëvendës drejtor i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”; drejtor i Përgjithshëm i Spitalit Ushtarak Qendror Universitar; drejtor i Inspektoratit Shëndetësor, kryeinspektor dhe këshilltar i Inspektoratit Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm të FA; shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake dhe zëvendës drejtor i Spitalit Universitar të Traumës, si dhe detyra të tjera në strukturat e Forcave të Armatosura. Gjeneralmajor Begaj ka ndjekur kualifikime dhe specializime të ndryshme në fushën ushtarake dhe atë mjekësore, në institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit. Ai ka përfunduar Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, Shkollën e Thelluar Pasuniversitare të Mjekësisë dhe specializimin pasuniversitar në profilin Gastrohepatologji, pranë Fakultetit të Mjekësisë Tiranë. Gjithashtu ka ndjekur kursin e menaxhimit spitalor dhe kursin e lidershipit mjekësor strategjik, në SHBA, Kursin e Lartë Ndërkombëtar të Menaxhimit të Mbrojtjes, pranë Institutit të Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në Shkollën Pasuniversitare të Marinës në SHBA, Seminarin e Lartë Ekzekutiv pranë Qendrës Marshall, Gjermani, si dhe kurse e kualifikime të tjera ushtarake. Gjeneralmajor Bajram Begaj, ka përfunduar “Doktoratën në Fushën e Mjekësisë”, pranë Fakultetit të Mjekësisë si dhe mban titullin “Profesor i Asociuar” në Mjekësi. Njëkohësisht është vlerësuar me medalje të ndryshme për arritje gjatë karrierës së tij ushtarake.

GËZUAR 28-29 NËNTORIN

"Shqipëria 109 vite shtet"

